



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 62

7 qershor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 292, datë 2.5.2012	Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.....	3027
Vendim i KM nr. 368, datë 30.5.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit”, të ndryshuar.....	3096

VENDIM
Nr.292, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË KALIMIT NGA TRANSMETIMET ANALOGE NË
TRANSMETIMET NUMERIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, si dhe institucionet e tjera publike të përfshira në strategji, për zbatimin e këtij vendimi dhe implementimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA
E KALIMIT NGA TRANSMETIMET ANALOGE NË TRANSMETIMET NUMERIKE
TIRANË 2012

PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Përkufizimet

I. GJENDJA EKZISTUESE E TRANSMETIMEVE NUMERIKE

- 1.1 Plani i frekuencave për transmetime numerike i Shqipërisë
- 1.2 Kapacitetet transmetuese që krijohen nga implementimi i planit të frekuencave për transmetime numerike

1.3 Operatorët analogë që mbështeten në platforma numerike

1.4 Transmetimet analoge tokësore ekzistuese sipas allotmenteve

II. DIGJITALIZIMI

2.1 Objektivat e kalimit të plotë në transmetimet numerike

2.1.1 Objektivat kryesorë

2.1.2 Objektivi imediat

2.1.3 Objektivi i mbulimit

2.2 Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore të transmetuesit publik

2.3 Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë

2.4 Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë vendorë

2.5 Shfrytëzimi i kapaciteteve të planit numerik

2.6 Karakteristikat teknike

2.6.1 Tipat e rrjeteve

2.6.2 Sistemi i transmetimit

2.6.3 Standardet e kompresimit

2.6.4 Ndërfaqja e përbashkët



- 2.6.5 Plani i renditjes
 - 2.7 Mënyra e kalimit në transmetimet tërësisht numerike
 - 2.7.1 Metoda e ishujve numerikë
 - 2.7.2 Përdorimi i rrjetit të TVSH-së për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues
 - 2.7.3 Rendi i ndërtimit të ishujve numerikë
 - 2.7.4 Grafiku i ndërtimit të ishujve numerikë
 - 2.8 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të mbështetura në to
 - 2.8.1 Propozimi për mënyrat e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve në Shqipëri
 - 2.8.2 Licencimi i rrjeteve dhe programeve të operatorit publik
 - 2.8.3 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të operatorëve privatë kombëtarë që mbështeten në ta
 - 2.8.4 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të operatorëve rajonalë e vendorë (lokalë) që mbështeten në to
 - 2.9 Programet që mbështeten në rrjetet numerike
 - 2.9.1 Programet e transmetuara hapur (free to air)
 - 2.9.2 Programet me akses të kushtëzuar
 - 2.10 Futja e teknologjive e shërbimeve të reja mediatike
 - 2.10.1 Futja e transmetimeve HD në rrjetet numerike tokësore
 - 2.10.2 Futja e transmetimeve televizive mobile (DVB-T H)
 - 2.10.3 Futja e shërbimeve të tjera (shërbimet interaktive etj.)
 - 2.11 Strukturat për ndjekjen e procesit të digjitalizimit
 - 2.11.1 Komiteti *ad hoc* dhe sekretariati teknik ndërinstytucional
 - 2.11.2 Krijimi i komitetit ndërinstytucional
 - 2.12 Kostot e digjitalizimit
 - 2.12.1 Ndërtimi i rrjetit/rrjeteve të TVSH-së
 - 2.12.1.1 Kostoja e ndërtimit të rrjetit kombëtar numerik të transmetuesit publik (RTSH) - (MUX 1)
 - 2.12.1.2 Digjitalizimi i rrjetit të tv publik (MUX 1+MUX 2)
 - 2.12.2 Subvencionimi i dekoderve
 - 2.12.3 Kostot e informimit të publikut për digjitalizimin
 - 2.12.4 Kostot për aktivitetet e komitetit ndërinstytucional dhe sekretariatit teknik
 - 2.13 Propozimet për përmirësimin e kuadrit ligjor
- III. IMPLEMENTIMI I OBJEKTIVIT IMEDIAT**
- 3.1 Ndërtimi i rrjetit numerik të operatorit publik
 - 3.2 Ndërtimi i rrjeteve numerike private kombëtare
 - 3.2.1 MUX 3: Rrjet numerik privat kombëtar
 - 3.2.2 MUX 4: Rrjet privat kombëtar
 - 3.2.3 MUX 5: Rrjet privat kombëtar
- IV. FUTJA E TEKNOLOGJIVE E SHËRBIMEVE TË REJA MEDIATIKE (HD TV, DVBT H)**
- OFRIMI I KAPACITETEVE SHITESË PËR RRRITJEN E SHUMËLLOJSHMËRISË E PLURALIZMIT TË PROGRAMEVE**
- 4.1 Zgjerimi i kapaciteteve transmetuese të operatorit publik
 - 4.1.1 MUX 2: Rrjet publik kombëtar
 - 4.1.2 Konfiguracioni
 - 4.2 Ndërtimi i rrjeteve private lokale
 - 4.2.1 11 MUX -e lokale (MUX 6.1 deri në MUX 6.11)
 - 4.2.2 Konfiguracioni

4.3. Operatorët rajonalë

4.3.1 Operatorë rajonalë të rrjetit numerik

4.3.2 Operatorë programesh rajonalë (ofrues rajonal i shërbimeve audiovizuale)

V. RENDI I IMPLEMENTIMIT

5.1 Faza I

5.1.1 Ndërtimi i MUX 1

5.1.1.1 Grafiku i ndërtimit

5.1.1.2 Afatet e digjitalizimit

5.1.2. Ndërtimi i MUX 3, MUX 4, MUX 5 (rrjetet private kombëtare)

5.2 Faza II

5.2.1 Ndërtimi i MUX 6.1 deri 6.11 (rrjetet lokale)

5.2.2 Ndërtimi i rrjeteve rajonale (MUX 8.1 etj.)

5.3 Vendimi për përdorimin e mbulimit rezervë

VI. DIVIDENTI DIGJITAL

6.1 Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve

RRJETIN NUMERIK KOMBËTAR TË TVSH-SË

7.1 Llogaritja e pagesës për mbështetje në MUX (MPEG 4)

7.2 Gjendja financiare e disa operatorëve televizivë ekzistues

7.3 Operatorë me shpenzime më pak se 4.5 milionë lekë në vit

7.4 Operatorë me shpenzime deri në dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

7.5 Operatorë me shpenzime mbi dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

7.6 Klasifikimi i operatorëve sipas shpenzimeve vjetore

7.7 Propozime mbi lehtësimin e pagesave për mbështetjen e operatorëve ekzistues në rrjetin numerik të TVSH-së

7.7.1. Pagesë e diferencuar sipas zonës së licencimit

7.7.2. Pagesë e reduktuar për vitin e parë

7.7.3. Pagesë e reduktuar gjatë viteve

7.7.4. Subvencione

Aneksi 1

- Licencimi i platformave numerike

- Aspekte mbi përmbajtjen

- E ardhmja

- Propozimi për mënyrat e licencimit të rrjeteve dhe shërbimeve numerike në Shqipëri

Aneksi 2. Dividendi digjital

A1. Aspekte ndërkombëtare

A1.1 Elemente teknike në lidhje me opsionet e harmonizimit për dividendin digjital

A1.2 CEPT

A1.3 ITU

A2. Aplikimet kandidate potenciale

A2.1 Fleksibiliteti

A2.2 Neutraliteti teknologjik

A3. Struktura GE 06 dhe koordinimi jashtë kufijve

A3.1 Avantazhet e një rregullimi të preferueshëm frekuence të harmonizuar bazuar në FDD

A4. Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të komunikimeve elektronike në

Republikën e Shqipërisë

Aneksi 3. Aspekte mbi teknologjinë



HYRJE

ASPEKTI NDËRKOMBËTAR I KALIMIT NË SISTEMIN NUMERIK

Nën dritën e zhvillimeve të reja teknologjike është konkluduar me kohë, që përdorimi efektiv i spektrit të frekuencave dhe realizimi i objektivave politikë të çdo vendi, si: zhvillimi i tregut të brendshëm, konkurrenca, ndryshimi dhe rritja, nuk mund të arrihen me anë të përdorimit të një spektri të fragmentuar nëpërmjet teknologjive të vjetra analoge, por duke futur teknologjitë e reja numerike, për vetë avantazhet që paraqesin këto teknologji si cilësi më e lartë, efektivitet në shfrytëzimin e spektrit etj., që do të shpjegohen në detaje në vijim.

Kalimi nga transmetimet analoge në transmetimet numerike është një proces global i koordinuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU).

Për rajonin 1 ku Shqipëria bën pjesë, sipas ndarjes rajonale të ITU-së, afatet për përfundimin e tij janë përcaktuar nga marrëveshja GE 06. Ky afat është 17 qershor 2015.

Marrëveshja GE 06 është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007 (Fletorja Zyrtare nr. 187, datë 24.1.2008, faqe 588).

Puna për futjen e teknologjive të reja numerike (digjitale) në transmetimet televizive europiane ka filluar prej kohësh. Këshilli i Ministrave i Bashkimit Europian, miratoi më 20 nëntor 2003 “Konkluzionet mbi periudhën tranzitore nga transmetimet analoge në ato numerike”, duke theksuar në mënyrë të veçantë shkallën e ndryshme të zhvillimit, e cila ekziston aktualisht ndërmjet shteteve anëtare, si dhe faktin që çdo lloj ndërhyrje e politikës për të realizuar këtë tranzicion, do të duhet të realizohet kryesisht në nivel kombëtar, duke pasur parasysh nevojën për mbështetjen publike për këtë proces.

Bazuar në vendimin e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), në vitin 2004, u zhvillua Konferenca Rajonale e Radiokomunikacionit (RRC-04), agjenda e së cilës përfshiu veçanërisht çështjet e planifikimit të frekuencave për DVB-T në të gjitha vendet e Europës dhe Afrikës dhe të një pjese të madhe të vendeve të Azisë. Raundi i dytë i kësaj konference i emërtuar si RRC-06, u zhvillua në maj-qershor 2006. RRC-06 miratoi marrëveshjen GE 06 “Për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz”.

Pjesë e marrëveshjes ishte dhe plani i frekuencave për transmetimet numerike, ku përfshihej edhe plani shqiptar i frekuencave numerike.

Në marrëveshje parashikohet viti 2015, si viti i fundit i mbylljes së të gjitha transmetimeve analoge, çka detyron të gjitha shtetet nënshkruese të respektojnë afatet e këtij vendimi ndërkombëtar.

Për arritjen e marrëveshjes GE 06 dhe finalizimin e planit të frekuencave që i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje, janë organizuar një numër i madh takimesh koordinuese, bilaterale dhe multilaterale ndërmjet shteteve fqinje, qëllimi final i të cilave ishte shfrytëzimi i barabartë e jo diskriminues i burimeve të kufizuara të spektrit të frekuencave në mënyrë që transmetimet numerike të plotësojnë kërkesat e secilit vend, në sasi e cilësi, duke mos shkaktuar interferenca të dëmshme në transmetimet e shteteve përkatëse.

Shtetet anëtare të Bashkimit Europian kanë përcaktuar objektiva për kalimin në sistemin numerik dhe lirim të spektrit të frekuencave. Për ta nxitur këtë kalim, në maj 2005, Komisioni Europian miratoi komunikatën “Mbi përshpejtimin e periudhës së tranzicionit nga transmetimet televizive analoge në ato numerike”. Ky dokument parashikon që transmetimet televizive analoge, në vendet anëtare të Bashkimit Europian, do të mbyllen përfundimisht në periudhën nga 2010 deri në 2012, duke ekzaminuar problemet kryesore të krijuara nga migrimi nga sistemi analog në numerik dhe duke nxjerrë në pah avantazhet e shumta që ofrojnë transmetimet numerike. Ky dokument shpjegon edhe rrethanat të cilat justifikojnë ndërhyrjen e politikës në procesin e kalimit në sistemin numerik.

Kjo komunikatë i referohet, gjithashtu, nevojës që shtetet anëtare të krijojnë një mjedis rregullator të qëndrueshëm, në të cilën inkurajohet investimi dhe ofrohet një fleksibilitet më i madh në kushtet që shoqërojnë kalimin në sistemin numerik. Ajo thekson rëndësinë që do të këtë menaxhimi i spektrit në kalimin në sistemin numerik, duke propozuar, ndërmjet të tjerash, një koordinim ndërkombëtar më të ngushtë dhe mekanizma të rinj shpërndarjeje dhe caktimi.

Ajo i fton vendet anëtare të sigurojnë që ndërhyrjet e politikës të jenë transparente, të justifikuar, adekuate, të zbatuara në kohë dhe në një mënyrë jodiskriminuese, duke deklaruar gjithashtu, që “periudha tranzitore e kalimit nga sistemi analog në atë numerik është një proces gjithëpërfshirës me ndikime sociale dhe ekonomike, por që në të njëjtën kohë, paraqet një sfidë të madhe për industrinë, përdoruesit dhe strukturat shtetërore”.

Qytetarët europianë, përfshirë edhe qytetarët shqiptarë, duhet të marrin përfitime të drejtpërdrejta nga ky proces, në formën e një aksesimi më të shpejtë drejt teknologjive të reja dhe çmimeve më të ulëta për komunikimet.

Ndërkohë që procesi i digjitalizimit do të prekë pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare përmes pasojave të tij të paevitueshme, veçanërisht atyre teknike, ekonomike dhe sociale, roli i shtetit në këtë proces është i pazëvendësueshëm.

Pikërisht, për të përballuar këtë sfidë, konsiderohet i nevojshëm identifikimi dhe zbatimi i hapave dhe masave konkrete që duhet të ndërmerren në këtë drejtim. Përvoja e vendeve të tjera, që tashmë e kanë nisur këtë proces, ka treguar më së miri që një kalim i suksesshëm në këtë sistem, kërkon formulimin e një strategjie apo dokumenti gjithëpërfshirës, me qëllim që të adresohen në mënyrë të duhur sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes.

Ndërkohë që jo vetëm në Europë, por edhe në rajonin tonë ka shtete që e kanë përfunduar procesin e digjitalizimit, Shqipëria mbetet nga vendet e fundit ku ky proces nuk ka filluar ende në mënyrë të organizuar dhe të rregulluar. Çdo vonesë e mëtejshme rrezikon realizimin e procesit, që përbën një nga angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Realizimi i procesit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, është pjesë e detyrimeve dhe në kuadrin e kërkesave të BE-së lidhur me aderimin e Shqipërisë në të.

QËLLIMI I DOKUMENTIT

Qëllimi i këtij dokumenti politikash është përcaktimi i masave politiko-ekonomike dhe tekniko-organizative për realizimin e kalimit nga transmetimet analoge në numerike, duke synuar zbatimin e tij në mënyrë të plotë dhe efektive, si dhe arritjen e rezultateve sa më pozitive nga ky kalim.

Meqenëse shoqëria e sotme mbështetet në komunikimet e avancuara elektronike, kërkesa për radiofrekuenca është vazhdimisht në rritje. Spektri i frekuencave është një element parësor mbështetës i komunikimeve elektronike, pavarësisht nëse ai përfshin telefoninë mobile, aksesin pa tel në internet, apo transmetimet radiotelevizive.

Në ditët e sotme, zhvillimet e shpejta teknologjike dhe konvergjenca e komunikimeve elektronike, kapacitetet e medias dhe pajisjet elektronike, janë duke krijuar një mjedis dinamik në të cilin spektri është duke u bërë, gjithnjë e më shumë, një burim i kufizuar.

Nëse menaxhimi i spektrit nuk ecën paralel me këtë zhvillim, pra nëse metoda tradicionale mbetet e pandryshuar, shoqëria jonë do të privohet nga gëzimi i fryteve të këtij mjedisi të ri dinamik.

Ndryshimet e vrullshme të teknologjisë në fushën e medias, realiteti aktual i televizionit numerik në Shqipëri dhe nevoja për të përditësuar legjislacionin në fuqi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira europiane në këtë fushë, ka shërbyer si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hartimin e një dokumenti të tillë, me synimin për të krijuar një mjedis dhe vizion afatgjatë të qasjeve rregulluese në lidhje me procesin e digjitalizimit.



PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Kjo strategji e kalimit nga sistemi analog në atë numerik parashikon objektivat kryesorë dhe parimet e kalimit, formulon rolin e shtetit dhe të strukturave përkatëse të administratës shtetërore në krijimin e kushteve të kalimit në sistemin numerik, vlerësimin e situatës ekzistuese teknike dhe ligjore të peizazhit audiovizual shqiptar, si dhe përcakton hapat, procedurat dhe afatet e kalimit brenda datës 17 qershor 2015.

Transmetimet numerike do të rrisin sferën e shërbimeve të ofruara për publikun, do të zgjerojnë sferën e zgjedhjeve të hapura për përdoruesit dhe do të ofrojnë një akses më të gjerë në shërbimet e shoqërisë së informacionit, e cila i bën implikimet/përfshirjet ekonomike dhe sociale të këtij procesi shumë të rëndësishme.

Ky dokument është përgatitur bazuar në analizat që i janë bërë situatës aktuale, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, duke marrë parasysh interesat e konsumatorëve shqiptarë, aspektet financiare të këtij kalimi, aspektet e kapaciteteve të rrjetit, detyrimet e transmetimit, si dhe gjendjen apo situatën konkrete të transmetimeve në Shqipëri.

Dokumenti merr parasysh përfitimet e kalimit në sistemin numerik, si dhe udhëzimet, konkluzionet, rekomandimet dhe debatet e ndryshme të zhvilluara në Bashkimin Europian mbi vlerat dhe përfitimet që ofron kalimi në sistemin numerik.

Dokumenti fokusohet, gjithashtu, në përcaktimin e rrugës dhe fazave që do të ndjekë kalimi në sistemin numerik, ndërmarrjen e hapave ligjorë, institucionalë dhe teknikë që do ta shoqërojnë atë, si dhe nevojën e bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë aktorët e përfshirë.

Përcaktimi i instrumenteve rregullatore është një tjetër element pozitiv i këtij dokumenti, në mënyrë të veçantë për sa i përket ndërhyrjeve të politikës publike (p.sh. fushatave informuese për konsumatorët apo përcaktimit të rolit të televizionit publik shqiptar (TVSH) në procesin e digjitalizimit); masave rregullatore apo mekanizmave të realizimit të saj.

Realizimi i këtij kalimi, në përputhje me objektivat e përcaktuar në këtë dokument, do të nxisë dhe zhvillojë më tej tregun mediatik shqiptar, do të krijojë përfitime të mëtejshme për konsumatorët dhe veçanërisht për shtresat në nevojë, do të krijojë mundësinë e një përdorimi më të efektshëm të kapaciteteve të rrjeteve, si dhe të një spektri me kapacitet më të madh, veçanërisht për shkak të mbylljes së televizioneve analoge.

ZHVILLIMI I NJË PROCESI KËSHILLIMI PUBLIK

Kalimi në sistemin numerik përbën një zhvillim shumë të rëndësishëm për vetë operatorët dhe për publikun. Suksesi i tij varet nga aftësia e institucioneve për ta shoqëruar këtë lëvizje dhe për të koordinuar aktorët e ndryshëm të tij.

Realizimi me sukses dhe kalimi drejt sistemit të plotë digjital, kërkon mbi të gjitha bashkëpunim. I gjithë ky proces i rëndësishëm nuk mund të realizohet dot nga një institucion i vetëm, por ai përfshin një mjedis të gjerë partnerësh ku përfshihen strukturat shtetërore, legjislative dhe ekzekutive, organizatat joqeveritare në fushën e medias, operatorët, si dhe vetë qytetarët dhe konsumatorët.

Për këtë arsye, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ndërmori realizimin e një këshillimi të gjerë publik dhe bashkëpunimi me një numër sa më të gjerë të mundshëm të aktorëve të interesuar, duke filluar nga viti 2008. Kjo përfaqëse këshillimi publik, jo vetëm që ishte në linjë me praktikën europiane, por është gjithashtu e detyrueshme nga dokumentet përkatëse të politikave të Bashkimit Europian. Përvoja europiane tregon që një tranzicion i harmonizuar drejt transmetimeve digjitale, kërkon një konsensus të gjerë ndërmjet aktorëve të interesuar, në mënyrë të veçantë në procesin e miratimit të një strategjie të një interesi të përgjithshëm.

Në kuadër të zhvillimit të një këshillimi të gjerë publik, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në bashkëpunim edhe me partnerët ndërkombëtarë, të tillë si Organizata për Bashkëpunimin dhe Sigurinë në Europë (OSBE), ndërmori një tërësi hapash dhe masash ku

përfshihen këshillimi *on-line*, organizimi i takimeve dhe konferencave të ndryshme, kombëtare dhe rajonale, me qëllim njohjen më konkrete të operatorëve me sfidat e këtij procesi; njëherësh, edhe marrja e mendimeve dhe opinioneve të tyre, çka do të mundësonte qartësimin e ideve dhe kristalizimin e objektivave të detajuar, që duhet të realizohen për zbatimin me sukses të transformimit rrënjësor të peizazhit të medieve elektronike në Shqipëri.

Dhënia e ideve, opinioneve dhe rekomandimeve të ndryshme nga aktorët e interesuar, kryesisht nga operatorët radiotelevizivë, ka qenë një kontribut dhe ndihmë reale në përcaktimin e hapave që duhet të ndjekë ky proces. Nëpërmjet këtij procesi këshillimi janë identifikuar dhe përcaktuar format më optimale të bashkëpunimit me operatorët, si aktorë themelorë në këtë proces, për ndërtimin e platformave lokale, rajonale e kombëtare, ku do të mbështeten me prioritet programet ekzistuese dhe pas tyre, programet e reja të përgjithshme apo tematike, sipas kërkesave të tregut dhe preferencave të audiencës.

Kusht kryesor është njohja e teknologjisë dhe e funksionimit të sistemit numerik, shoqëruar me investimet dhe kostot përkatëse sipas tipit të rrjetit që do të ndërtohet.

Kontributet e ofruara nga të gjithë aktorët e interesuar janë tashmë pjesë e rëndësishme e këtij dokumenti strategjik për kalimin në sistemin numerik, duke përfshirë dhe eksperiencat e vendeve që janë përpara në këtë proces, si dhe standardet dhe praktikatat më të mira europiane në këtë fushë.

Në përfundim:

1. Realizimi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është një proces me rëndësi kombëtare dhe më i rëndësishmi i bërë ndonjëherë në fushën e transmetimeve radiotelevizive.

2. Nuk mund të lejohet asnjë vonesë për fillimin e procesit për digjitalizimin e transmetimeve të operatorëve televizivë shqiptarë (publikë e privatë), në mënyrë që të arrihet realizimi i këtij procesi brenda afatit të fundit të vendosur nga GE 06, qershor 2015.

3. Koha e mbetur nuk lejon që RTSH-ja dhe operatorët privatë që do të marrin licencat për mbulim kombëtar, rajonal apo lokal të punojnë me plane apo agjenda të ndryshme. Puna për mbulim të territorit me “ishuj digjitalë” do të kërkojë që të gjithë operatorët pa përjashtim të koordinojnë realizimin e punimeve në mënyrë “sinkrone” për të qenë të gatshëm të realizojnë *switch over*-in (mbylljen e transmetimeve analoge) në kohën që do të vendosin institucionet e ngarkuara për këtë qëllim sipas planit të veprimit bashkëlidhur këtij dokumenti.

4. Theksojmë, se edhe në vitin 2015, për shkak të konfiguracionit të thyer të terrenit, asnjë operator shqiptar nuk do të jetë në gjendje të mbulojë më shumë se 90-95% të territorit të vendit. Për pjesën e mbetur do të duhet të parashikohet mbulimi nëpërmjet satelitit, siç është realizuar edhe në vende të tjera.

5. Për realizimin me sukses të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike kërkohet angazhimi i qeverisë dhe përdorimi i skemave të ndihmës shtetërore.

PËRKUFIZIMET

1. “Aparat marrës” është bashkësia e pajisjeve elektronike që realizon marrjen dhe shfaqjen e transmetimeve radiotelevizive për përdoruesit dhe çdo aparat tjetër apo program i lidhur me të për këtë qëllim.

2. “Autoriteti i komunikimeve elektronike e postare” ose AKEP është autoriteti përgjegjës, rregullator për komunikimet elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

3. “Definicioni i lartë HD *high-definition television* (HDTV)” është videoja që ka një rezolucion thelbësisht më të lartë se ai i sistemeve tradicionale televizive (definicioni standard tv ose SDTV, ose SD). HDTV-ja ka një ose dy milionë piksel për kuadër, pothuaj pesë herë më shumë se SD-ja.

4. “Allotment”, zona gjeografike që mbulohet me një rrjet televiziv numerik me një frekuencë (SFN-Single Frequency Network).



5. “Zonë mbulimi me transmetim radioteleviziv” është territori në të cilin, intensiteti i sinjalit përmbush kërkesat e cilësisë së marrjes së sinjalit, të përcaktuara në aktet ndërkombëtare mbi transmetimet radiotelevizive.

6. “Zonë licencimi” është territori i mbulimit me shërbim transmetimi radioteleviziv nga një operator i caktuar, i përcaktuar nga autoriteti rregullator në licencën përkatëse.

7. “Kapacitet transmetues” është sasia e shërbimeve programore dhe shërbimeve të tjera që mund të mbështeten në një rrjet numerik.

8. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë: filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, pjesë teatrale etj.

9. “Program radio” është tërësia e mesazheve me zë që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.

10. “Program analog” është programi i mbështetur në një rrjet transmetimi analog.

11. “Program numerik” janë programet e mbështetura në një rrjet numerik transmetimi.

12. “Mjete tokësore” për shpërndarjen e një shërbimi transmetim radioteleviziv janë mjetet për shpërndarjen e një shërbimi të tillë nëpërmjet valëve të emetuara nga transmetues të instaluar në tokë.

13. “Multipleks” është një pajisje teknike për konvertimin e sinjaleve analoge në sinjale numerike dhe bashkimin e tyre në një varg (fluks) numerik të dhënash.

14. “Platformë multipleksi” është infrastruktura teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike dhe shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.

15. “Radio”, një term i përgjithshëm i aplikuar për përdorimin e radiovalëve.

16. “Radio valë” apo valë herciane, valë elektromagnetike me frekuenca më të vogla se 3 000 GHz, të përhapura në hapësirë pa udhëzues artificial.

17. “Frekuencë”, numri i lëkundjeve në sekondë të valëve elektromagnetike.

18. “Caktim i frekuencave (i një radiofrekuence apo kanali radiofrekuencor)”. Autorizimi i dhënë nga një autoritet publik për një radiostacion për të përdorur një radiofrekuencë apo një kanal radiofrekuencor në kushte të specifikuara.

19. “Operatori multipleks” është personi fizik ose juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike dhe shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.

20. “Ofrues shërbimi mediatik” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit me zë dhe/ose shërbimit të programit me zë e figurë dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

21. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike në rastet kur ato përdoren, për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

22. “Ofrimi i një shërbimi transmetimi radioteleviziv” është ofrimi i një programi të strukturuar me qëllim transmetimin ose shpërndarjen si një shërbim radioteleviziv.

23. “Shërbimet me zë dhe me zë e figurë sipas kërkesës”, janë shërbimet e transmetimit jolinear të ofruara nga ofruesi i shërbimit mediatik në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë

të kërkesës së tij mbështetur në një katalog programi të ofruar për këtë qëllim nga ofruesi i shërbimit mediatik.

24. “Transmetim pa pagesë – *Free on air*” është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektit që e siguron këtë shërbim.

25. “Shërbim i transmetimit publik” përfshin shërbimet pa pagesë të transmetimit të RTSH-së.

26. “Shërbim i transmetimit me zë” është një shërbim transmetimi, i cili përhap, ridërgon ose shpërndan lajme, zë, shenja ose sinjale, me qëllim marrjen e tyre të drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë.

27. “Shërbim programi me zë e figurë” është një shërbim, i cili përfshin një tërësi programesh me zë e figurë të çdo lloji dhe që përhapet ose shpërndahet drejtpërsëdrejti ose jo për marrjen nga publiku i gjerë.

28. “Simulcast”, periudha kohore kur do të lejohet bashkekzistenca e rrjeteve analoge me ato numerike.

29. “Mjete tokësore për shpërndarjen e një shërbimi transmetimi radioteleviziv” janë mjetet për shpërndarjen e një shërbimi të tillë nëpërmjet valëve.

30. “Transmetim analog tokësor”, shpërndarja e shërbimit të transmetimit radioteleviziv me mjete analoge.

31. “Transmetim numerik tokësor”, shpërndarja e shërbimit të transmetimit radioteleviziv me mjete numerike.

32. “Platformë numerike”, tërësia e mjeteve teknike numerike për mbështetjen e shërbimeve të programeve.

33. “Transmetimi televiziv” është transmetimi linear i një shërbimi radioteleviziv i siguruar nga ofruesi i shërbimeve mediatike për shikimin e njëkohshëm të programeve mbi bazën e një skeme programesh.

34. “Transmetim linear” është ofrimi i shërbimit të programit me zë dhe/ose me zë e figurë për marrje të njëkohshme të tyre nga dëgjuesit dhe/ose shikuesit.

35. “Transmetim jolinear” është ofrimi i shërbimit të programit me zë dhe/ose me zë e figurë për marrje sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.

36. “Shërbime të mbrojtura” janë:

a) ato shërbime të transmetimit me zë dhe/ose figurë dhe shërbime të shoqërisë së informacionit që ofrohen për qëllime fitimi mbi bazën e aksesit të kushtëzuar.

b) ofrimi i aksesit të kushtëzuar për shërbimet e cituara në shkronjën “a” të kësaj pike gjithashtu është një shërbim i mbrojtur.

37. “Akses i kushtëzuar” është marrja e masave dhe/ose rregullimeve teknike në mënyrë që aksesit në një formë të kuptueshme/të qartë në shërbimet e mbrojtura bëhet kundrejt një autorizim individual paraprak.

38. “Pajisje e aksesit të kushtëzuar” është çdo pajisje ose program kompjuterik i projektuar ose përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme/të qartë.

39. “Shërbim i transmetimit me zë” është një shërbim transmetimi, i cili përhap ose shpërndan shenja ose sinjale me zë, me qëllim marrjen e tyre të drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë.

40. “Shërbim programi me zë e figurë” është një tërësi programesh me zë e figurë të çdo lloji dhe që përhapet ose shpërndahet drejtpërsëdrejti ose jo për marrjen nga publiku i gjerë.

41. “Transmetimi televiziv” është transmetimi linear i një shërbimi radioteleviziv i siguruar nga ofruesi i shërbimeve mediatike për shikimin e njëkohshëm të programeve mbi bazën e një skeme programesh.

42. “Transmetuesi publik” është ofruesi publik i shërbimeve mediatike (RTSH).

43. “Transmetim satelitor” është shërbimi mediatik i transmetuar nëpërmjet satelitit.



44. “Shërbim transmetimi radioteleviziv” është një shërbim transmetimi, i cili përhap ose shpërndan sinjale me figura, me qëllim marrjen e tyre të drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë.

45. “Mbulim” është mbulimi i territorit të caktuar me sinjalin e një transmetuesi.

46. “Platformë numerike satelitore” është tërësia e mjeteve teknike, numerike, satelitore për mbështetjen e shërbimeve të programeve.

47. “Head end” është nyja qendrore e një rrjeti numerik ku instalohet pajisja multipleks.

48. “Dekoder” është pajisja që konverton sinjalet numerike në sinjale analoge, për t’u kapur (marrë) nga marrësit e zakonshëm analogë.

49. “Rrjet” është një tërësi stacionesh transmetuese që mbulojnë me sinjal një territor të caktuar.

LISTA E SHKURTIMEVE

1. ITU (International Telecommunications Union) - Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve.

2. GE 06 - Marrëveshja rajonale e radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1¹ dhe 3², në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz, (Gjenevë, 15 maj – 16 qershor 2006).

3. RRC-06 – Konferenca rajonale e radiokomunikacioneve (Gjenevë, 15 maj – 16 qershor 2006).

4. VHF (Very High Frequency) - Frekuencat shumë të larta (30 – 300 MHz).

5. UHF (Ultra High Frequency) – Frekuencat ultra të larta (300 – 3000 MHz).

6. DVB-T - *Digital Video Broadcasting Terrestrial* – Transmetimi numerik videotokësor (DVB-T) është sistemi në shërbimin tokësor, i përcaktuar në rekomandimin ITU-R BT.1306 të bashkimit ndërkombëtar të telekomunikacioneve, si “Sistemi numerik B”.

7. DVBT 2 - Sistem i transmetimeve numerike tokësore DVB-T, i përmirësuar.

8. T-DAB është sistemi në shërbimin tokësor, i përcaktuar në rekomandimin ITU-R BS.1114 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve si “Sistemi numerik A”.

9. DVB-H është sistem transmetimi numerik mobil.

10. MFN (Multi frequency Network) – rrjet numerik me shumë frekuenca.

11. SFN (Single Frequency Network) – rrjet numerik me një frekuencë.

12. SFN vendor – rrjet numerik me një frekuencë për mbulimin e një allotmenti.

13. HD (High-definition television (HDTV)) - është sinjal video me rezolucion substancialisht më të lartë së sinjalet video të sistemeve televizive tradicionale. (HDTV ka pesë herë më shumë piksel për kuadër në krahasim me sistemet tradicionale.

14. SDTV (standard-definicion TV) - është sinjali video i sistemeve televizive tradicionale.

15. MPEG 2 – Sistem kompresioni i figurës.

16. MPEG 4 – Sistem i avancuar i kompresionit të figurës.

17. TS (transport stream) - Sinjal që përmban programet televizive dhe të gjithë informacionin lidhur me të.

18. LCN (Logical Canal Number) – Numri (renditja e programit në buketë).

19. OSHM – Operator i shërbimeve mediatike.

20. DD- Digjital dividenti.

21. WRC – Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit.

22. PKF – Plani kombëtar i frekuencave.

¹ Rajon që sipas përcaktimit të ITU-së përfshin kryesisht Europën dhe Afrikën.

² Rajon që sipas përcaktimit të ITU-së përfshin kryesisht vendet e Azisë.

KALIMI I PLOTË NË TRANSMETIMET NUMERIKE

I. GJENDJA EKZISTUESE E TRANSMETIMEVE NUMERIKE

1.1 Plani i frekuencave për transmetime numerike i Shqipërisë

Plani shqiptar i frekuencave i miratuar me marrëveshjen GE 06, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, parashikon:

- 7 mbulime kombëtare me DVB-T (televizion numerik tokësor) në brezin UHF;
- 1 mbulim kombëtar me DVB-T në brezin VHF;
- 2 mbulime kombëtare me T-DAB (radionumerike) po në brezin VHF.

Përveç mbulimeve kombëtare, plani parashikon edhe mbulime lokale:

- Suballotmenti i Tiranës me 7 mbulime lokale DVB-T në UHF, 1 mbulim në DVB-T VHF dhe 2 mbulime në T-DAB VHF.

- Planifikimi i një numri frekuencash për mbulime lokale në disa zona të Shqipërisë

Forma e Allotmenteve¹:

1. Për DVB-T në UHF

2. Për DVB-T në VHF

3. Për T-DAB në VHF (Radio numerike)




Figura 1. Format e allotmenteve të planit numerik

1.2 Kapacitetet transmetuese që krijohen nga implementimi i planit të frekuencave për transmetime numerike

Tabela e mëposhtme (tabela 1) paraqet kapacitetet transmetuese që përfitohen nga plani i frekuencave numerike të Shqipërisë. Në tabelë janë paraqitur frekuencat (kanalet) e planifikuara për mbulimin e secilit allotment. Rreshtat me të njëjtën ngjyrë paraqesin kombinimet e frekuencave (kanaleve) të allotmenteve për të ndërtuar një rrjet numerik MFN me mbulim kombëtar. Siç shihet nga tabela, ekziston mundësia potenciale për të ndërtuar gjithsej 8 rrjete numerike me mbulim kombëtar. Nga tabela rezulton se me resurset që disponon plani kombëtar i frekuencave numerike, numri i rrjeteve numerike që mund të ndërtohen në territorin e Shqipërisë, varion nga 112 (nëse do të ndërtohen vetëm rrjete SFN vendore), në 32 (8 kombëtare MFN +24 vendore SFN), nëse do të

¹ Allotment: Zona që mbulon një rrjet transmetimi me disa transmetues. Në rastin kur numri i transmetuesve është 1, allotmenti është zona që mbulohet nga një caktim frekuencor (assignment).



synohej të maksimizohet numri i rrjeteve kombëtare. Në rastin e dytë disa zona (Shkodër, Lezhë, Tiranë dhe Vlorë) do të privoheshin nga e drejta e ndërtimit të rrjeteve vendore.

Mbulimet	Allotmenti Shkoder Kanali TV	Allotmenti Kukes Kanali TV	Allotmenti Diber Kanali TV	Allotmenti Lezhe Kanali TV	Allotmenti Tirane Kanali TV	Allotmenti Elbasan Kanali TV	Allotmenti Fier Kanali TV	Allotmenti Berat Kanali TV	Allotmenti Korçe Kanali TV	Allotmenti Gjirokaster Kanali TV	Allotmenti Vlore Kanali TV
Mb. 1 Kombetar	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8
Mb.2 Kombetar	22	26	24	23	21	23	22	24	21	26	23
Mb.3 Kombetar	28	32	25	29	34	33	27	25	27	29	39
Mb. 4 Kombetar	34	36	30	33	39	40	28	30	28	35	43
Mb. 5 Kombetar	41	40	38	43	53	42	29	32	43	37	46
Mb.6 Kombetar	45	42	54	46	57	46	31	36	45	38	57
Mb. 7 Kombetar	51	50	55	66	59	48	35	47	51	44	64
Mb. 8 Kombetar	59	52	60	68	61	49	45	52	55	48	68
Mb. Vendore		56	63			56	51	54	57	50	
Mb. Vendore		65	69			58		61	59	53	
Mb. Vendore						62		65	64	56	
Mb. Vendore						68		66		58	
Mb. Vendore										60	
Mb. Vendore										63	
Mb. Vendore										67	
Mb. Vendore										69	

Tabela 1. Kapacitetet transmetuese që krijohen nga plani i frekuencave numerike të Shqipërisë

Tabela e mëposhtme (tabela 2) paraqet mbulimet shpesh të planifikuara për qytetin e Tiranës dhe rrethinat e tij.

Mbulimet	Sub Allotmenti Tirane
	Kanali TV
Mbulimi 1	26
Mbulimi 2	37
Mbulimi 3	44
Mbulimi 4	50
Mbulimi 5	60
Mbulimi 6	64
Mbulimi 7	67

Tabela 2. Kapacitetet transmetuese që krijohen nga plani i frekuencave numerike të Shqipërisë për suballotmentin e Tiranës

1.3 Operatorët analogë që mbështeten në platforma numerike

Transmetuesi publik nuk ka ndërtuar rrjete numerike, por programi i tij transmetohet simulcast mbështetur në rrjetin numerik tokësor të Digitalb-it (i palicencuar). Gjithashtu edhe operatorët privatë kombëtarë (KLAN dhe Top Channel) transmetojnë në simulcast mbështetur në rrjetin numerik të digitalb. Përveç këtyre edhe disa operatorë lokalë kanë mbështetur programet e tyre në rrjete numerike, kryesisht të digitalb-it. Tabela e mëposhtme pasqyron gjendjen ekzistuese të transmetimit në simulcast të programeve të operatorëve të licencuar si operatorë analogë tokësorë.

Nr.	Operatorët	Statusi	Zona e mbulimit	Platforma
	Analogë TV			
1	TVSH	Publik	Kombëtar	Digitalb
2	TV Klan	Privat	Kombëtar	Digitalb
3	Top Channel	Privat	Kombëtar	Digitalb
4	TV News 24	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
5	TV Ora	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
6	Vizion +	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Tring
7	TV Shijak	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digital TV Shijak

Tabela 3. Operatorët që krahas transmetimeve analoge tokësore mbështeten edhe në rrjete numerike

Shënim. Operatorët privatë lokalë, duke u mbështetur në platformën numerike tokësore të digitalb, kanë zgjeruar zonën e mbulimit përtej zonës së tyre të licencimit.

Përveç rrjeteve numerike tokësore, disa operatorë ekzistues analogë, mbështesin programet e tyre edhe në platforma numerike satelitore.

Nr.	Operatorët tv analogë	Statusi	Zona e mbulimit	Platforma satelitore
1	TVSH	Publik	Kombëtar	Digitalb
2	TV Klan	Privat	Kombëtar	Digitalb
3	Top Channel	Privat	Kombëtar	Digitalb
4	TV News 24	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
5	TV Ora	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
6	Vizion +	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Tring
7	Vizion +	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
8	TV TNSH	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
9	TV Tirana	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
10	TV Alsat	Privat	TV Satelitor	Alsat
11	TV BBF	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
12	TV Koha	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb
13	TV Kukësi	Privat	Vendor (Tiranë - Durrës)	Digitalb

Tabela 4. Operatorët që krahas transmetimeve analoge tokësore, mbështeten edhe në platforma satelitore

Shënim. Në programet kombëtare përfshihen 2 programe të RTSH-së.

Shënim. Operatorët privatë lokalë, duke u mbështetur në platformat satelitore kanë zgjeruar zonën e mbulimit përtej zonës së tyre të licencimit.

Konkluzion

Prania e programeve të mbështetura në rrjete numerike (tokësore dhe satelitore) ka influencuar në njohjen e përdorimit të pajisjeve të teknologjisë numerike nga teleshikuesit në të gjithë territorin e Shqipërisë, faktor që ndikon në uljen e kostove për informimin e publikut në periudhën e kalimit.

1.4 Transmetimet analoge tokësore ekzistuese sipas allotmenteve

Tabela 5 pasqyron gjendjen e rrjeteve analoge tokësore të licencuar në territorin e Shqipërisë, të ndarë sipas allotmenteve të planit numerik. Kjo tabelë sillet për të llogaritur kapacitetet e rrjeteve numerike, të nevojshme për të mbështetur programet analoge ekzistuese me cilësi standarde (SDTV). Kjo do të thotë që në fazën e parë të kalimit, nuk do të aplikohen programe mbështetur në teknologjinë me definicion të lartë (HD).

Kapacitetet e rrjeteve numerike ndryshojnë në funksion të teknologjisë (DVBT apo DVBT 2) dhe të standardit të kompresionit të sinjalit (MPEG 2 apo MPEG 4).

Tabela e mëposhtme (tabela 5), paraqet numrin e nevojshëm të rrjeteve numerike për mbështetjen e të gjitha programeve analoge ekzistuese mbi këto rrjete numerike sipas standardit të kompresionit që do të përdoret. Siç rezulton nga tabela, varianti më optimal që siguron shfrytëzimin më efektiv të spektrit, rezulton përdorimi i sistemit MPEG 4.



Nr.	Allotmenti	Zona e licencimit				Programe gjithsej	Rrjete numerike të nevojshme	
		Deri 1 Qark	Deri 4 qarqe	Përsërit	Kombëtar		MPEG 2	MPEG 4
1	Shkodër	7	1	2	4	14	2 rrjete	1 rrjet
2	Kukës	-	1	-	4	5	1 rrjet	1 rrjet
3	Dibër	2	-	-	4	6	1 rrjet	1 rrjet
4	Lezhë	3	5	-	4	12	2 rrjete	1 rrjet
5	Tiranë	11	16	3	4	34	4 rrjete	2 rrjete
6	Elbasan	2	7	2	4	15	2 rrjete	1 rrjet
7	Fier	5	5	1	4	15	2 rrjete	1 rrjet
8	Berat	4	1	1	4	10	2 rrjete	1 rrjet
9	Korçë	5	1	-	4	10	2 rrjete	1 rrjet
10	Gjirokastër	4	-	2	4	10	2 rrjete	1 rrjet
11	Vlorë	7	2	3	4	16	2 rrjete	1 rrjet

Tabela 5. Numri i operatorëve analogë tokësorë ekzistues sipas allotmenteve të planit numerik dhe numri i rrjeteve numerike të nevojshme për të mbështetur programet analoge ekzistuese sipas allotmenteve të planit numerik

Shënim. Në programet kombëtare përfshihen 2 programe të RTSH-së.

II. DIGJITALIZIMI

2.1 Objektivat e kalimit të plotë në transmetimet numerike

2.1.1. Objektivat kryesorë:

- Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore në Republikën e Shqipërisë;
- Ofrimi i kapaciteteve shtesë për rritjen e shumëllojshmërisë e pluralizmit të programeve;
- Futja e teknologjive të reja mediatike (HD TV, DVB-T2, DVB- H) shërbimet interaktive etj.;

- Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.

Mbyllja e transmetimeve analoge që do të realizohet me përmbushjen e objektivit “Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore” në Republikën e Shqipërisë, do të krijojë premiset për realizimin e objektivave të tjerë. Prandaj propozohet që implementimi i rrjeteve numerike në Shqipëri të realizohet në dy faza:

1. Faza e parë. Realizimi i objektivit imediat: Mbyllje e transmetimeve analoge;

2. Faza e dytë. Ofrimi i kapaciteteve shtesë për rritjen e shumëllojshmërisë e pluralizmit të programeve; futja e teknologjive e shërbimeve të reja mediatike (HD TV, DVB-H, DVB-T2, shërbimet interaktive etj.); dhe shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve,

2.1.2 Objektivi imediat

Mbyllja e transmetimeve analoge:

- Ligji nr. 9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, përcaktonte si afat, brenda 31 dhjetorit 2012. Ky afat tashmë konsiderohet joreal.

- Afati i përcaktuar në marrëveshjen GE 06, ratifikuar nga Kuvendi Shqipërisë: brenda datës 17.6.2015.

Për arritjen e objektivit imediat, kërkohet zbatimi i tre komponentëve të mëposhtëm, secili me mision dhe karakteristika të ndryshme:

1. Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore të transmetuesit publik;
2. Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore të operatorëve privatë kombëtarë;
3. Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore të operatorëve ekzistues lokalë.

Digjitalizimi i secilit prej tre komponentëve të mësipërm kërkon përcaktimin e modeleve specifike që marrin parasysh misionin, karakteristikat dhe sidomos mundësitë financiare të realizimit.

2.1.3 Objektivi i mbulimit

Objektivi minimal i digjitalizimit do të jetë realizimi i mbulimit me sinjal të popullsisë, të paktën në masën që ky mbulim realizohet me teknologjinë analoge nga secili operator.

Operatori me mbulim më të madh të territorit është RTSH, i cili aktualisht mbulon 73%¹ të territorit të Shqipërisë, që i korrespondon rreth 85% të popullsisë.

Lidhur me hapat që do ndiqen për mbulimin me “ishuj digjitalë” është menduar të ndiqet radha që jepet në tabelën nr. 10. Mendohet që në vitin e parë të mbulohet një numër sa më i madh i popullatës, të paktën 60% dhe i gjithë bregdeti Adriatik. Vitin e dytë të mbulohet i gjithë bregdeti Jon dhe një pjesë e rëndësishme e zonës verilindore, që do çojë në një mbulim të paktën të 80% të popullatës së vendit. Pjesa e vitit të tretë shënon mbulimin e të paktën 90% të popullsisë së Shqipërisë.

Prandaj objektivi i mbulimit të realizuar me anë të rrjetit numerik të RTSH në përfundim të fazës së parë të digjitalizimit do të jetë:

Mbulimi i 75% të territorit dhe 85% të popullsisë.

Objektivi i fazës së dytë:

Mbulimi i 85% të territorit dhe mbi 90% të popullsisë.

2.2 Digjitalizimi i rrjeteve analoge tokësore të transmetuesit publik

Një numër dokumentesh të Këshillit të Europës i ngarkojnë televizionit publik barrën kryesore në procesin e kalimit të plotë në transmetimet numerike.

Misioni i transmetuesit publik është t’u ofrojë përdoruesve në të gjithë territorin e vendit, pavarësisht nga vendosja gjeografike, programe informative, didaktike e argëtuese të transmetuara hapur (pa pagesë). Në këtë mënyrë sigurohet që shtresat e gjera të popullsisë të marrin një minimum të caktuar shërbimesh mediatike. (Në mbledhjet e sekretariatit teknik, përfaqësuesit e TVSH-së insistuan që edhe operatorit publik t’i jepet e drejta të transmetojë programe të krijuara.)

Me qëllim që televizioni publik ta ruajë misionin e tij të pazëvendësueshëm edhe në epokën numerike, është e nevojshme të programohet me prioritet transferimi i programeve të tij në platforma numerike.

Financimi i ndërtimit të rrjetit numerik ku do të mbështeten programet e operatorit publik, në kushtet aktuale, përbën një sfidë të vështirë. Vlerësohet se ndërtimi i një rrjeti numerik kombëtar do të kushtojë rreth 12-14 milionë euro. Përcaktimi i drejtë dhe realist i skemës së financimit dhe kohës së kthimit të kapitalit, përbëjnë elemente bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së operatorit publik.

Kombinimi i ndërtimit të rrjetit të operatorit publik me ndërtimin e rrjeteve të operatorëve vendorë mund të jetë një rrugë që shkurton kostot e përgjithshme të kalimit në numerik dhe ndoshta mund edhe të ulë kërkesat e vetë operatorit publik për kapacitete transmetuese.

2.3. Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë.

Transmetimet numerike përbëjnë një realitet qysh prej më se 4 vjetësh në Shqipëri. Digitalb, Supersport, por edhe TRING, janë të pranishëm në pothuaj të gjithë territorin e vendit, nëpërmjet programeve të mbështetura qoftë në rrjete numerike tokësore, qoftë në rrjete satelitore. Këto programe ndiqen me interes nga pjesë të konsiderueshme të popullsisë, e cila është ambientuar me disa prej tyre sipas interesave të segmenteve e grup-moshave të ndryshme.

Ligji nr. 9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” (neni 4, pika 1) përcakton:

“Aplikuesit për licencë rrjeti, të pajisur ose jo me licencë për transmetim analog tokësor apo satelitor, që dëshirojnë të ndërtojnë një rrjet numerik, duhet të marrin pjesë në procesin e konkurrimit, të shpallur nga KKRT-ja, detajet e të cilit përcaktohen nga KKRT-ja, në përputhje me një rregullore, që miratohet paraprakisht për këtë qëllim”.

¹KKRT - Raporti vjetor 2010.



Zbatimi i këtij neni në kushtet aktuale mbart mundësinë potenciale të fitimit të garës prej një subjekti të ndryshëm nga operatorët ekzistues në treg, duke venë në rrezik investimet e kryera prej tyre në infrastrukturë, shërbime e programe.

Në këto kushte, zgjidhja më e përshtatshme do të ishte licencimi i operatorëve ekzistues bazuar në kushtet e vendosura nga ligji dhe rregullave të përcaktuara nga KKRT-ja sipas mënyrave të rekomanduara më poshtë.

Në praktikën e disa vendeve të BE-së është përdorur gjerësisht *beauty contest*. Për shembull, në Francë kanalet kryesore (publike e private) ekzistuese analoge (2,3,5, arte, TF1 dhe M6) trajtohen si “kanale historike”. Për nxitjen e kalimit në transmetime numerike të këtyre “kanaleve historike”, Autoriteti Rregullator Audiovizual Francez (CSA) u ka dhënë të drejtën, që përveç programit ekzistues, të transmetojnë edhe një program shtesë si “bonus”, si dhe u ka zgjatur kohën e autorizimit (licencës). Aktualisht kohëzgjatja është 15 vjet. Pas kalimit në platforma numerike, programet “historike” kanë marrë të drejtën të zgjatin kohën e autorizimit edhe 15 vjet të tjera. Sigurisht këto të drejta të operatorëve “historikë” janë sanksionuar në legjislacionin përkatës.

Në analogji me këtë praktikë, edhe në Shqipëri mund të përcaktohen operatorët historikë kombëtarë, si dhe operatorët e përshtatshëm që zotërojnë eksperiencë në transmetimet numerike dhe besueshmëri që duhen nxitur për kalimin e shpejtë në transmetimet numerike. Ndër kriteret e përcaktimit të “kanaleve historike” shqiptare mund të jenë koha e ekzistencës së programit televiziv, mbulimi i realizuar gjatë viteve, cilësia e programeve të transmetuara, audienca, aplikimi i teknologjive të reja etj.

Bazuar në kapacitetet e planit kombëtar të transmetimeve numerike, gjendjen ekzistuese dhe kërkesat e tregut, duke llogaritur edhe perspektivën, paraprakisht numri i rrjeteve private kombëtare për fazën e parë do të jetë 3 (shih tabelën 6).

Në licencën që do t’u lëshohet operatorëve privatë kombëtarë duhet të përfshihen edhe kushtet specifike që do të përmbushin për t’u licencuar në këtë mënyrë. Ndër kushtet kryesore do të jenë edhe kushtet e mëposhtme:

1. Operatorët ekzistues do të lirojnë frekuencat e zëna arbitrarisht dhe do të migrojnë në frekuencat e përcaktuara në planin numerik (GE 06), sipas specifikimeve të KKRT-së, brenda një kohe të përcaktuar në dokumentin e licencës, kohë e cila do të jetë e harmonizuar me realizimin e “ishujve numerikë”;

2. Secili operator ekzistues do të licencohet për një rrjet kombëtar numerik. Kjo do të thotë, që për të rritur efektivitetin e shfrytëzimit të spektrit, për të transmetuar pjesën më të madhe të programeve që sot mbështeten në disa rrjete, të aplikohet sistemi i komprimimit MPEG-4, në vend të MPEG-2 që aplikohet sot. Edhe për këtë kalim, në dokumentin e licencës do të vendosen afate të përcaktuara kohore;

3. Në kushtet e licencës do të vendosen detyrime për mbështetjen e rrjeteve të operatorëve lokalë (mbështetje programi apo *facility sharing*);

4. Në licencë do të vendosen kushte për të siguruar aksesin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën;

5. Në licencë do të vendosen kushte për standardizimin e sistemeve të aksesit të kufizuar, mbrojtjen nga programet me karakter dëmtues për të miturit etj.;

6. Në licencë, gjithashtu do të vendosen kushte për aplikimin e shërbimeve të reja (DVB-H, DVB-T2 HD etj.) dhe interaktive.

Licencimi i operatorëve historikë kombëtarë ose të përshtatshëm do t’i nënshtrohet garës bazuar në *beauty contest*. Aplikimi i licencimit në bazë të parimit të *beauty contest*-it do të marrë në konsideratë projektin e paraqitur nga operatorët e përshtatshëm dhe përmbushjen e kushteve të mësipërme.

Pavarësisht nga mënyra e licencimit, subjekti që do të fitojë të drejtën të ngrejë dhe shfrytëzojë një rrjet numerik tokësor privat kombëtar, do të paraqesë të gjitha garancitë financiare të nevojshme për sigurimin e ndërtimit të një rrjeti cilësor me karakteristikat e përcaktuara nga ligji dhe kushtet teknike, sipas specifikimeve të KKRT-së. Në këtë prizëm, strategjia synon në zhvillimin e modeleve që ofrojnë ndërtimin e rrjeteve numerike tokësore private kombëtare, duke synuar minimizimin e kostove financiare.

KKRT-ja mbi bazën e vlerësimit të zhvillimeve në tregun e transmetimeve televizive, të përcaktojë operatorët historikë kombëtarë, si dhe operatorët e përshtatshëm që gëzojnë kredibilitet, mbi bazën e eksperiencës në zhvillimin e transmetimeve numerike dhe të bëjë publike këtë vlerësim.

KKRT-ja do të ftojë këta operatorë të marrin pjesë në garën për t'u pajisur me licencën e transmetimit numerik kundrejt plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë dokument dhe në ligj. Me marrjen e aplikimeve, KKRT-ja duhet të vlerësojë aplikimet që çojnë në përdorimin më efektiv të frekuencave, sikurse përmes aplikimeve të përbashkëta. Në fund të këtij procesi KKRT-ja lëshon deri në tri licenca për ndërtimin e rrjeteve kombëtare numerike për operatorët privatë, sipas përcaktimit në tabelën 6.

Në rast të mungesës së interesit nga operatorët historikë ose të përshtatshëm për t'u pajisur me licencë kombëtare, KKRT-ja shikon mundësitë e realizimit të objektivit imediat përmes shfrytëzimit të kapaciteteve të lira të frekuencave, sipas përcaktimeve në planin numerik me licenca rajonale, duke synuar garantimin e mbulimit maksimal.

2.4. Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë vendorë

Është e evidente që operatorët vendorë ekzistues, me pak përjashtime, nuk i disponojnë mjetet financiare dhe aftësitë teknike të nevojshme për të ndërtuar dhe mirëmbajtur rrjetet e transmetimeve numerike tokësore. Ata nuk janë të prirur të mbyllin me dëshirën e tyre transmetimet analoge brenda vitit 2015, pasi kërkojnë të nxjerrin përfitimin maksimal nga investimet për ndërtimin e rrjetit.

Nga ana tjetër, kalimi në transmetimet numerike duhet realizuar pa prishur strukturën ekzistuese të tregut mediatic që aktualisht funksionon si treg i programeve të transmetuara hapur (pa pagesë) dhe që financohet nga reklamat. Ruajtja e strukturës së tregut do të thotë që programet ekzistuese analoge që do të mbështeten në platforma numerike do të vazhdojnë të transmetohen hapur (pa pagesë) dhe do të vazhdojnë të financohen nga tregu i reklamave.

Operatorët privatë lokalë, duke qenë më pranë komuniteteve lokale, përfaqësojnë vlera të pluralizimit të mendimeve, programeve, minoriteteve etj., vlera që duhen ruajtur e promovuar. Krijimi i mundësive për mbështetjen e programeve të tyre në platforma numerike pa sforcime të fuqishme ekonomike, i shërben edhe ruajtjes së strukturës ekzistuese të tregut, ku përdoruesit janë mësuar të marrin disa programe hapur (pa pagesë).

Në kërkim të rrugëve për realizimin e objektivit të kalimit të plotë e me kosto sa më të ulët financiare e shoqërore në transmetimet numerike, nga KKRT-ja janë studiuar disa mundësi.

Kombinimi i ndërtimit të rrjetit të operatorit publik me ndërtimin e rrjeteve të operatorëve vendorë mund të jetë një rrugë që do të shkurtojë kostot e përgjithshme të kalimit në numerik. Kjo do të sigurojë mbështetjen e të gjithë operatorëve ekzistues lokalë në platformën numerike të transmetuesit publik, duke i lënë këtij të fundit një numër minimal programesh për të plotësuar misionin e vet. Në këtë rast, procesi i transferimit të programeve analoge ekzistuese konsiderohet i shkëputur nga procesi i licencimit të rrjeteve të reja të transmetimeve numerike tokësore lokale, i cili mund të realizohet në një fazë të dytë, pas përfundimit të përbushjes së objektivit kryesor, që është mbyllja e transmetimeve analoge.

Zgjidhja e përshkruar më sipër nuk përjashton zgjidhje të tjera. Për të nxitur dhe përshpejtuar procesin e digjitalizimit, operatorëve privatë lokalë do t'u paraqiten alternativat e mëposhtme:

1. Mbështetje në rrjetin e operatorit publik;
2. Financimi i përbashkët prej operatorëve ekzistues në përbërje të një allotmenti për



ndërtimin e rrjetit numerik dhe shfrytëzimin e përbashkët të kapaciteteve të lira të tij (kërkohe mbështetja ligjore).

3. Organizimi i garës për ndërtimin e rrjetit numerik lokal.

Alternativa 3 do të aplikohet në rast se dështojnë alternativat 1 dhe 2.

2.5. Shfrytëzimi i kapaciteteve të planit numerik

Gjatë procesit të konsultimit të dokumentit të strategjisë u kërku mendim për shfrytëzimin e mbulimeve kombëtare të planit sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Klasifikimi	Zona e mbulimit	Numri i mbulimeve të planit kombëtar të shfrytëzuara	Numri i rrjeteve që mund të krijohen	Tipi i rrjetit
1	Operatori publik kombëtar	Territori i Republikës	2	2	11 SFN
2	Operatorë kombëtarë privatë	Territori i Republikës	3	3	11 SFN
	Operator rajonal 1	Tiranë-Durrës - Fier	0.3	1	SFN
3	Operatorë rajonalë 2	2 qarqe	0.7	4	2 SFN
4	Operatorë vendorë	1 qark	1	11	SFN
5	Rezervë	Territori i Republikës	1	1	11 SFN
	Mbulime Kombëtare gjithsej		8	22	SFN+MFN
6	Operatorë të qytetit të Tiranës	Qyteti i Tiranës dhe rrethinat	1	7	SFN

Tabela 6. Shfrytëzimi i mbulimeve kombëtare të planit të frekuencave numerike të Shqipërisë

Në këtë përcaktim njëri prej mbulimeve kombëtare (11 allotmente) parashikohej për t'u përcaktuar në të ardhmen në varësi të nevojave që mund të paraqiten, si dhe për aplikimin e teknologjive të reja.

Pas konsultimit dhe diskutimit me grupe të ndryshme të interesit, si dhe bazuar në rekomandimet e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), aktet finale të WRC-2007 dhe aktet finale të WRC-2012, zhvillimet në tregun evropian, ky dokument përcakton që tabela e mësipërme të ndryshojë, duke lënë dy mbulime kombëtare për t'u përcaktuar në të ardhmen. Shfrytëzimi i një mbulimi për operatorët rajonalë do të shqyrtohet më vonë. Në këtë mënyrë tabela e shfrytëzimit merr formën e mëposhtme:

Nr.	Klasifikimi	Zona e mbulimit	Numri i mbulimeve të planit kombëtar të shfrytëzuara	Numri i rrjeteve që mund të krijohen	Tipi i rrjetit
1	Operatori publik kombëtar	Territori i Republikës	2	2	11 SFN
2	Operatorë kombëtarë privatë	Territori i Republikës	3	3 ¹	11 SFN
3	Operatorë vendorë	1 qark	1	11	SFN
5	Rezervë	Territori i Republikës	2	2	11 SFN
	Mbulime kombëtare, gjithsej		8	22	SFN+MFN
6	Operatorë të qytetit të Tiranës	Qyteti i Tiranës dhe rrethinat	1	7	SFN

Tabela 7. Shfrytëzimi i mbulimeve kombëtare të planit të frekuencave numerike të Shqipërisë, i ndryshuar

2.6 Karakteristikat teknike

¹ Në varësi të zhvillimeve sipas seksionit 2.2, kapacitetet e lira në përfundim të procesit të licencimit mund të shfrytëzohen për ndërtimin e rrjeteve rajonale.

2.6.1 Tipat e rrjeteve

Siç paraqitet në pikën 1.1, plani kombëtar i frekuencave parashikon ndarjen e territorit të Shqipërisë në 11 allotmente.

Për shfrytëzimin optimal të kapaciteteve të krijuara nga plani kombëtar i frekuencave, propozohet që secili allotment i planifikuar, të mbulohet nga një rrjet me frekuencë të vetme (SFN-Single Frequency Network). Për krijimin e mbulimeve më të mëdha se një allotment, do të kombinohen dy ose më shumë SFN. Për krijimin e një rrjeti kombëtar, kërkohet kombinimi i SFN-ve të 11 allotmenteve, pra do të krijohet një rrjet MFN (Multi Frequency Network), pra tipi i rrjetit do të jetë 11 SFN.

Mundësia e ndërtimit të një SFN-je konsiderohet si një nga tiparet përcaktuese të transmetimit digjital. Kjo lejon një rritje të ndjeshme në efikasitetin e spektrit. Një nga çështjet kryesore në lidhje me SFN-të është kërkesa për sinkronizim të shpërndarësve edhe nëse ndodhen larg njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, SFN-të japin avantazhin që zgjerimi i rrjetit dhe shtimi i transmetuesve shtesë (gap-fillers) mund të bëhet pa riplanifikim.

Parimi bazë i planit të Gjenevës është që subjektet e regjistruara të mbrohen dhe që çdo aktivizim i ri të përputhet me subjektet e regjistruara në plan. Kur një kërkesë e re koordinimi konkludohet pozitivisht, subjekti i koordinuar bëhet pjesë e planit me të njëjtat të drejta. Në rast kërkesë të re koordinimi, nëse nuk arrihet një marrëveshje midis administratave të interesuara, mosmarrëveshja raportohet në Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikimit (ITU), i cili ka për detyrë të asistojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve anëtare të ITU-së. Kjo do të thotë që marrëveshja GE 06 mund të akomodojë lehtësisht frekuenca të reja për çdo ndarje (allotment) ose edhe transmetues të rinj, me kusht që të respektohen disa dispozita. Procedura e saktë për ndryshime të planeve GE 06 jepet në nenin 4 të marrëveshjes, Gjenevë 06.

2.6.2 Sistemi i transmetimit

Sistemi i transmetimit DVB-T i përshkruar si “Sistemi B” në rekomandimin ITU-R BT.1306-3.DVB-T është pjesë e akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-863 MHz) Pika 1.1 e kapitullit 1 të aneksit 2 (elementet dhe kriteret teknike të përdorura në zhvillimin e planit dhe implementimin e marrëveshjes).

Për të lejuar përdorimin më të mirë të burimeve të spektrit, në vitin 2009, konsorciumi DVB nxori kushtet specifike për teknologjitë DVB-T2, si një zgjerim i standardit ekzistues DVB-T. Një zgjerim i tillë rezulton në rritjen me 30-50% të efektshmërisë së DVB-T2, kundrejt DVB-T. Pritet që të dyja standardet do të bashkekzistojnë për disa vjet.

Testimi i specifikave të DVB-T2 ka filluar në Mbretërinë e Bashkuar dhe Itali. Në qershor 2008, Transmetuesi Publik Britanik (BBC), së bashku me operatorët e rrjetit të transmetimit *Arqiva* dhe *National Grid Wireless*, kreu transmetimin e parë testues të DVB-T2 me tri kanale HD të transmetuara në një multipleks. Në Itali, një operator (Europa 7¹) ka nisur së fundmi operacione tregtare në një *muks* në gusht të vitit 2010 bazuar në teknologjinë DVB-T2/MPEG-4. Europa 7 ka nxjerrë një ofertë me pagesë që bazohet në DVB-T2, duke ofruar tetë përmbajtje HD për përdoruesin e fundit me një regjistrim mujor ndërmjet 7 dhe 20 euro për muaj. Dekoderi që bazohet në teknologji DVB-T2/MPEG-4 shpërndahet drejtpërdrejt nga Europa 7 me një çmim rreth 120/130 euro. Në Finlandë, operatori DNA Oy ka marrë një licencë për të operuar në dy multiplekse DVB T2. Prezantimi ndodhi kohët e fundit pas një periudhe prove që u krye në qytetin Lahti, në dhjetor të vitit 2009. Disa vende të tjera, si Suedia dhe Austria², kanë bërë njoftimet përkatëse ose tashmë kanë instaluar rrjetet DVB-T2.

Nga sa u trajtua më sipër, duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, mundësitë e

¹ <http://www.europa7.it>

² http://www.dvb.org/about_dvb/dvb_worldwide



përfitimit ekonomik dhe përdorimit më efektiv të spektrit të frekuencave që ato ofrojnë, zhvillimet në vendet e tjera, si dhe lirin e brezit të DD-së rekomandohet që Shqipëria të kalojë direkt në implementimin e sistemit më të avancuar DVB-T2.

Për të gjitha rrjetet e parashikuara nga tabela e mësipërme (tabela 7) mënyra e marrjes do të përcaktohet nga KKRT-ja në përputhje me standardet teknike të miratuara në aneksin 2 të marrëveshjes GE 06.

2.6.3 Standardet e kompresimit

Në rrjetet numerike tokësore që do të ndërtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë do të aplikohet sistemi i kompresionit MPEG-4 H.264 e sisteme të tjera më të avancuara të së ardhmes. Kjo do të lejojë shfrytëzimin me efektivitet të spektrit, si dhe programet HD.

Duke qenë se operatorët ekzistues të rrjeteve numerike tokësore (të palicencuar) aplikojnë standardin MPEG 2, do të caktohet një periudhë tranzicioni MPEG2/MPEG-4 (jo më shumë se 2 vjet).

2.6.4 Ndërfaqja e përbashkët

Zhvillimi i televizionit digjital (në frekuenca satelitore, tokësore dhe kablllo) dhe mbi të gjitha, hyrja e televizionit me pagesë dhe platformave me akses të kushtëzuar, ka çuar në krijimin e një numri të madh të mjeteve të enkriptimit, të projektuara për të lejuar vetëm shikuesin e identifikuar me një kod të veçantë enkriptimi, të shohë programin e dëshiruar.

Problemi me enkriptimin qëndron në faktin se çdo ofrues shërbimi që ofron përmbajtje me anë të kanaleve me pagesë mund të përdorë një kod enkriptimi që është i ndryshëm nga të tjerët. Si pasojë, konsumatori që dëshiron të shikojë kanale të pranishme në më shumë se një platformë, të enkriptuara në mënyra të ndryshme, do të duhet të blejë një dekoder për secilin sistem enkriptimi.

Zgjidhja e këtij problemi qëndron në përdorimin e të ashtuquajturës “Ndërfaqe e përbashkët”, një standard i përcaktuar që mundëson shtimin e një moduli aksesi të kushtëzuar (CAM) në një marrës DTV, për t’u përshtatur me lloje të ndryshme kriptografimi. Njihet gjithashtu si DVB-CI për ndërfaqen e përbashkët të transmetimeve me figurë digjitale. Ndërfaqja lejon transmetuesit të përdorin module që përmbajnë zgjidhje nga furnizues të ndryshëm në të njëjtin sistem transmetimi, duke rritur kështu zgjedhjen e tyre për opsionet kundër piraterisë. Sistemi përbëhet nga një *host* dhe një modul:

- *host*-i, një pajisje ku moduli/et mund të lidhen; për shembull, një marrës/dekodues i integruar (IRD), një VCR, një PC;

- moduli, një pajisje e vogël, që nuk punon vetëm, e dizenuar për të kryer detyra të specializuara në lidhje me një *host*; për shembull, një nënsistem aksesi të kushtëzuar, një modul aplikacioni të guidës së një programi elektronik ose për të siguruar burime të nevojshme për një aplikacion, por që nuk sigurohet direkt nga *host*-i.

Shembujt e një *host*-i janë televizioni digjital ose një *set-top box*-i digjital. Standardi normativ DVB-CI EN 50221 i përcaktuar në vitin 1997 nga CENELEC, Komiteti Europian për Standardizimin Elektroteknik, lejon shumë lloje modulesh; sidoqoftë, vetëm Moduli i Aksesit të Kushtëzuar (CAM) pati popullaritet për arsye të televizionit me pagesë. Në variantin tipik, *host*-i dërgon një TS¹ (Transport Stream) të enkriptuar MPEG tek CAM-i dhe ky i fundit e kthen TS-në e dekriptuar te *host*-i. Zakonisht CAM-i përmban një lexues të kartave smart.

Krijimi i një standardi të tillë dhe zbatimi i tij, duke pasur si pasojë detyrimin për të përfshirë një DVB-CI në të gjitha терминаlet televizive digjitale², ka kërkuar disa vjet për shtetet

¹ Sinjal që përmban programin dhe të gjithë informacionin lidhur me të.

² Përhapja e shpejtë e televizorëve me sintonizues digjital të integruar (iDTVs) mund të lehtësojë detyrën e shndërrimit digjital. Tashmë, shumë nga prodhuesit e mëdhenj elektronikë për konsumatorët shesin vetëm televizorë me sintonizues digjital të integruar, gjë që ul numrin e televizorëve që duhet të shndërrohen. Në Europë, vetëm Franca dhe Italia kanë bërë të detyrueshme sintonizuesit digjitalë në televizorë. Që nga 3046

anëtare të BE-së. Prandaj, ky dokument propozon aplikimin e një standardi të vetëm, në mënyrë që prodhuesit e dekodereve dhe televizorëve të fusin pajisjet e ndërfaqes së përbashkët të *hardware*-i dhe të shmangin gjenerimin e konflikteve që mund të jenë të dëmshme për konsumatorët.

Përvoja e tregut italian, gjithashtu sugjeron instalimin e detyruar të sintonizuesve digjitalë tek televizorët. Në fakt, sipas të dhënave statistikore në këtë kuadër, kjo ka stimuluar dhe përshpejtuar procesin e digjitalizimit dhe që nga koha e futjes së detyrimit, numri i marrësve të integruar në televizorë është dyfishuar.

2.6.5 Plani i renditjes

Standardi i televizionit digjital ofron një kanal sinjalizues të quajtur informacion shërbimi (DVB-SI). Një kanal i tillë sinjalizimi lejon, ndër të tjera, mundësinë për të komunikuar te pajisjet marrëse dhe tek telekomandat numrin e caktuar për secilin kanal DTT të transmetuar. Marrësit DTT mund të kërkojnë automatikisht kanalet DTT duke shfrytëzuar një identifikues/fushë të veçantë në TS¹ (transport stream) të *muks*-it, të quajtur numri logjik i kanalit (LCN).

Nga pikëpamja e operimit, rendi i kanaleve DTT menaxhohet nga operatorët e rrjetit/*muks*-it, të cilët mund të fusin në TS identifikuesin e saktë LCN që korrespondon me numrin e caktuar për secilin shërbim digjital. Si rezultat, të tërë marrësit DTT (me anë të *software*-it të përshtatshëm) i lejojnë shikuesit – kur instalojnë marrësin DTT për herë të parë – të rendisin në mënyrë automatike të gjitha programet e marra sipas një liste të parapërcaktuar (i ashtuquajtur “plan i renditjes DTT”). Rendi i listës, si dhe formati, janë shumë të rëndësishëm: Të gjitha programet duhet të kenë numrin e tyre specifik, në 3 shifra (ose 4 shifra, por sistemi me 3 shifra është përdorur nga pothuajse të tëra shtetet e BE-së) dhe transmetuesit në vend duhet të programohen për të dërguar të njëjtën listë rendore. Zakonisht, grupi i kanaleve 1XX i dedikohet të ashtuquajturave kanale “të përgjithshme” ose kanale me shumë qëllime (në mënyrë tipike transmetuesi publik dhe ato që nuk karakterizohen nga një temë specifike); grupi 2XX zakonisht përfshin “kanalet e lajmeve” (CNN, BBC world etj.), grupi 3XX përfshin “kanalet e filmave”, grupi 4XX përfshin “kanalet sportive”, grupi 5XX përfshin “kanalet lokale” e kështu me radhë.

Renditja DTT nuk duhet të përcaktohet te kushtet specifike të marrësit, por nëpërmjet sinjalit që mbart informacionin e renditjes nëpërmjet një identifikuesi LCN. Marrësit DTT duhet të jenë të aftë të njohin numrin e caktuar për secilin kanal DTT kur kryhet sintonizimi i kanaleve.

Nëse plani i renditjes nuk përcaktohet nga rregullatori, lindin konflikte në nivel marrjeje ndërmjet kanaleve DTT. Konflikte të tilla rrisin pasigurinë dhe në disa shtete kanë krijuar hutim dhe kanë ngadalësuar zbatimin e procesit të digjitalizimit. Plani i renditjes duhet të përcaktohet bazuar në transparencë dhe jodiskriminim, por gjithashtu duke pasur parasysh zakonet ekzistuese të konsumatorëve.

Propozohet që formati i planit shqiptar të renditjes (PSR) të jetë me 3 shifra dhe të hartohet nga KKRT-ja.

2.7 Mënyra e kalimit në transmetimet tërësisht numerike:

Realizimi i objektivit imediat;

marsi i vitit 2008, shitësit e pakicës në Francë kanë qenë të detyruar të shesin televizorë me sintonizues digjital, kurse në Itali një kërkesë e tillë ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2009. Më tej, që nga dhjetori i vitit 2008, të tërë televizorët *HD-ready* të shitur në Francë duhet të përfshijnë një sintonizues digjital dhe një dekoder HD. Ndërsa nuk ka detyruar instalimin e sintonizuesve digjitalë, Mbretëria e Bashkuar ka përfituar nga vendimi i disa shitësve të mëdhenj me pakicë për të mos shitur më televizorë analogë. Shtetet e Bashkuara kanë kthyer detyrimin për instalimin e sintonizuesve digjitalë në themelin e politikës për kalimin digjital. Që nga marsi i vitit 2007, prodhuesit amerikanë kanë qenë të detyruar të instalojnë një sintonizues digjital në të tërë televizorët.

¹ Sinjal që përmban programin dhe gjithë informacionin lidhur me të.



Përdorimi i rrjetit numerik të TVSH-së për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues dhe implementimi sipas metodës së ishujve numerikë.

2.7.1 Metoda e ishujve numerikë

Ndërtimi do të kryhet sipas rendit dhe afateve të përcaktuara allotment pas allotmenti (metoda e ishujve numerikë) deri në mbulimin e plotë të territorit shqiptar (11 allotmente). Rendi i implementimit të ishujve numerikë dhe afatet do të miratohen nga komiteti *ad hoc* për strategjinë e kalimit në transmetimet numerike.

Me përfundimin e ndërtimit të rrjetit në një allotment të caktuar, pas një periudhe të shkurtër prove (1 muaj), transmetimet analoge të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë që mbulojnë zonën e allotmentit përkatës, do të mbyllen.

Afatet e përcaktuara për ndërtimin e rrjeteve numerike të RTSH-së do të jenë të njëjta me afatet për ndërtimin e rrjeteve numerike të operatorëve numerikë privatë kombëtarë, të përcaktuara në kushtet e licencës që do t'u lëshohet nga KKRT-ja.

Për realizimin e mbylljes së transmetimeve analoge në zonën Tiranë-Durrës dhe të qarkut të Vlorës, ku numri i operatorëve lokalë analogë ekzistues e tejkalon kapacitetin e rrjetit numerik të TVSH-së, do të vendosen detyrime (qoftë edhe të përkohshme) për operatorët privatë kombëtarë, duke përcaktuar një numër minimal programesh të transmetuara hapur (pa pagesë për publikun) për këtë qëllim. Këto programe do të mbështeten në rrjetet private me të njëjtat kushte (përfshirë kushtet ekonomike), si dhe programet që do të mbështeten në rrjetin e operatorit publik.

2.7.2 Përdorimi i rrjetit të TVSH-së për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues

Rrjeti i parë numerik kombëtar i TVSH-së (MUX 1) në fazën e parë do të shërbejë si mbështetje për të gjitha programet ekzistuese lokale që mbështeten në rrjete analoge.

Ndërtimi i këtij rrjeti do të realizohet allotment pas allotmenti sipas metodës së përshkruar në pikën 5.1 paraardhëse.

Në këtë rrjet do të mbështeten të paktën 3 programe kombëtare të operatorit publik dhe kundrejt pagesës, të gjitha programet private tv lokale ekzistuese të licencuara nga KKRT-ja që përfshijn allotmenti i dhënë.

Do të konsiderohen si ekzistuese të gjitha programet e licencuara deri në fund të vitit 2011. Të gjitha programet që do të mbështeten në këtë rrjet do të transmetohen hapur (pa pagesë) për publikun.

Ndërtimi i MUX 2 mund të zbatohet pjesërisht për rajonin Tiranë - Durrës qysh në fazën e parë (shih pikën "a"), për të plotësuar kapacitetet e MUX 1 për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues.

Tabela e mëposhtme paraqet shfrytëzimin e kapaciteteve të rrjetit të parë numerik të televizionit publik që do të shfrytëzohen për mbështetjen e programeve analoge ekzistuese lokale, së bashku me kapacitetet për mbështetjen e programeve kombëtare të RTSH-së dhe të dy operatorëve ekzistues analogë kombëtarë.

Nr.	Allotmenti	Zona e licencimit				Programe gjithsej	Rrjete numerike të nevojshme
		Deri 1 qark	Deri 4 qarqe	Përsërit	Kombëtar		MPEG 4
1	Shkodër	7	1	2	4	14	1 Rrjet
2	Kukës	-	1	-	4	5	1 Rrjet
3	Dibër	2	-	-	4	6	1 Rrjet
4	Lezhë	3	5	-	4	12	1 Rrjet
5	Tiranë	11	16	3	4	34	2 Rrjete
6	Elbasan	2	7	2	4	15	1 Rrjet
7	Fier	5	5	1	4	15	1 Rrjet

8	Berat	4	1	1	4	10	1 Rrjet
9	Korçë	5	1	-	4	10	1 Rrjet
10	Gjirokastrë	4	-	2	4	10	1 Rrjet
11	Vlorë	7	2	3	4	16	1 Rrjet

Tabela 8. Mbështetja e operatorëve analogë ekzistues në rrjetin e TVSH-së

Zgjerimi i kapaciteteve transmetuese të operatorit publik (ndërtimi i MUX 2) do të realizohet njëkohësisht me ndërtimin e rrjetit të parë. Kjo kërkon përcaktimin e numrit optimal të programeve që do të konsiderohen të vlefshme për të përmbushur misionin e operatorit publik. Në këtë fazë do të përcaktohen nevojat për shërbimet e reja të operatorit publik (HD, shërbimet interaktive etj.).

2.7.3 Rendi i ndërtimit të ishujve numerikë

Ndërtimi i rrjetit numerik të tv kombëtare, do të bëhet në përputhje me planin e veprimit bashkëlidhur këtij dokumenti. Përdorimi i metodës së ishujve numerikë lejon të planifikohet ndërtimi me faza i kombinuar me mbylljen e transmetimeve analoge. Kjo metodë ka avantazh se racionalizon investimet dhe realizon mbylljen e përshkallëzuar të transmetimeve analoge.

Mbulimi me sinjal numerik i territorit në fazën e parë të implementimit do të synohet të jetë më i madh ose i barabartë me mbulimin me sinjal analog nga secili operator ekzistues analog.

Në fazën e parë do të synohet që mbulimi me sinjal numerik të jetë mbi 90% të popullsisë.

2.7.4 Grafiku i ndërtimit të ishujve numerikë

Ndërtimi i ishujve numerikë do të fillojë nga rajoni i Tiranës, sipas renditjes së përshkruar në tabelën e mëposhtme dhe do të përfundojë 3 vjet nga dita e fillimit. Afati përfundimtar për realizimin e kësaj është 17 qershor 2015.

Nr.	Zona	Popullsia (%)	Familje	Mbulimi (% e popullsisë)	Implementimi i ishujve digjitalë				
					Fillimi, muaj	Mbarimi, muaj	Testimi, muaj	Transferimi, muaj	Mbyllja e transmetimeve analoge
1	Q. Tiranë - Q. Durrës	32.71	347369	85	0	2	3	4	6
2	Qarku i Fierit	11.48	97594	85	3	5	6	7	9
3	Qarku i Elbasanit	9.99	106090	85	6	8	9	10	12
4	Qarku i Lezhës	5	52809	85	9	11	12	13	15
5	Qarku i Shkodrës	7.82	83054	85	12	14	15	16	18
6	Qarku i Vlorës	8.74	92819	85	15	17	18	19	21
7	Qarku i Korçës	8.29	88113	85	18	20	21	22	24
8	Qarku i Beratit	5.47	6281	85	21	23	24	25	27
9	Qarku i Dibrës	4.22	44823	85	24	26	27	28	30
10	Qarku i Gjirokastrës	3.7	39347	85	27	29	30	31	33
11	Qarku i Kukësit	2.58	27346	85	30	32	33	34	36
	Territori i Shqipërisë	100	985643	85					
	Implementimi në vite				0	2.67	2.75	2.83	3.00

Tabela 9



Nr.	Zona	Specifikimet teknike	Shpallja e garës	Shqyrtimi i aplikimeve	Shpallja e fituesit	Implementimi i ishujve digjitalë							
						Fillimi	Mbarimi	Testimi	Transferimi, muaj	Mbyllja e transmetimeve analoge			
1	Q. Tiranë – Q. Durrës	Prill 2012	Maj 2012	Qershor 2012	Korrik 2012								
	Ndërtimi i SFN-së					Tetor 2012	Janar 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013			
Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>	Tetor 2012					Janar 2013	Shkurt 2013	Mars 2013					
2	Qarku i Fierit												
	Ndërtimi i SFN-së					Tetor 2012	Janar 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013			
Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>	Tetor 2012					Janar 2013	Shkurt 2013	Mars 2013					
3	Qarku i Elbasanit												
	Ndërtimi i SFN-së					Korrik 2013	Tetor 2013	Nëntor 2013	Dhjetor 2013	Janar 2014			
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Korrik 2013	Tetor 2013	Nëntor 2013	Dhjetor 2013				
4	Qarku i Lezhës												
	Ndërtimi i SFN-së					Mars 2013	Qershor 2013	Korrik 2013	Gusht 2013	Shtator 2013			
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Mars 2013	Qershor 2013	Korrik 2013	Gusht 2013				
5	Qarku i Shkodrës												
	Ndërtimi i SFN-së					Mars 2013	Qershor 2013	Korrik 2013	Gusht 2013	Shtator 2013			
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Mars 2013	Qershor 2013	Korrik 2013	Gusht 2013				
6	Qarku i Vlorës												
	Ndërtimi i SFN-së					Korrik 2013	Tetor 2013	Nëntor 2013	Dhjetor 2013	Janar 2014			
Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>	Korrik 2013					Tetor 2013	Nëntor 2013	Dhjetor 2013					

Nr.	Zona	Specifikimet teknike	Shpallja e garës	Shqyrtimi i aplikimeve	Shpallja e fituesit	Implementimi i ishujve digjitalë				
						Fillimi	Mbarimi	Testimi	Transferimi, muaj	Mbyllja e transmetimeve analoge
7	Qarku i Korçës	Prill 2012	Maj 2012	Korrik 2012	Gusht 2012					
	Ndërtimi i SFN-së					Nëntor 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013	Qershor 2013
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Nëntor 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013	
8	Qarku i Beratit									
	Ndërtimi i SFN-së					Nëntor 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013	Qershor 2013
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Nëntor 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013	
9	Qarku i Dibrës									
	Ndërtimi i SFN-së					Mars 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Mars 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	
10	Qarku i Gjirokastrës									
	Ndërtimi i SFN-së					Mars 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>					Mars 2014	Qershor 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	
11	Qarku i Kukësit									
	Ndërtimi i SFN-së	Korrik 2014	Tetor 2014	Nëntor 2014	Dhjetor 2014	Janar 2015				
	Lidhja e studiove të op. ekz. me <i>Head End</i>	Korrik 2014	Tetor 2014	Nëntor 2014	Dhjetor 2014					

Tabela 10. Grafiku i ndërtimit të ishujve numerikë

2.8 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të mbështetura në to

2.8.1 Propozimi për mënyrat e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve në Shqipëri

Shqipëria ka një traditë të fortë të marrjes së programeve pa pagesë (free to air) nëpërmjet transmetimeve analoge tokësore, gjë e cila influencon në zgjedhjen e modelit të licencimit edhe të transmetimeve numerike.

Modeli “gatekeeper”, ku e drejta për të vendosur mbi përmbajtjen e mbështetur në platforma numerike i jepet një entiteti, privat konsiderohet jo i përshtatshëm për Shqipërinë.

Në analogji me shumë shtete të Europës, edhe në Shqipëri propozohet një sistem licencimi ku rregullatori të mbajë kontrollin mbi përmbajtjen e ofruar, duke synuar përmbushjen e misionit publik të medieve elektronike.

Në funksion të këtij objekti propozohet të aplikohen llojet e mëposhtme të licencave:

- a) Licencë shërbimi programi audio për ofrimin e një shërbimi programi audio;
- b) Licencë shërbimi programi audioviziv për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv;
- c) Licencë transmetimi audio. Kjo licencë përbëhet nga:
 - i) Licencë shërbimi programi audio sipas pikës “a”; dhe
 - ii) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit radio, i cili mund të jetë analog ose numerik;
- d) Licencë transmetimi audiovizive. Kjo licencë përbëhet nga:
 - i) Licencë shërbimi programi audioviziv sipas pikës “b”; dhe
 - ii) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit televiziv, i cili mund të jetë analog ose numerik.

Një ndarje e tillë e licencave krijon fleksibilitet për t’iu përshtatur çfarëdo modeli biznesi në tregun e medieve audiovizuale.

P.sh. për transmetimet analoge, propozohet të jepet licencë transmetimi audio ose audiovizive analoge (pikat “c” dhe “d” më sipër). Kjo licencë përfshin licencën për shërbimin programor dhe licencën për ndërtimin e operimin e rrjetit analog (1 rrjet - 1 program).

Për transmetimet numerike, propozohet të jepet licencë transmetimi audio ose audiovizive numerike. Kjo licencë përfshin licencën për shërbimet programore dhe licencën për ndërtimin e operimin e rrjetit numerik (1 rrjet – shumë programe).

Për të shmangur monopolet dhe për të nxitur pluralizmin, operatorët që do të pajisen me licencë transmetimi numerike (audio apo audiovizuale) do të lejohen të shfrytëzojnë vetëm 60% të kapacitetit të rrjetit të tyre numerik për të mbështetur programet e veta. Kapacitetet e lira ata detyrohen t’ua ofrojnë në bazë të kriterëve të drejta, të barabarta dhe jodiskriminuese, operatorëve të tjerë që nuk disponojnë rrjet të vetin, por janë pajisur me licencë shërbimi programi (audio ose audiovizive), sipas pikave “a” dhe “b” më sipër.

Licencat do të kategorizohen në:

- a) kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak se 80% e territorit të vendit;
- b) rajonale, për mbulim deri në 4 qarqe me vazhdimësi gjeografike; dhe
- c) lokale, për mbulimin e një qarku.

Licencat e përmendura të shërbimeve të programeve do të jenë kombëtare, rajonale apo lokale në funksion të kategorisë së rrjetit tokësor (analog apo numerik), në të cilin do të mbështeten këto shërbime.

Për shërbimet programore që do të mbështeten në rrjete të ndryshme nga rrjetet tokësore (analoge apo numerike), pra nuk kërkojnë shfrytëzimin e burimeve të fundme natyrore, propozohet që të jepen pa konkurrim autorizime për shërbimin e programit audio dhe autorizime për shërbimin e programit audioviziv. Këto autorizime do të jenë:

- a) Satelitor, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor;
- b) Kabllor kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor;
- c) Shërbimi *on line*, kur shërbimi mbështetet në internet;
- d) Shërbimi teknik për sistemet e aksesit të kushtëzuar;



e) Ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

Propozimet e mësipërme janë në harmoni me klasifikimet e licencave në projektligjin e ri të medieve audiovizive të Shqipërisë.

2.8.2 Licencimi i rrjeteve dhe programeve të operatorit publik

Sipas një praktike të njohur botërore, televizioni publik nuk ka nevojë për licencë për ndërtimin e rrjetit/rrjeteve të tij numerik/e dhe programeve që mbështeten në to. KKRT-ja, bazuar në planin e frekuencave numerike, i akordon RTSH-së caktimet frekuencore për të ndërtuar deri në 2 rrjete numerike kombëtare. TVSH-ja do të ketë të drejtën të mbështesë edhe nga një program lokal në rrjetin e vet numerik ose në rrjetet numerike private lokale në zonat: Shkodër, Korçë, Gjirokastër dhe Kukës.

Programet që vlerësohen si programe që përmbushin misionin publik të RTSH-së, transmetohen hapur (free to air). Këto programe, pas një konsultimi publik, me propozim të operatorit publik, miratohen nga autoriteti kompetent i përcaktuar në ligj. Përveç programeve të vlerësuara si më sipër, RTSH-ja mund të ofrojë edhe programe me akses të kondicionuar për të konkurruar në tregun mediatic, në përputhje me disponibilitetin e vendeve të lira në platformë (rrjet), mundësive financiare dhe pas përfundimit të fazës së parë të procesit të digjitalizimit (pas mbylljes së transmetimeve analoge). Programet me akses të kushtëzuar nuk përfitojnë nga skema publike e financimit të RTSH-së. Financimi i tyre bëhet krejtësisht nga reklamat dhe abonentët e shërbimit me akses të kushtëzuar.

RTSH-ja, pas realizimit të një konsultimi publik, përgatit një kontratë të shërbimit të transmetimit publik, ku të përcaktojë parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta si transmetues publik, të cilën ia paraqet KKRT-së.

Kontrata e shërbimit të transmetimit publik duhet të parashikojë, veç të tjerash:

a) programet që do të mbështesë në rrjet/rrjetet e veta numerike, duke ndarë qartë programet e hapura (free to air) që do të transmetohen në përmbushje të misionit publik dhe programet me akses të kushtëzuar (nëse do të ketë);

b) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për të miturit;

c) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për shkencën dhe teknologjinë;

d) numrin e botimeve që duhet të përgatisë, të botojë dhe të shpërndajë në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik; dhe

e) përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve të regjistruara me zë e figurë në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik.

KKRT mund të nënshkruajë kontratën e shërbimit të transmetimit publik ose të kërkojë rishikimin e saj nga RTSH-ja. Në çdo rast duhet t'ia paraqesë atë komisionit për mjetet e informimit në Kuvend.

2.8.3 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të operatorëve privatë kombëtarë që mbështeten në to

Licencimi i rrjeteve numerike të transmetimit do të realizohet sipas përcaktimeve të seksionit 2.2 “Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë”, duke u dhënë prioritet ofruesve të përmbajtjes (ofruesve të shërbimeve mediatike).

KKRT-ja përcakton procedurat, kriteret, mënyrën dhe formën e përcaktimit të programeve kombëtare që do të mbështeten në 3 rrjetet numerike private kombëtare.

Programet analoge kombëtare ekzistuese do të vazhdojnë të transmetohen hapur edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.

Mbajtësit e licencave kombëtare, të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në jo më pak se 40% të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHM-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

Licencimi i rrjeteve të reja, pas realizimit të objektivit imediat do të realizohet bazuar në konkurrimin e kandidaturave, sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në rregulloren përkatëse të KKRT-së.

2.8.4 Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve të operatorëve rajonale e vendore (lokalë) që mbështeten në to

Në fazën e parë të digjitalizimit, operatorëve ekzistues të programeve televizive analoge private do t'u ofrohet mbështetja, kundrejt pagesës në rrjetin e parë (MUX 1) të operatorit publik.

Si një rrugë alternative në fazën e parë, operatorëve ekzistues lokalë që bëjnë pjesë në një allotment, mund t'u ofrohet pjesëmarrja në ndërtimin e rrjetit numerik lokal, duke krijuar një shoqëri të përbashkët. Vlerësimi i aplikimeve do të mbështetet në parimin e *beauty contest*-it.

Mbajtësit e licencave rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në jo më pak se 40% të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHM-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

Nëse operatorët lokalë të një allotmenti dështojnë të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi brenda një afati të përcaktuar nga KKRT-ja, kjo e fundit organizon garën për licencimin e rrjetit numerik dhe programeve të mbështetura në të allotmentit përkatës.

Licencimi i rrjeteve numerike rajonale dhe programeve të mbështetura në to, do të realizohet nëpërmjet garave që do të organizojë KKRT-ja.

2.9 Programet që mbështeten në rrjetet numerike

2.9.1. Programet e transmetuara hapur (free to air)

Transmetim pa pagesë (hapur) është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektivit që e siguron këtë shërbim.

Të gjitha programet që ofrojnë operatorët ekzistues analogë, përfshirë edhe transmetuesin publik, do të vazhdojnë të transmetohen hapur edhe në platformat numerike.

Për transmetuesin publik (kombëtar dhe rajonal) do të përcaktohet një numër minimal programesh që do të transmetohen hapur për të përmbushur misionin publik.

Licencimi i programeve shtesë, pas përfundimit të fazës së parë të digjitalizimit do të realizohet në përputhje me legjislacionit në fuqi.

2.9.2 Programet me akses të kushtëzuar

Akcesi në një formë të kuptueshme në shërbimet e mbrojtura të bëhet kundrejt një autorizimi individual paraprak.

Programet me akses të kushtëzuar gjatë fazës së implementimit të objektivit imediat, do të licencohen vetëm mbështetur në rrjetet private, në sasinë dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga KKRT-ja.

Ofrimi i shërbimeve me akses të kushtëzuar dhe shërbimet shoqëruese/mbështetëse të tyre realizohet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullat e nxjerra nga KKRT-ja. KKRT-ja, me anë të rregullave të nxjerra në zbatim të këtij ligji, siguron që shërbimet e mbrojtura të ofrohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

KKRT-ja ka të drejtë të imponojë detyrime për aksesin, ofruesit të shërbimeve me akses të kushtëzuar.

Ofruesit e shërbimit me akses të kushtëzuar janë të detyruar të sigurojnë akses në ndërfaqet/përshtatësit e programeve të aplikimit (API) ose në udhëzuesit elektronikë të programeve (EPG) në kushte të ndershme, jodiskriminuese dhe të përshtatshme.

KKRT-ja do të përcaktojë kushtet e funksionimit të pajisjeve të televizionit numerik të përdoruesve.

2.10 Futja e teknologjive e shërbimeve të reja mediatike

2.10.1 Futja e transmetimeve HD në rrjetet numerike tokësore



Në fazën e parë (mbyllja e transmetimeve analoge), për të siguruar mbështetjen e të gjitha programeve analoge ekzistuese në rrjetin e RTSH-së, standardi i transmetimit do të jetë SD (Standard definition), që do të thotë se cilësia e transmetimit do të jetë e kënaqshme, krahasuar me transmetimet analoge, por jo e lartë.

Licencimi i programeve me cilësi të lartë HD (High definition) do të fillojë në fazën e dytë, gjatë licencimit të rrjeteve e shërbimeve programore numerike private, kombëtare, rajonale dhe lokale, pasi në këtë fazë kapacitetet transmetuese do të jenë të tilla që të përballojnë kërkesat për shpejtësi të lartë transmetimi që kanë kanalet HD.

Në vendet e zhvilluara ekziston një opinion që në të ardhmen të gjitha programet do të jenë HD. Për këtë po punohet në dy drejtime:

- a) Planifikimi i mbulimeve shtesë në planin e frekuencave numerike (Francë); dhe
- b) Përmirësimi i teknologjisë së ndërtimit të rrjeteve (DVB-T2) (Mbretëria e Bashkuar).

2.10.2 Futja e transmetimeve televizive mobile (DVB-T H)

Në shumë vende janë bërë dhe po bëhen përpjekje për futjen e transmetimeve televizive të lëvizshme (mobile). Deri tani këto eksperimentime kanë rezultuar të pasuksesshme për shkak të karakterit specifik të biznesit. Dëshmi është edhe dështimi i këtij biznesi edhe në vendin tonë.

Në botë, përherë e më shumë po fiton terren ideja së ky biznes mund të zhvillohet me sukses nga operatorët e telefonisë mobile në brezat e frekuencave të caktuara për *broad band*.

Sidoqoftë në fazën e parë dhe të dytë të digjitalizimit nuk parashikohet licencimi i operatorëve DVB-T H.

2.10.3 Futja e shërbimeve të tjera (shërbimet interaktive etj.)

Shërbimet me zë dhe me zë e figurë sipas kërkesës janë shërbimet jolineare të ofruara nga ofruesi i shërbimit mediatik (OSHM) në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë të kërkesës së tij mbështetur në një katalog programi të ofruar për këtë qëllim nga OSHM-ja. Këto shërbime mund të mbështeten edhe në rrjetet numerike tokësore, kur kapacitetet e këtyre rrjeteve do ta lejojnë një gjë të tillë, pra pas fazës së parë të digjitalizimit. Transmetim jolinear është ofrimi i shërbimit të programit me zë dhe/ose me zë e figurë për marrje sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.

2.11 Strukturat për ndjekjen e procesit të digjitalizimit

2.11.1 Komiteti *ad hoc* dhe sekretariati teknik ndërinstucional për hartimin e strategjisë

Për hartimin e strategjisë dhe koordinimin e të gjithë procesit gjatë hartimit deri në miratimin e saj ka funksionuar:

- Komiteti *ad hoc* i mbështetur nga sekretariati teknik.

Komiteti *ad hoc* është ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 77, datë 2.6.2009 “Për ngritjen e komitetit *ad hoc* për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në digjitale”, i kryesuar nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.

Me urdhrin e Kryeministrit, nr. 159, datë 27.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 77, datë 2.6.2009 “Për ngritjen e komitetit *ad hoc* për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në digjitale”, u krijua sekretariati teknik me qëllim që të mbështesë punën e komitetit *ad hoc*. Ky sekretariat përbëhet nga 2 ekspertë të KKRT-së, dy ekspertë të RTSH-së dhe nga një ekspert për çdo institucion në përbërjen e komitetit *ad hoc*.

2.11.2 Krijimi i komitetit ndërinstucional për implementimin e strategjisë

Për implementimin e strategjisë dhe ndjekjen e të gjithë procesit deri në kalimin e plotë në transmetimet numerike krijohet komiteti ndërinstucional për implementimin e strategjisë.

Komiteti ndërinstucional është vazhdimësi e komitetit *ad hoc* dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin e veprimtarive lidhur me implementimin e strategjisë deri në mbylljen e transmetimeve analoge, si dhe propozimin e të gjitha vendimmarrjeve të nevojshme për realizimin në afat të këtij procesi tek organet kompetente. Komiteti ndërinstucional monitoron zbatimin e detyrave nga

institucionet përgjegjëse sipas planit të veprimit bashkëlidhur këtij dokumenti dhe propozon masat e duhura për përmbushjen e tyre. Komiteti ndërinstitucional i propozon qeverisë skemën e subvencionimit dhe njësinë administruese të kësaj skeme, komiteti ndërinstitucional miraton skemën e financimit për projektin e ndërtimit të rrjetit/rrjeteve të operatorit publik kombëtar dhe bën propozimin përkatës për realizimin e saj.

Komiteti ndërinstitucional do të udhëhiqet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe do të ketë në përbërje:

- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Drejtësisë;
- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrin e Turizmit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Kryetaren e KKRT-së;
- Kryetarin e AKEP-së;
- Kryetaren e AK-së;
- Drejtorin e përgjithshëm të RTSH-së.

Komiteti ndërinstitucional do të mbështetet nga sekretariati teknik. Ky sekretariat mund të zgjerohet me ekspertë të fushës së transmetimeve televizive, ekspertë të reklamave publicitare dhe ekspertë të Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Misioni i sekretariatit teknik do të jetë:

- Bashkëpunimi me institucionet, organet rregullatore të pavarura, shoqatat e medieve për ndjekjen e zbatimit të detyrave të ngarkuara për këto institucione;
- Bashkëpunimi me operatorët publikë e privatë, koordinimi i punës për zbatimin e ishujve numerikë;
- Informimi, shpjegimi dhe shoqërimi i telespektatorëve drejt kalimit të plotë në transmetimet numerike;
- Hartimin dhe propozimin të komiteti ndërinstitucional të planit të subvencionimeve dhe strukturës për administrimin e burimeve financiare dhe ndihmave (subvencioneve) për lehtësimin e kalimit në transmetime numerike, përfshirë fushatën sensibilizuese dhe edukimin e publikut.

Detyrat e kësaj strukture janë:

- Koordinimi në nivel teknik i punës për implementimin e planit të veprimit që i bashkëngjitet kësaj strategjie dhe raportimi periodik të komiteti ndërinstitucional;
- Ndjekja e implementimit të projektit për ndërtimin e rrjetit/rrjeteve të operatorit publik kombëtar;
- Të zhvillojë dhe të zbatojë një plan të qartë dhe të detajuar mirë lidhur me fazat e implementimit, për të përfunduar kalimin në transmetime televizive numerike brenda vitit 2015, si dhe për të arritur mbulimin me shërbim të të gjithë territorit të vendit;
- Menaxhimi i një programi informimi dhe edukimi, i cili i shpjegon procesin *switchover* të gjithë publikut, duke shpjeguar se çfarë duhet të bëjnë ata dhe si të marrin informacionin e nevojshëm (organizimin e fushatave sensibilizuese të përcaktuara me kosto). Mobilizimi i profesionistëve, të zgjedhurve dhe shoqatave të ndryshme në aktivitete për informimin e përdorimit të teknologjisë numerike;
- Organizojnë takime me grupe të interesit, si: operatorët, shitësit me pakicë, teknikë antenash, agjenci private dhe publike, institucione qeveritare dhe të koordinojë këto takime në mënyrë që ekspertiza e tyre të shërbejë në përfundimin e procesit brenda afatit;
- Ndjekja e planit të migrimit të frekuencave analoge për lirimin e spektrit të frekuencave për t'i hapur rrugë transmetimeve numerike;
- Ndjekja e implementimit të planit kombëtar të përdorimit të frekuencave numerike sipas specifikimeve të marrëveshjes GE 06, duke pasur parasysh lirimin e spektrit për dividendin digjital;



- Të ndjekë zbatimin e projektit të shërbimeve satelitore të destinuar për të kompensuar mbulimin me sinjal në zonat që nuk do të mbulohen me sinjal numerik;

- Mbështetja e konsumatorëve duke ofruar asistencë teknike për instalimin e pajisjeve, renditjen e programe dhe probleme të tjera që mund të lindin gjatë këtij procesi në koordinim me aktorët e tjerë.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë

Zhvillimi i një procesi monitorimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm të procesit të kalimit në transmetime numerike, do të jetë i domosdoshëm pasi do të shërbejë për arritjen në kohë të objektivit (brenda vitit 2015), si dhe përcaktimin e detyrave pas përfundimit të këtij procesi.

2.12 Kostot e digjitalizimit

2.12.1 Ndërtimi i rrjetit/rrjeteve të TVSH-së

2.12.1.1 Kostoja e ndërtimit të rrjetit kombëtar numerik të transmetuesit publik (RTSH-MUX 1)

Një vlerësim i koston së ndërtimit të rrjetit kombëtar të transmetuesit publik (RTSH) jepet në tabelën e mëposhtme (tabela 11). Vlerësimet janë bërë në bazë të investimeve të kërkuara për ndërtimin e një rrjeti bazë SFN, të tipit RN2 (Reference network 2) që parashikon instalimin e 3 transmetuesve kryesorë për çdo allotment. Duke marrë parasysh konfiguracionin e thyer të terrenit shqiptar, është parashikuar një numër minimal përsëritësish (3 copë për çdo allotment). Me këto të dhëna sigurohet mbulimi me sinjal i allotmenteve të veçanta në masën 60–70% të territorit ose 70–90% të popullsisë që jeton në këtë territor. Plotësimi i mbulimit do të realizohet në faza të mëvonshme.

Pasi është përcaktuar kostoja e përafërt e ndërtimit të rrjetit të një allotmenti, është llogaritur kostoja e ndërtimit të rrjetit numerik kombëtar duke shumëzuar me 11 (numri i allotmenteve) koston e një allotmenti. MUX 1 do të jetë një rrjet i kombinuar kombëtar/lokal. Për këtë arsye kostoja e ndërtimit të tij, do të jetë më e lartë se në rastin e ndërtimit të një rrjeti numerik thjesht kombëtar, pasi investimi përfshin edhe koston e *head end*-eve lokale.

Lidhja e *head end*-eve lokale me atë qendror është parashikuar të realizohet me sisteme mikrovalore dhe është futur në zërin sisteme fikse për lidhjen e MUX -eve me transmetuesit, pasi do të shfrytëzohen të njëjtat pika transmetimi. Nuk përjashtohet lidhja e tyre me sisteme kabllore me fibra optike (sidomos për *back bone* - rrjetin kryesor).

Çmimet referencë janë marrë me përfrime nga tregu dhe nuk ekziston siguria që janë të sakta. Theksojmë se vlera e saktë do të përcaktohet nga procesi i prokurimit, i cili do të realizohet bazuar në specifikime teknike të përshkruara nga projekti teknik. Vlerësimet e mëposhtme kanë vetëm karakter orientues.

Rrjeti numerik (RN2)

Emërtimi i pajisjeve	Çmimi (€)	Sasia	Vlefte (€)
1. Pajisje qendrore			
1.1 Sisteme fikse (link) për lidhjen e studiove me MUX (8)	15000	8	120000
1.2 Encoder	16000	1	16000
1.3 Multipleks statistikor	20000	1	20000
1.4 NMS (Network management system)	20000	1	20000
Totali 1			176000
2. Sisteme fikse për lidhjen e MUX me transmetuesit			
2.1 Link 51 Mbps	40000	3	120000
2.2 Përsëritës (min 3)	10000	3	30000
Totali 2			150000

3. Sistemi i transmetimit			
3.1 Transmetuesit (3)	50000	3	150000
3.2 Sistemi i antenave (3)	5000	3	15000
3.3 Përsëritës (gap filler)	20000	3	60000
Totali 3			225000
4. Të tjera (Kulla, Mot gen, ambiente)	40000	3	120000
TOTALI (1+2+3+4)			671000
PUNIMET			400000
Investimi total për allotment			1071000
Investimi total/program për allotment			66937.5

Tabela 11. Kostoja e ndërtimit të rrjetit numerik të 1 allotmenti

Kostoja për ndërtimin e rrjetit kombëtar

Në mënyrë të përafëruar investimi për ndërtimin e rrjetit numerik kombëtar përcaktohet si produkti i investimit për 1 allotment me numrin e allotmenteve (11)

Rezultati jepet në tabelën më poshtë (tabela 12)

Emërtimi	Lekë	Euro
Investimi total për një rrjet kombëtar	1 531 530 000	11 781 000
Investimi total/program kombëtar	95 720 625	736 312.5

Tabela 12

Duke shtuar shpenzimet për *head end*-et në qendrat e allotmenteve, kostoja për ndërtimin MUX 1 është:

Emërtimi	Lekë	Euro
Investimi total	1 837 836 000	14 137 200

Tabela 13. Kostoja e ndërtimit të rrjetit numerik kombëtar (11 allotmente)

Kostoja për ndërtimin e 2 rrjeteve kombëtare

Ndërtimi i rrjetit të dytë të RTSH-së do të kushtojë më pak se rrjeti i parë, për arsye se nuk ka nevojë të ndërtohen *head end*-et në qendrën e allotmenteve.

Me përafërsi, rrjeti i dytë do të kushtojë: 1 225 224 000 lekë ose 9 424 800 euro

Në total, ndërtimi i të dy rrjeteve do të kushtojë:

Emërtimi	Lekë	Euro
Investimi total për dy rrjete kombëtare	3 369 366 000	25 919 000

Tabela 14

Shënim. Vlerësimet e kostimit për një rrjet numerik kombëtar, si dhe ato për një allotment vlejné edhe për një operator privat, duke pasur parasysh arsyetimin teknik për mbulimin e terrenit dhe gjeografinë e territorit shqiptar.

2.12.1.2 Digjitalizimi i rrjetit të tv publik (MUX 1+MUX 2)

Ndërtimi i MUX 1 do të jetë baza ku do të mbështetet digjitalizimi i transmetimeve televizive në Shqipëri. MUX 2 do të përdoret nga RTSH-ja. Një sfidë serioze përbën financimi i ndërtimit të këtij rrjeti. Ndërtimi i rrjetit allotment pas allotmenti i zbut kërkesat për financime, ndërsa zgjat kohën e kalimit të plotë në transmetimet numerike. Varianti i paraqitur i afateve të implementimit parashikon ndarjen e investimeve në tre vjet, që e lehtëson financimin e ndërtimit.

Fondet e nevojshme sipas viteve, jepen nga tabela e mëposhtme:

Viti	2012		2013		2014		2015		Totale
Intervali kohor	6 Muj 1	6 Muj 2	6 Muj 1	6 Muj 2	6 Muj 1	6 Muj 2	6 Muj 1	6 Muj 2	
Leke	561561000	561561000	561561000	561561000	561561000	561561000	561561000	561561000	3369366000
Euro	4319833.3	4319833.33	4319833.3	4319833.33	4319833.33	4319833.3	4319833.3	4319833.3	25919000

Tabela 15



Në fund, pas disa rregullimeve që kanë të bëjnë me natyrën e investimit, kërkesat për financim sipas viteve paraqiten si më poshtë:

2012	Lekë	780 000 000
	Euro	6 000 000
2013	Lekë	1 170 000 000
	Euro	9 000 000
2014	Lekë	1 170 000 000
	Euro	9 000 000
2015	Lekë	2 49 470 000
	Euro	1 919 000
Totali	Lekë	3 369 470 000
	Euro	25 919 000

Tabela16

Shënim. Në llogaritjet e mësipërme nuk është marrë parasysh kostoja e kapitalit.

2.12.2 Subvencionimi i dekoderave

Që të realizohet plani i mësipërm i kalimit të plotë në transmetime numerike, krahas ndërtimit të rrjeteve duhet planifikuar pajisja e audiencës me marrës numerikë ose dekoder që bëjnë të mundur përdorimin e marrësve ekzistues analogë edhe për marrjen e sinjaleve numerike. Dekoderat që duhen planifikuar janë të sistemit të kompresionit MPEG 4. Ndërkohë, në përdorim janë hedhur dekoderat MPEG 2 për marrjen e sinjaleve numerike të operatorëve privatë ekzistues. Përfundimisht, në planifikimin e nevojave për dekoder, duhet marrë parasysh pajisja me ta e 100% të familjeve. Nevojat për dekoder janë sjellë në tabelën 17 më poshtë:

Nr.	Zona	Allotment	Popullsia	Popullsia %	Familje	Nevojat, copë
1	Q. Tiranë – Durrës	AL005D	1389474	32.71	347369	347369
2	Qarku i Fierit	AL007D	487970	11.48	97594	97594
3	Qarku i Elbasanit	AL006D	424360	9.99	106090	106090
4	Qarku i Lezhës	AL004D	211234	5.00	52809	52809
5	Qarku i Shkodrës	AL001D	332214	7.82	83054	83054
6	Qarku i Vlorës	AL011D	371277	8.74	92819	92819
7	Qarku i Korçës	AL009D	352452	8.29	88113	88113
8	Qarku i Beratit	AL008D	232383	5.47	6281	6281
9	Qarku i Dibrës	AL003D	179291	4.22	44823	44823
10	Qarku i Gjirokastrës	AL010D	157386	3.70	39347	39347
11	Qarku i Kukësit	AL002D	109385	2.58	27346	27346
	Territori i Shqipërisë		4247426	100.00	985643	985643

Tabela 17. Nevojat për dekoderat

Shënim. Të dhënat e tabelës së mësipërme mund të rishikohen pas shpalljes së rezultateve të censusit.

Planifikimi i nevojave për dekoder do të bëhet në përputhje me ndërtimin e “ishujve digjitalë” të renditur në tabelën e mësipërme. Subvencionimi do të bëhet vetëm për dekoderat që garantojnë përdorimin e të ashtuquajturës “ndërfaqe e përbashkët” siç përcaktohet në seksionin 2.6.4 të këtij dokumenti.

Është e dëshirueshme që transmetimet analoge në një zonë të caktuar të mbyllen pasi e gjithë

popullsia (ose pjesa më e madhe e saj) të jetë pajisur me marrës numerikë. Duke ditur se jo të gjitha familjet janë në gjendje të sigurojnë dekoder brenda afateve që do të përcaktohen për ndërtimin e “ishujve numerikë”, duhet të parashikohet subvencioni për një pjesë (apo për të gjithë) të popullsisë. Tabela 18 jep vlera orientuese të shpenzimeve të nevojshme për disa skema subvencioni (100%, 50% dhe 7%). Shifra e fundit është numri i familjeve në nevojë).

Nr.	Zona	Allotmenti	Popullsia	Popullsia	Familje	Fondet e nevojshme (Euro)		
						100%	50%	7%
1	Q. Tirane -	AL005D	1389474	32.71	347369	10421055	5210528	729480
2	Qarku i Fierit	AL007D	487970	11.48	97594	2927820	1463910	204960
3	Qarku i Elbasanit	AL006D	424360	9.99	106090	3182700	1591350	222780
4	Qarku i Lezhës	AL004D	211234	5	52809	1584255	792128	110910
5	Qarku i Shkodrës	AL001D	332214	7.82	83054	2491605	1245803	174420
6	Qarku i Vlorës	AL011D	371277	8.74	92819	2784578	1392289	194910
7	Qarku i Korçës	AL009D	352452	8.29	88113	2643390	1321695	185040
8	Qarku i Beratit	AL008D	232383	5.47	6281	188419	94209	13200
9	Qarku i Dibrës	AL003D	179291	4.22	44823	1344683	672341	94140
10	Qarku i Gjirokastrës	AL010D	157386	3.7	39347	1180395	590198	82620
11	Qarku i Kukësit	AL002D	109385	2.58	27346	820388	410194	57420
	Territori i Shqipërisë		4247426	100	985643	29569286	14784643	2069880

Tabela 18. Fonde të nevojshme për skema të ndryshme subvencioni (euro)

Nr.	Zona	Allotmenti	Popullsia	Përqindja e popullsisë	Familje	Fondet e nevojshme (lekë)		
						100%	50%	77%
1	Q. Tiranë - Q. Durrës	AL005D	1389474	32.71	347369	1354737150	677368575	94831601
2	Qarku i Fierit	AL007D	487970	11.48	97594	380616600	190308300	26643162
3	Qarku i Elbasanit	AL006D	424360	9.99	106090	413751000	206875500	28962570
4	Qarku i Lezhës	AL004D	211234	5.00	52809	205953150	102976575	14416721
5	Qarku i Shkodrës	AL001D	332214	7.82	83054	323908650	161954325	22673606
6	Qarku i Vlorës	AL011D	371277	8.74	92819	361995075	180997538	25339655
7	Qarku i Korçës	AL009D	352452	8.29	88113	343640700	171820350	24054849
8	Qarku i Beratit	AL008D	232383	5.47	6281	24494424	12247212	1714610
9	Qarku i Dibrës	AL003D	179291	4.22	44823	174808725	87404363	12236611
10	Qarku i Gjirokastrës	AL010D	157386	3.70	39347	153451350	76725675	10741595
11	Qarku i Kukësit	AL002D	109385	2.58	27346	106650375	53325188	57427
	Territori i Shqipërisë		4247426	100.00	985643	3844007199	1922003600	261672405

Tabela 19. Fonde të nevojshme për skema të ndryshme subvencioni (lekë)

Shënime:

1. Përbërja mesatare familjare është marrë: Persona 4
2. Përqindja e familjeve në nevojë: 7%¹
3. Çmimi i një dekoderi është supozuar: (€) 30

Dekoderat që do të subvencionohen duhet të jenë universalë dhe duhet të kenë karakteristikat bazë për të siguruar marrjen e sinjaleve standarde TV.

2.12.3 Kostot e informimit të publikut për digjitalizimin

1. Spote sensibilizuese publicitare

¹ Përqindja e familjeve në nevojë është përcaktuar nga numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike, që aktualisht kapin shifrën 99000 të shpërndarë në gjithë Shqipërinë.



2. Emisione speciale
3. Njoftime
4. Anketime të publikut

Kostot e informimit të publikut, vjetore	L. 183 350 760. 00
	Euro 1 348 168.00

1. Shpenzimet për spotet e digjitalizimit

Subjektet	Lekë/spot	Nr. i subjekteve	Spote në ditë	Spote në vit	Shuma (Lekë)	Shuma (Euro) (€)
TV kombëtar	13600	3	12	4380	59568000	
Radio kombëtare	6800	3	12	4380	29784000	
Tv lokal (Tiranë)	8160	20	8	2920	23827200	
Tv lokal	2720	60	10	3650	9928000	
Radio lokale (Tiranë)	2040	35	10	3650	7446000	
Radio lokale	680	30	8	2920	1985600	
Totali					132538800	974550

Tabela 20. Shpenzimet për spotet e digjitalizimit

2. Shpenzimet për emisionet speciale

Subjektet	Nr. i emisioneve në vit	Vlefte për emision	Shuma (lekë)	Nr. i subjekteve	Shuma (lekë)	Shuma (euro)
Televizionet Kombëtare	12	100000	1200000	3	3600000	
Televizionet Lokale	6	50000	300000	80	24000000	
Radiot Kombëtare	8	60000	480000	3	1440000	
Radiot Lokale	4	30000	120000	65	7800000	
Totali			2100000		36840000	270882.3529

Tabela 21. Shpenzimet për emisionet speciale

3. Shpenzimet për njoftime

Subjektet	Nr. i njoftimeve për allotment	Nr. i subjekteve	Allotmente	Shuma e njoftimeve	Çmimi i njoftimeve	Shuma
Televizionet kombëtare	450	3	11	14850	1360	20196000
Televizionet lokale	270	8	1	2160	680	1468800
Radiot Kombëtare	450	3	11	14850	408	6058800
Radiot lokale	270	6	1	1620	136	220320
Totali Lekë				33480		27943920
Totali Euro						214953.23

Tabela 22. Shpenzimet për njoftime

Shënim. Njoftimi do të fillojë ditë për ditë 3 muaj para kalimit të çdo allotmenti.

Njoftimi do të bëhet në mediet lokale (allotmenti përkatës) dhe kombëtare.

Shpenzimet për njoftimin përmes spoteve publicitare sipas tabelave të mësipërme mund të reduktohen nëse operatorët televizivë transmetojnë spotet dhe njoftimet përkatëse falas ose me tarifa të reduktuara.

4. Anketime të publikut

Për anketimin e publikut nuk janë përcaktuar nevojat për financime.

2.12.4 Kostot për aktivitetet e komitetit ndërinstitucional dhe sekretariatit teknik

Për përmbushjen e aktiviteteve të parashikuara në seksionin 2.11.2 të komitetit ndërinstitucional dhe sekretariatit teknik vlerësohen rreth 57.000.000 lekë për vitin e parë dhe rreth 40.000.000 lekë/vit për vitet pasardhëse.

2.13 Propozimet për përmirësimin e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor në fuqi për transmetimet radiotelevizive përfshin:

- Ligjin nr. 8410 datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligjin nr. 9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”.

Me legjislacionin në fuqi, ky dokument do të kërkonte:

- Amendime për përcaktimin e datës së re të mbylljes së transmetimeve numerike;

- Amendimin e mënyrës së licencimit të rrjeteve numerike kombëtare dhe programeve radio e televizive të mbështetura mbi to;

- Amendimin e ligjit në lidhje me mënyrën e licencimit të rrjeteve numerike lokale dhe programeve radio e televizive të mbështetura mbi to, si dhe rregullimin e veprimtarisë së transmetimeve numerike ekzistuese të palicencuara.

Mënyrat e licencimit dhe të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike dhe masat transitorie të paraqitura në dokument janë në harmoni me parashikimet në projektligjin “Për mediet audiovizive”.

III. IMPLEMENTIMI I OBJEKTIVIT IMEDIAT

Mbyllja e transmetimeve analoge

Për lehtësimin e kalimit të plotë në transmetimet numerike, procesi do të organizohet sipas fazave të përshkruara më poshtë:

3.1. Ndërtimi i rrjetit numerik të operatorit publik

MUX 1: Rrjet publik kombëtar (figura 2)



Figura 2. MUX 1 Rrjeti numerik i RTSH-së

Konfiguracioni:

Rrjet i kombinuar (kombëtar dhe lokal) i përbërë nga:

MUX 1.1 - Rrjet SFN Shkodër. *Head end* në Shkodër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL001 D të Shkodrës (GE 06).

MUX 1.2 - Rrjet SFN Kukës. *Head end* në Kukës. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL002 D të Kukësit (GE 06).

MUX 1.3 - Rrjet SFN Dibër. *Head end* në Dibër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL003 D të Dibrës (GE 06).

MUX 1.4 - Rrjet SFN Lezhë. *Head end* në Lezhë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL004 D të Lezhës (GE 06).

MUX 1.5 - Rrjet SFN Tiranë. *Head end* qendror në Tiranë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL005 D të Tiranës (GE 06).

MUX 1.6 - Rrjet SFN Elbasan. *Head end* në Elbasan. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL006 D të Elbasanit (GE 06).

MUX 1.7 - Rrjet SFN Fier. *Head end* në Fier. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL007 D të Fierit (GE 06).

MUX 1.8 - Rrjet SFN Berat. *Head end* në Berat. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL008 D të Beratit (GE 06).

MUX 1.9 - Rrjet SFN Korçë. *Head end* në Korçë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL009 D të Korçës (GE 06).

MUX 1.10 - Rrjet SFN Gjirokastrë. *Head end* në Gjirokastrë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL010D të Gjirokastrës (GE 06).

MUX 1.11 - Rrjet SFN Vlorë. *Head end* në Vlorë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL011D të Vlorës (GE 06).

Shënim

- Në qytetin kryesor të secilit prej allotmenteve do të instalohet një *head end* nën administrimin e RTSH-së, ku do të hyjnë të gjitha programet lokale, përfshirë edhe programet lokale të televizionit publik. RTSH-së i bie detyra që të sigurojë ambiente të përshtatshme për instalimin e *head end*-eve në të gjitha qendrat e qarqeve. Instalimi i *head end*-eve në qendrat e allotmenteve (gjithsej 11 *head end*-e) vlerësohet se do të rrisë investimet për ndërtimin e rrjetit të parë tokësor numerik të RTSH-së në masën 15-20% në krahasim me vlerën e llogaritur në tabelën 11. (Kostoja e ndërtimit të rrjetit numerik kombëtar.) Lidhja e *head end*-it me studiot e operatorëve lokalë do të realizohet nga këta të fundit.

- Të gjitha *head end*-et lokale (të allotmenteve) do të lidhen me *head end*-in qendror të RTSH-së në Tiranë për të mundësuar shpërndarje kombëtare të dy apo më shumë programeve të operatorit publik.

Konceptimi si bashkësi e 11 MUX -eve bën të mundur mbështetjen në rrjetin kombëtar të transmetuesit publik edhe të programeve lokale të veta dhe private (shih figurën 2).

Teknologjia e ndërtimit të rrjetit do të përcaktohet e njëjtë me rrjetet e tjera numerike që do të ndërtohen në Shqipëri. Ajo do të zgjidhet ndër arritjet e fundit që lejojnë shfrytëzimin maksimal të spektrit të frekuencave.

Ndërtimi do të kryhet sipas rendit dhe afateve të përcaktuara allotment pas allotmenti (metoda e ishujve numerikë) deri në mbulimin e plotë të territorit shqiptar (11 allotmente). Rendi i implementimit të ishujve numerikë dhe afatet do të miratohen nga komiteti *ad hoc* për strategjinë e kalimit në transmetimet numerike.

Në MUX 1 do të mbështeten të paktën 3 programe kombëtare të operatorit publik dhe kundrejt pagesës, të gjitha programet private lokale ekzistuese të licencuara nga KKRT-ja që përfshijn allotmenti i dhënë.

Të gjitha programet që do të mbështeten në këtë rrjet do të transmetohen hapur (pa pagesë) për publikun.

Me përfundimin e ndërtimit të rrjetit në një allotment të caktuar, pas një periudhe të shkurtër prove (1 muaj), transmetimet analoge të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë që mbulojnë zonën e allotmentit përkatës, do të mbyllen.

Për realizimin e mbylljes së transmetimeve analoge në zonën Tiranë-Durrës dhe qarkun e Vlorës, ku numri i operatorëve lokalë analogë ekzistues e tejkalon kapacitetin e rrjetit numerik, do të vendosen detyrime (qoftë edhe të përkohshme) për operatorët privatë kombëtarë duke përcaktuar një numër minimal programesh të transmetuara hapur (pa pagesë për publikun) për këtë qëllim. Këto programe do të mbështeten në rrjetet private me të njëjtat kushte (përfshirë kushtet ekonomike), si dhe programet që do të mbështeten në rrjetin e operatorit publik.

Subvencioni i dekoderave do të realizohet në përputhje me planin e implementimit, duke llogaritur kohën e nevojshme për t'i paraprirë afatit të mbylljes së transmetimeve analoge.

3.2. Ndërtimi i rrjeteve numerike private kombëtare

Ndërtimi i rrjeteve numerike private kombëtare do t'i shërbejë njëkohësisht si përmbushjes së objektivit imediat (kalimi i plotë në transmetimet numerike), ashtu dhe plotësimit të objektivave të tjerë kryesorë që janë:

- a) Ofrimi i kapaciteteve shtesë për rritjen e shumëllojshmërisë e pluralizmit të programeve;
- b) Futja e teknologjive e shërbimeve të reja mediatike (HD TV, DVBT H, shërbimet interaktive etj.).

3. 2.1 MUX 3: Rrjet numerik privat kombëtar




Figura 3. MUX 3, MUX 4, MUX 5 - Rrjetet numerike private kombëtare

Konfiguracioni:

Rrjet 11 SFN me një *head end office* në Tiranë;

SFN 3.1 Shkodër;

SFN 3.2 Kukës;

SFN 3.3 Dibër;

SFN 3.4 Lezhë;

SFN 3.5 Tiranë;

SFN 3.6 Elbasan;

SFN 3.7 Fier;

SFN 3.8 Berat;

SFN 3.9 Korçë;
SFN 3.10 Gjirokastrë;
SFN 3.11 Vlorë.

Frekuencat e SFN-ve përcaktohen nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin përkatës (GE 06).

Licencimi nga KKRT-ja bëhet sipas përcaktimeve në seksionin 2.3 dhe 2.8.3.

3.2.2 MUX 4: Rrjet privat kombëtar

- Konfiguracioni:

Rrjet 11 SFN me një *head end office* në Tiranë;

SFN 4.1 Shkodër;

SFN 4.2 Kukës;

SFN 4.3 Dibër;

SFN 4.4 Lezhë;

SFN 4.5 Tiranë;

SFN 4.6 Elbasan;

SFN 4.7 Fier;

SFN 4.8 Berat;

SFN 4.9 Korçë;

SFN 4.10 Gjirokastrë;

SFN 4.11 Vlorë.

Frekuencat e SFN-ve përcaktohen nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin përkatës (GE 06).

Licencimi nga KKRT-ja sipas përcaktimeve në seksionin 2.3 dhe 2.8.3 më sipër.

3.2.3 MUX 5: Rrjet privat kombëtar

- Konfiguracioni:

Rrjet 11 SFN me një *head end office* në Tiranë;

SFN 5.1 Shkodër;

SFN 5.2 Kukës;

SFN 5.3 Dibër;

SFN 5.4 Lezhë;

SFN 5.5 Tiranë;

SFN 5.6 Elbasan;

SFN 5.7 Fier;

SFN 5.8 Berat;

SFN 5.9 Korçë;

SFN 5.10 Gjirokastrë;

SFN 5.11 Vlorë.

Frekuencat e SFN-ve përcaktohen nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin përkatës (GE 06).

Licencimi nga KKRT-ja. Nëse dështon licencimi i operatorëve ekzistues sipas parimit *beauty contest*, KKRT-ja organizon konkurrimin e kandidatuarave.

MUX 3, MUX 4 dhe MUX 5 mund të licencohen sipas një grafiku të përcaktuar ose njëkohësisht.

- Programet

Programet që do të mbështeten në rrjetet private kombëtare do të licencohen nga KKRT-ja.

Gjatë licencimit KKRT-ja mban parasysh raportet e caktuara nga ligji për programet e transmetuara hapur dhe atyre të krijuara. Një program i licencuar nga KKRT-ja do të konsiderohet lokal, rajonal apo kombëtar në varësi të rrjetit ku mbështetet (lokal, rajonal apo kombëtar).

Operatorëve privatë kombëtarë mund t'u caktohen detyrime për mbështetjen e një numri të



kufizuar programesh të operatorëve ekzistues, analogë, lokalë (sidomos të zonës Tiranë-Durrës). Transmetimi i programeve të operatorëve ekzistues lokalë do të realizohet në të njëjtat kushte dhe me të njëjtat pagesa, si dhe programet që do të mbështeten në rrjetin e operatorit publik.

IV. FUTJA E TEKNOLOGJIVE TË SHËRBIMEVE TË REJA MEDIATIKE (HD TV, DVBT H, SHËRBIMET INTERAKTIVE ETJ.)

OFRIMI I KAPACITETEVE SHITESË PËR RRITJEN E SHUMËLLOJSHMËRISË SË PLURALIZMIT TË PROGRAMEVE

4.1. Zgjerimi i kapaciteteve transmetuese të operatorit publik

4.1.1 MUX 2: Rrjet publik kombëtar

4.1.2 Konfiguracioni

Rrjet 11 SFN me një *head end office* në Tiranë, i përbërë nga SFN 2.1 Shkodër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL001 D të Shkodrës (GE 06).

SFN 2.2 Kukës. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL002 D të Kukësit (GE 06).

SFN 2.3 Dibër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL003 D të Dibrës (GE 06).

SFN 2.4 Lezhë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL004 D të Lezhës (GE 06).

SFN 2.5 Tiranë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL005 D të Tiranës (GE 06).

SFN 2.6 Elbasan. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL006 D të Elbasanit (GE 06).

SFN 2.7 Fier. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL007 D të Fierit (GE 06).

SFN 2.8 Berat. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL008 D të Beratit (GE 06).

SFN 2.9 Korçë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL009 D të Korçës (GE 06).

SFN 2.10 Gjirokastër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL010D të Gjirokastrës (GE 06).

SFN 2.11 Vlorë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL011D të Vlorës (GE 06).

Zgjerimi i kapaciteteve transmetuese të operatorit publik do të fillojë pas përfundimit të ndërtimit të rrjetit të parë (në përfundim të kalimit të plotë në transmetimet numerike) dhe përcaktimit të numrit optimal të programeve që do të konsiderohen të vlefshme për të përmbushur misionin e operatorit publik. Në këtë fazë do të përcaktohen nevojat për shërbimet e reja të operatorit publik (HD, shërbimet interaktive etj.).

Ndërtimi i MUX 2 mund të zbatohet pjesërisht për rajonin Tiranë-Durrës qysh në fazën e parë (shih pikën “a”), për të plotësuar kapacitetet e MUX 1 për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues.

4.2 Ndërtimi i rrjeteve private lokale

4. 2.1 - 11 MUX -e lokale (MUX 6.1 deri në MUX 6.11)



Figura 4. MUX 6.1 deri 6.11 - Rrjetet numerike private lokale

b) Konfiguracioni

Head end-i në qendër të çdo allotmenti.

MUX 6.1 - Rrjet SFN Shkodër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL001 D të Shkodrës (GE 06).

MUX 6.2 - Rrjet SFN Kukës. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL002 D të Kukësit (GE 06).

MUX 6.3 - Rrjet SFN Dibër. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL003 D të Dibrës (GE 06).

MUX 6.4 - Rrjet SFN Lezhë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL004 D të Lezhës (GE 06).

MUX 6.5 - Rrjet SFN Tiranë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL005 D të Tiranës (GE 06).

MUX 6.6 - Rrjet SFN Elbasan. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL006 D të Elbasanit (GE 06).

MUX 6.7 - Rrjet SFN Fier. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL007 D të Fierit (GE 06).

MUX 6.8 - Rrjet SFN Berat. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL008 D të Beratit (GE 06).



MUX 6.9 - Rrjet SFN Korçë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL009 D të Korçës (GE 06).

MUX 1.10- Rrjet SFN Gjirokastrë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL010D të Gjirokastrës (GE 06).

MUX 6.11 - Rrjet SFN Vlorë. Frekuenca e SFN-së përcaktohet nga KKRT-ja bazuar në planin e frekuencave numerike për allotmentin AL011D të Vlorës (GE 06).

Licencimi nga KKRT-ja nëpërmjet konkurrimit të kandidaturave. Operatorët ekzistues analogë, të licencuar nga KKRT-ja mund të marrin një licencë lokale, nëse lidhin një marrëveshje midis tyre për ndërtimin dhe shfrytëzimin e rrjetit lokal sipas përcaktimeve në seksionin 2.4 dhe 2.8.4.

Programet që do të mbështeten në rrjetet private lokale do të licencohen nga KKRT-ja.

Gjatë licencimit KKRT-ja mban parasysh raportet e caktuara nga ligji për programet e transmetuara hapur dhe atyre të krijuara. Nëse një program mbështetet në më shumë se një rrjet (përfshirë edhe rrjetet kabllorë apo satelitore) kategoria e tij (lokale, rajonale apo kombëtare) përcaktohet nga rrjeti që ka shtrirje më të madhe gjeografike.

4.3. Operatorët rajonalë

4.3.1 Operatorë rajonalë të rrjetit numerik

Operatorët rajonalë të rrjeteve numerike do të licencohen nga KKRT-ja për të mbuluar mbi një qark. Numri i tyre dhe zonat përkatëse të licencimit përcaktohen nga KKRT-ja pas vlerësimit të nevojave të tregut mediatik. Pas përcaktimit të numrit të operatorëve, KKRT-ja organizon konkurrimin e kandidaturave për ndërtimin e rrjeteve rajonale. Për ndërtimin e operatorëve rajonalë rekomandohet përdorimi i frekuencave të brezit VHF, që bëjnë pjesë në planin kombëtar të frekuencave numerike (GE 06).



Figura 5. MUX 8.1 deri 8.8 - Rrjetet numerike private rajonale

Konfiguracioni

Rrjete SFN, 2 SFN ose 3 SFN me *head end*-e të instaluara në qendër të rajonit.

Emërtimi MUX 8.1, MUX 8.2 etj.

4.3.2 Operatorë programesh rajonale (ofrues rajonal i shërbimeve audiovizuale)

Në rrjetet numerike rajonale mund të mbështeten programe rajonale.

Programet që do të mbështeten në rrjetet private lokale do të licencohen nga KKRT-ja.

Gjatë licencimit KKRT-ja mban parasysh raportet e caktuara nga ligji për programet e transmetuara hapur dhe atyre të krijuara. Nëse një program mbështetet në më shumë se një rrjet (përfshirë edhe rrjetet kabllore apo satelitore) kategoria e tij (lokale, rajonale apo kombëtare) përcaktohet nga rrjeti që ka shtrirje më të madhe gjeografike.

V. RENDI I IMPLEMENTIMIT

5.1 Faza I

5.1.1 Ndërtimi i MUX 1

5.1.1.1 Grafiku i ndërtimit

Ndërtimi i rrjetit numerik të tv kombëtar, në varësi të disponibilitetit të financimeve, mund të planifikohet të realizohet në një apo disa vite. Përdorimi i metodës së ishujve numerikë lejon të planifikohet ndërtimi me faza i kombinuar me mbylljen e transmetimeve analoge. Kjo metodë, ka avantazh se racionalizon investimet dhe realizon mbylljen e përshkallëzuar të transmetimeve analoge.

Mbulimi me sinjal numerik i territorit, në fazën e parë të implementimit do të synohet të jetë më i madh ose i barabartë me mbulimin me sinjal analog nga secili operator ekzistues analog.

Në fazën e parë do të synohet që mbulimi me sinjal numerik të jetë mbi 90% të popullsisë.

5.1.1.2 Afatet e digjitalizimit

Kalimi në transmetimet numerike do të jetë më i ngadalshëm se ndërtimi i vetë rrjetit MUX 1, pasi përgatitja e publikut, informimi dhe pajisja e tij me dekoder, do të kërkojnë kohën e duhur.

Tabela e mëposhtme (tabela 23) paraqet një variant të llogaritjes së kohës për kalimin e plotë në transmetimet numerike të një allotmenti të caktuar. Kjo tabelë nuk merr parasysh kohën e prokurimit të ndërtimit të rrjetit që mund të zgjasë 4 deri në 6 muaj.

Koha e ndërtimit të rrjetit (muaj)	Testimi i rrjetit (muaj)	Transferimi në plat. numerike (muaj)	Mbyllje e transmetimeve analoge (muaj)
2	1	1	2

Tabela 23. Afatet e digjitalizimit

1. Koha e ndërtimit është koha e nevojshme për realizimin teknik të rrjetit dhe përfshin përshtatjen e ambienteve dhe kullave ekzistuese në pikat ekzistuese të transmetimit, instalimin e transmetuesve kryesorë (main transmitters) dhe sistemeve përkatës r/rele etj.

2. Testimi është koha për kryerjen e provave e testeve të ndryshme për performancën e rrjetit të ndërtuar dhe dorëzimin e tij për shfrytëzim.

3. Transferimi në platformën numerike është koha e nevojshme për mbështetjen e operatorëve analogë ekzistues në platformën numerike, pa ndërprerë transmetimet analoge nëpërmjet rrjeteve të tyre analoge ekzistuese.

4. Mbyllja e transmetimeve analoge është koha e nevojshme për ndërprerjen e transmetimeve analoge në allotmentin e caktuar. Për realizimin e këtij procesi është e domosdoshme pajisja e të gjithë teleshikuesve me marrës numerikë (dekoder ose marrës tv me dekoder të inkorporuar), në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e marrjes së programeve që më parë merreshin në mënyrë analoge.

Bazuar në afatet e digjitalizimit, është ndërtuar tabela 24 e cila paraqet afatet e kalimit në transmetime numerike të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, allotment pas allotmenti. Në



tabelë gjithashtu është paraqitur edhe propozimi për rendin e kalimit në transmetime numerike, duke filluar nga Tirana. Siç shihet kriteri i rendit të ndërtimit është përqindja e popullsisë (digjitalizimi fillon nga zona me popullsi më të madhe, Tiranë-Durrës dhe përfundon në zonën me popullsi më të vogël, Kukës).

Nr.	Zona	Popullsia (%)	Familje	Mbulimi (% e popullsisë)	Implementimi i ishujve digjitalë				
					Fillimi, muaj	Mbarimi, muaj	Testimi, muaj	Transferimi, muaj	Mbyllja e transmetimeve analoge
1	Q. Tiranë – Q. Durrës	32.71	347369	85	0	2	3	4	6
2	Qarku i Fierit	11.48	97594	85	3	5	6	7	9
3	Qarku i Elbasanit	9.99	106090	85	6	8	9	10	12
4	Qarku i Lezhës	5	52809	85	9	11	12	13	15
5	Qarku i Shkodrës	7.82	83054	85	12	14	15	16	18
6	Qarku i Vlorës	8.74	92819	85	15	17	18	19	21
7	Qarku i Korçës	8.29	88113	85	18	20	21	22	24
8	Qarku i Beratit	5.47	6281	85	21	23	24	25	27
9	Qarku i Dibrës	4.22	44823	85	24	26	27	28	30
10	Qarku i Gjirokastrës	3.7	39347	85	27	29	30	31	33
11	Qarku i Kukësit	2.58	27346	85	30	32	33	34	36
	Territori i Shqipërisë	100	985643	85					
	Implementimi në vite				0	2.67	2.75	2.83	3.00

Tabela 24. Afatet e kalimit të plotë në transmetimet numerike (MUX 1)

Tabela 24 përcakton afatet e realizimit të secilit nga proceset e nevojshme për mbylljen e transmetimeve analoge në secilin allotment.

Siç shihet nga kjo tabelë, koha e nevojshme për kalimin e plotë në transmetime numerike është 3 vjet. Ky afat e tejkalon afatin e vendosur në ligjin ekzistues të transmetimeve numerike që është viti 2012, ndërkohë që mbetet brenda afatit të përcaktuar nga marrëveshja GE 06 (2015).

Afatet e kalimit të plotë në transmetimet numerike mund të përshpejtohen nëse:

- Teleshikuesit do të pajisen 100% me dekoder brenda afatit të kalimit në numerik të secilit allotment;
- Mbështetja e operatorëve analogë ekzistues në platformën e MUX 1 do të realizohet në kohë e pa probleme financiare;
- Do të sigurohet në kohë financimi i plotë i ndërtimit të MUX 1;
- Në kriteret për fituesit e garës së furnizimit të pajisjeve transmetuese dhe ndërtimit të rrjetit, koha e realizimit të vlerësohet me pikët maksimale.

5.1.2. Ndërtimi i MUX 3, MUX 4, MUX 5 (rrjetet private kombëtare)

Gjatë procesit të licencimit të rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë, KKRT-ja do të përcaktojë kushte për harmonizimin e ndërtimit të këtyre rrjeteve në përputhje me planin e mbylljes së transmetimeve analoge ekzistuese. Gjatë implementimit të rrjetit operatorët privatë mund ta përshpejtojnë ndërtimin, por duke respektuar rendin e vendosur për digjitalizimin e çdo allotmenti.

Në rrjetet private kombëtare do të mundësohet edhe transmetimi me definicion të lartë (HD).

5.2 Faza II

5.2.1 Ndërtimi i MUX 6.1 deri 6.11 (rrjetet lokale)

Me mbështetjen e programeve të operatorëve ekzistues në platformën e RTSH-së (MUX 1), dhe mbylljen e rrjeteve të tyre analoge do të lirohen frekuencat e zëna prej tyre, disa prej të cilave

bëjnë pjesë në planin e frekuencave numerike. Lirimi i spektrit krijon kushte për licencimin e platformave lokale numerike në të cilat do të mbështeten programe të reja lokale.

Nuk përjashtohet edhe kalimi në platformat lokale edhe të programeve ekzistuese që në fazën e parë do të mbështeten në rrjetin e tv publik, nëse oferta e platformave lokale do të jetë më tërheqëse.

Shtimi i kapaciteteve transmetuese, si rezultat i ndërtimit të platformave lokale do të krijojë mundësinë e futjes së transmetimeve me definicion të lartë (HD) si në platformat lokale, ashtu edhe në MUX 1 të tv publik.

5.2.2 Ndërtimi i rrjeteve rajonale (MUX 8.1 etj.)

Si rezultat i lirit të spektrit nga transmetimet analoge, njëkohësisht me platformat lokale, mund të licencohen edhe platformat rajonale (që do të mbulojnë më shumë se një qark), duke përdorur mbulimin e planifikuar në brezin VHF.

5.3 Vendimi për përdorimin e mbulimit rezervë

Pas ezaurimit të kapaciteteve transmetuese të 7 mbulimeve kombëtare të përshkruara më sipër, për ndërtimin e rrjeteve të tv publik, në përputhje me zhvillimet e tregut të medieve elektronike të Shqipërisë, si dhe të teknologjive të transmetimeve radio e televizive, KKRT-ja do të përcaktojë mënyrën e shfrytëzimit, teknologjinë dhe mënyrën e licencimit të rrjetit të MUX 7, të lënë rezervë.

VI. DIVIDENTI DIGJITAL

6.1 Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.

Në Europë, kalimi nga transmetimi analog në transmetim numerik tokësor në fund të 2012-ës do të lirojë një sasi spektri të konsiderueshëm si rezultat i efikasitetit më të madh të teknologjisë numerike. Ky spektër njihet si “dividendi digjital”.

Dividendi digjital konsiderohet si një mundësi unike për të plotësuar kërkesën në rritje të shpejtë për shërbimet e komunikimit pa tel. Ai hap një spektër të mjaftueshëm për transmetuesit për të zgjeruar e zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme shërbimet e tyre duke siguruar në të njëjtën kohë që përdorime të tjera të rëndësishme sociale e ekonomike, si aplikimet me bandë të gjerë.

Pasojat e vendimeve të konferencës botërore të komunikacioneve të vitit 2007 (WRC-07), të vitit 2012, WRC - 2012, lidhur me përdorimin e spektrit 470-862 MHz, i destinuar deri tani sipas PKF-së për transmetime televizive, jepen në figurën e mëposhtme:



Siç shihet nga figura e mësipërme, një brez prej 72 MHz (790-862 MHz), në vend të transmetimeve televizive si deri tani, destinohet për transmetime mobile me bandë të gjerë.

Sot, brezi i frekuencave 790 – 862 MHz (kanalet 61-69 UHF), aktualisht nën administrimin e KKRT-së¹, përdoret për:

1. Transmetime analoge ekzistuese;

¹ Bazuar në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe planin kombëtar të frekuencave, miratuar me vendimin nr. 479 datë 6.5.2009 të Këshillit të Ministrave.



2. Transmetime digjitale ekzistuese (jashtë planit GE 06); dhe
3. Transmetime digjitale të planifikuara në marrëveshjen GE 06.

1. Transmetime analoge ekzistuese

Janë caktime frekuencore të gjetura në transmetim nga KKRT-ja në momentin e krijimit të saj ose të dhëna në vitet para miratimit të marrëveshjes GE 06. Më poshtë jepen operatorët, pikat përkatëse të transmetimit dhe kanalet e përdorura.

	Operatori	Pika e transmetimit	Kanali	Teknologjia	Kategoria
1.	TV Vizion+	Durrës	63	Analog	Vendor
2.	Telesport	Petresh	63	Analog	Vendor
3.	TV Margit	Blerim (Lu)	65	Analog	Vendor
4.	Telesport	Zvërnec	65	Analog	Vendor
5.	TVSH	Zvërnec	63	Analog	Publik
6.	TV Shijak	Shijak	61	Analog	Vendor
7.	T Margit 1	Ardenicë	63	Analog	Vendor
8.	TV Klan19	Mali i Robit	62	Analog	Kombëtar
9.	TVA 10	Kodër Ishëm	63	Analog	Kombëtar
10.	TVA 11	Librazhd	68	Analog	Kombëtar
11.	TVA 12	Ardenicë	61	Analog	Kombëtar
12.	2ATV	Kavajë Qytet	61	Analog	Vendor
13.	TV Fokus	Zvërnec	61	Analog	Vendor
14.	TV Berati	Berat Kala	67	Analog	Vendor
15.	TV Klan	Rubik	63	Analog	Kombëtar
16.	TV A1	V. Zogut (Dr)	68	Analog	Vendor
17.	TV Klan	Skrevan	65	Analog	Kombëtar
18.	TV ATN1	Ballsh	61	Analog	Vendor
19.	TV Adriati	Durrës	65	Analog	Vendor
20.	TV Tele1	Petresh	61	Analog	vendor
21.	TV Alsat	Tarabosh	66	Analog	Vendor
22.	TV D1	Peshkopi	61	Analog	Vendor
23.	TV 4+	Germenj	66	Analog	Vendor
24.	TV Preza	Prezë Kala	65	Analog	vendor
25.	TV K8	Mile	65	Analog	Vendore
26.	Top Channel	Bratomirë	67	Analog	Kombëtar
27.	Top Channe	Gllavë	68	Analog	Kombëtar
28.	TV News 24	Himarë	66	Analog	Vendor

Këto transmetime pritet të mbyllen në vitin 2015, në përputhje me dispozitat e GE 06.

2. Transmetime numerike ekzistuese

Siç dihet këto transmetime nuk janë licencuar nga KKRT dhe kanalet e okupuara nuk bëjnë pjesë në planin GE 06 D. Më poshtë jepen të dhënat përkatëse.

Nr.	Operatori	Pika e transmetimit	Kanali	Teknologjia
1	DigitAlb	Ardenicë	62	Digjital
2	DigitAlb1	Ardenicë	64	Digjital
3	DigitAlb2	Ardenicë	67	Digjital
4	DigitAlb3	Ardenicë	69	Digjital
5	DigitAlb	Fushë-Dajt	62	Digjital
6	DigitAlb	Fushë-Dajt	64	Digjital
7	DigitAlb	Fushë-Dajt	67	Digjital
8	DigitAlb	Fushë-Dajt	69	Digjital
9	DigitAlb	V. Zogut (Dr)	62	Digjital

10	DigitAlb	V. Zogut (Dr)	64	Digjital
11	DigitAlb	V. Zogut (Dr)	67	Digjital
12	DigitAlb	V. Zogut (Dr)	69	Digjital
13	DigitAlb	Petresh	62	Digjital
14	DigitAlb	Petresh	64	Digjital
15	DigitAlb	Petresh	67	Digjital
16	DigitAlb	Petresh	69	Digjital
17	DigitAlb	Tarabosh	62	Digjital
18	DigitAlb	Tarabosh	64	Digjital
19	DigitAlb	Tarabosh	67	Digjital
20	DigitAlb	Tarabosh	69	Digjital
21	DigitAlb	Zvërnec	62	Digjital
22	DigitAlb	Zvërnec	64	Digjital
23	DigitAlb	Zvërnec	67	Digjital
24	DigitAlb	Korçë	69	Digjital
25	DigitAlb	Korçë	62	Digjital
26	DigitAlb	Korçë	64	Digjital
27	DigitAlb	Korçë	67	Digjital
28	DigitAlb	Korçë	69	Digjital

Këto transmetime parashikohen të mbyllen me licencimin e operatorëve numerikë, privatë kombëtarë, pas një periudhe tranzicioni që do të bëjë të mundur kalimin në frekuencat e parashikuara nga GE 06 dhe ndryshimin e dekoderave nga MPEG-2 në MPEG-4.

3. Transmetime numerike të planifikuara në planin GE 06 D

Sipas GE 06, në planin shqiptar të frekuencave numerike bëjnë pjesë edhe caktime frekuencore në brezin e dividendit digjital (kanalet 61-69), lista e të cilave jepet më poshtë.

Allotmenti Kukës	Kan/Frek
AL-002D/Kukës	65 (826Mhz)
Allotmenti Dibër	Kan/Frek
AL-003D/Dibër	63 (810Mhz)
AL-003D/Dibër	69 (858Mhz)
Allotmenti Lezhë	Kan/Frek
AL-004D/Lezhë	66 (834Mhz)
AL-004D/Lezhë	68 (850Mhz)
Allotmenti Tiranë	Kan/Frek
AL-005D/Tiranë	61 (794Mhz)
Allotmenti Elbasan	Kan/Frek
AL-006D/Elbasan	62 (802Mhz)
AL-006D/Elbasan	68 (850Mhz)
Allotmenti Berat	Kan/Frek
AL-008D/Berat	65 (826Mhz)
AL-008D/Berat	66 (834Mhz)
Allotmenti Korçë	Kan/Frek
AL-009D/Korçë	64 (818Mhz)
Allotmenti Gjirokastrë	Kan/Frek
AL-010D/Gjirokastrë	63 (810Mhz)
AL-010D/Gjirokastrë	67 (842Mhz)
AL-010D/Gjirokastrë	69 (858Mhz)
Allotmenti Vlorë	Kan/Frek
AL-011D/Vlorë	64 (818Mhz)
AL-011D/Vlorë	68 (850Mhz)



Problem kryesor rezulton riplanifikimi i transmetimeve numerike në breza më të ulët frekuencash, për të mos pakësuar kapacitetet transmetuese të fituara nga plani GE 06. Për këtë qëllim duhet planifikuar koordinimi me vendet fqinje dhe duhet bërë regjistrimi në GE 06 të rreth 13% të caktimeve frekuencore totale të planifikuara nga GE 06.

Duke marrë në konsideratë vështirësitë e procesit të koordinimit, i cili mund të përfundojë pa rezultat, si pasojë e interesave të të gjitha vendeve për të shfrytëzuar në interes të vet të gjitha burimet e fundme, shumë vende kanë vendosur të mos bëjnë më riplanifikim, por thjesht të reduktojnë mbulimet e planifikuara. Në rastin e Shqipërisë kjo do të sillte mosshfrytëzimin e plotë të 2 mbulimeve (Nga 7+1 mbulime do të mbeten 5+1 mbulime.).

Kjo bëhet në përputhje me të gjitha zhvillimet ndërkombëtare, me aktet finale të konferencës botërore të radiokomunikacionit, me interesat kombëtare për zhvillimin e rrjeteve me brez të gjerë, si një mundësi zhvillimi ekonomik për vendin dhe përfitimin social-ekonomik të gjerë.

Puna për koordinimin me vendet fqinje, mund të zhvillohet paralelisht me realizimin e objektivit imediat (kalimi në transmetimet numerike dhe lirimi i spektrit për DD) dhe të vazhdojë pas arritjes së tij për të bërë të mundur riplanifikimin me synim krijimin e mbulimeve të reja (kombëtare apo lokale).

VII. PAGESAT E OPERATORËVE PRIVATË LOKALË PËR MBËSHTETJEN NË RRJETIT NUMERIK KOMBËTAR TË TVSH-SË

Duke qenë së mbështetja e operatorëve analogë ekzistues në rrjetin numerik të RTSH-së do të respektojë rregullat e tregut, gjatë zhvillimit të këtij biznesi, RTSH-së duhet t'i planifikohet një normë fitimi. Në material kjo normë është përcaktuar 15% duke u mbështetur në praktikën e lejimit të një norme të arsyeshme fitimi dhe moskrijimit të barrierave financiare për operatorët ekzistues që do mbështeten në rrjetin e RTSH-së.

Duke marrë parasysh edhe taksat, të ardhurat vjetore të RTSH-së nga biznesi i ofrimit të rrjetit të vet për mbështetjen e programeve të të tretëve, do të jenë:

Emërtimi	Lekë	Euro
Shpenzimet vjetore	46866352.50	360510.40
Fitimi i planifikuar (15%)	7059906.00	108153.10
Tatimfitimi (10%)	75991.00	10815.30
Shuma e të ardhurave vjetore të op. publik (për 1 allotment)	54002249.5	479 478.8

Tabela 25. Të ardhurat vjetore të planifikuara nga ofrimi i rrjetit të RTSH-së për mbështetjen e programeve për të tretët

7.1 Llogaritja e pagesës për mbështetje në MUX (MPEG 4)

Duke supozuar se për çdo allotment, në rrjetin e RTSH-së do të mbështeten mesatarisht 12 operatorë lokalë, për të përcaktuar pagesën e çdo operatori lokal, shuma e të ardhurave sipas tabelës paraardhëse, pjesëtohet me nr. 12.

Emërtimi	Lekë	Euro
Operatorë të shërbimit programor TV	12	
Pagesa vjetore për operator	4500187.45	34616.82
Pagesa mujore	375015.62	2884.73

Tabela 26. Llogaritja e pagesës për mbështetje në MUX (MPEG 4)

Arsyetimi i mësipërm është bërë pa zbritur shpenzimet që RTSH-ja do të kryejë për të operuar kanalet e veta që do të mbështeten në po këtë rrjet numerik.

Në këtë mënyrë, mesatarisht, pagesa vjetore për të mbështetur programet lokale në një allotment të rrjetit të operatorit publik është rreth 34 600 euro ose 4.5 milionë lekë, që i korrespondon një pagese mujore prej 2 884 eurosh ose 375015 lekësh.

Në këtë përcaktim nuk janë marrë parasysh disa faktorë që janë determinues në përcaktimin e vlerës së tregut, si zona e shërbimit, madhësia aktuale e operatorëve ekzistues etj.

7.2 Gjendja financiare e disa operatorëve televizivë ekzistues

Për të realizuar një kalim të shpejtë në transmetimet numerike do të jetë vendimtar përcaktimi i aftësisë paguese të operatorëve ekzistues analogë për t'u mbështetur në platformën numerike. Për këtë përcaktim të aftësisë paguese të operatorëve ekzistues analogë, janë marrë në konsideratë operatorët e mëposhtëm (tabela 27), për të cilët disponohen të dhëna.

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Të ardhurat (mijë lekë)	Shpenzime (mijë lekë)	Të ardhurat (euro)	Shpenzime (euro)
	Televizione		2275531	2150344	17504085	16541108
1	TV Telesport	Tiranë	28937	28412	222592	218554
2	TV Tele 1	Tiranë		2402	0	18477
3	TV Tirana 2000	Tiranë	5082	5306	39092	40815
4	TV Kopliku	M. e Madhe	4242	3829	32631	29454
5	TV BBF	Tiranë	22186	21399	170662	164608
6	TV Planet (Calvin)	Tiranë	11150	10717	85769	82438
7	TV Lezha	Lezhë	6894	6377	53031	49054
8	TV Berati	Berat	865	734	6654	5646
9	TV Supersonic	Tiranë	6291	5593	48392	43023
10	TV Star	Tiranë	2450	11077	18846	85208
11	TV Scan (ATN 1)	Tiranë	36152	34637	278092	266438
12	TV Club	Tiranë	12415	10050	95500	77308
13	TV Rozafa	Shkodër	46212	3896	355477	29969
14	TV Vizion +	Tirane	459982	469000	3538323	3607692
15	TV Channel 7	Gjirokastër	4830	4320	37154	33231
16	TV Top Channel	Tiranë	1320413	1269258	10157023	9763523
17	TV Puka	Pukë	2100	1747	16154	13438
18	TV UFO	Durrës	7540	6730	58000	51769
19	TV Blue Sky	Shkodër	1799	1604	13838	12338
20	TV Lobi	Korçë	2750	3717	21154	28592
21	TV Apollon	Fier	8122	6472	62477	49785
22	TV ORA	Tiranë	74959	68342	576608	525708
23	TV News 24	Tiranë	200524	164689	1542492	1266838
24	TV AVN	Fier	4115	3995	31654	30731
25	TV Margit	Lushnjë	1920	1774	14769	13646
26	TV 4+	Lushnjë	3601	5267	27700	40515

Tabela 27. Gjendja financiare e disa operatorëve televizivë ekzistues

Në pamundësi të sigurohen të dhëna të detajuara për shpenzimet, shifra totale vjetore e shpenzimeve është krahasuar me pagesën vjetore të kalkuluar më sipër për mbështetjen në platformat numerike. Është e evidente që ky krahasim është vetëm orientues, pasi në shpenzimet aktuale të operatorëve hyjnë, përveç shpenzimeve të mirëmbajtjes së rrjetit, edhe shumë shpenzime të tjera. Me këto paranteza, gjendja paraqitet:



7.3 Operatorë me shpenzime më pak së 4.5 milionë lekë në vit

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Të ardhurat (mijë lekë)	Shpenzime (mijë lekë)	Të ardhurat (euro)	Shpenzime (euro)
1	TV Tele 1	Tiranë		2402	0	18477
2	TV Kopliku	M. e Madhe	4242	3829	32631	29454
3	TV Berati	Berat	865	734	6654	5646
4	TV Rozafa	Shkodër	46212	3896	355477	29969
5	TV Channel 7	Gjirokastër	4830	4320	37154	33231
6	TV Puka	Pukë	2100	1747	16154	13438
7	TV Blue Sky	Shkodër	1799	1604	13838	12338
8	TV Lobi	Korçë	2750	3717	21154	28592
9	TV AVN	Fier	4115	3995	31654	30731
10	TV Margit	Lushnjë	1920	1774	14769	13646

Tabela 28. Operatorë me shpenzime më pak se 5.2 milionë lekë në vit

Shënim. Tabela e mësipërme është hartuar nga të dhënat e disponueshme dhe nuk është shteruese. Në treg mund të ketë edhe operatorë të tjerë me të ardhura e shpenzime të pakta.

7.4 Operatorë me shpenzime deri në dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Të ardhurat (mijë lekë)	Shpenzime (mijë lekë)
1	TV Tirana 2000	Tiranë	5082	5306
2	TV Lezha	Lezhë	6894	6377
3	TV Supersonic	Tiranë	6291	5593
4	TV Club	Tiranë	12415	10050
5	TV UFO	Durrës	7540	6730
6	TV Apollon	Fier	8122	6472
7	TV 4+	Lushnjë	3601	5267

Tabela 29. Operatorë me shpenzime deri në dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

7.5 Operatorë me shpenzime mbi dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Të ardhurat (mijë lekë)	Shpenzime (mijë lekë)	Të ardhurat (euro)	Shpenzime (euro)
	Televizione		2275531	2150344	17504085	16541108
1	TV Telesport	Tiranë	28937	28412	222592	218554
2	TV BBF	Tiranë	22186	21399	170662	164608
3	TV Planet (Calvin)	Tiranë	11150	10717	85769	82438
4	TV Star	Tiranë	2450	11077	18846	85208
5	TV Scan (ATN 1)	Tiranë	36152	34637	278092	266438
6	TV Vizion +	Tiranë	459982	469000	3538323	3607692
7	TV Top Channel	Tiranë	1320413	1269258	10157023	9763523
8	TV ORA	Tiranë	74959	68342	576608	525708
9	TV News 24	Tiranë	200524	164689	1542492	1266838

Tabela 30. Operatorë me shpenzime mbi dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit

7.6 Klasifikimi i operatorëve sipas shpenzimeve vjetore

Tabela 31 paraqet të përmbledhur përqindjen e shpenzimeve sipas paragrafëve 7.3, 7.4 dhe 7.5

Nr.	Emërtimi	%
1	Operatorë me shpenzime më pak së 4.5 milionë lekë në vit	39
2	Operatorë me shpenzime deri në dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit	27
3	Operatorë me shpenzime mbi dyfishin e 4.5 milionë lekëve në vit	34

Tabela 31. Klasifikimi i operatorëve sipas shpenzimeve vjetore

Nga të dhënat e tabelës 31 së mësipërme, rezulton se 39% të operatorëve ekzistues lokalë nuk janë në gjendje të përballojnë shpenzimet për mbështetje në rrjetin e operatorit publik (MUX 1), kurse 34% të tyre janë qartësisht në gjendje t'i përballojnë këto shpenzime edhe pse do t'u duhet të paguajnë më shumë pasi shtrihen në disa allotmente.

Mendimi është se pagesën e kalkuluar për mbështetje në MUX 1 mund ta përballojnë rreth 50-55% të operatorëve ekzistues. Për pjesën tjetër, me qëllim që të nxitet kalimi në platformën numerike, duhet studiuar mundësia e lehtësimeve në pagesat, të paktën për vitet e para.

7.7. Propozime mbi lehtësimin e pagesave për mbështetjen e operatorëve ekzistues në rrjetin numerik të TVSH-së

Siç u demonstrua më sipër, jo të gjithë operatorët ekzistues analogë do të jenë në gjendje të paguajnë detyrimin për t'u mbështetur në rrjetin e TVSH-së. Për të nxitur mbështetjen e tyre në platformën digjitale, propozohet të aplikohen lehtësirat si më poshtë:

7.7.1. Pagesë e diferencuar sipas zonës së licencimit

Dihet se zonat e licencimit të operatorëve televizivë nuk paraqesin të njëjtën tërheqje për biznesin. Zonat më atraktive janë zona Tiranë-Durrës, Ultësira Perëndimore e Shqipërisë dhe zona Korçë-Elbasan. Zonat e tjera konsiderohen të vështira. Ky diferencim duhet të reflektohet edhe në pagesat për mbështetjen në platformat numerike. Tabela e mëposhtme pasqyron koeficientet që do të shërbejnë për të realizuar diferencimin (tabela 32).

Zona e licencimit	Tiranë-Durrës	Shqipëria Perëndimore, Korça	Pjesa tjetër
Koeficientet	2	1.5	0.5

Tabela 32. Koeficientet e pagesës sipas zonave të licencimit

Koeficientët e mësipërm reflektohen në pagesat vjetore e mujore të operatorëve në tabelën më poshtë (tabela 33).

Pagesa për 1 allotment për operator	Mesatare	Tiranë-Durrës	Shqipëria Perëndimore, Korça	Të tjerët
Koeficienti		2	1.5	0.5
Operatorët (%)		30	40	30
Pagesa vjetore për operator (lekë)	5 200 000	10 400 000	7800000	2600000
Pagesa vjetore për operator (euro)	40000	80 000	60 000	20 000
Pagesa mujore për operator (lekë)	433 333	866 667	650 000	216 667
Pagesa mujore për operator (euro)	3 333	6 667	5 000	1 667

Tabela 33. Pagesat për mbështetjen në rrjetin numerik të TVSH-së sipas zonave të licencimit

7.7.2. Pagesë e reduktuar për vitin e parë

KKRT-ja ka detyrim të sigurojë lehtësira për kalimin në platformën numerike të operatorëve ekzistues. Viti i parë i kalimit në transmetimet numerike do të jetë viti më i vështirë për të gjithë operatorët, pasi përveç të tjerash atyre do t'u duhet të bëjnë shpenzime edhe për rrjetin ekzistues analog për periudhën e *simulcast*-it. Prandaj propozohet që vitin e parë pagesa për mbështetjen në rrjetin numerik të reduktohet në gjysmën e pagesës së llogaritur. Në vitet e tjera, sidomos operatorët që aktualisht kanë shtrirje të kufizuar (një rreth apo një qytet) do të përfitojnë nga zgjerimi i zonës së licencimit (që do të jetë një qark), duke përmirësuar kështu edhe gjendjen ekonomike.

Aplikimi i një pagese të reduktuar për vitin e parë do të ulë të ardhurat e operatorit publik për vitin në fjalë. Ky fakt duhet të merret parasysh gjatë llogaritjeve të vetëshlyerjes së MUX 1. Një



zgjidhje alternative mund të ishte aplikimi i ndihmës shtetërore (ose mbështetja nga donatorë të tjerë) i diferencës, për të mos ndikuar në afatet e vetëshlyerjes së investimit.

Tabela 34 e mëposhtme pasqyron pagesat që rezultojnë nga një propozim i tillë.

Pagesa për 1 allotment për operator	Mesatare	Tiranë-Durrës	Shqipëria Perëndimore, Korça	Të tjerët
Koeficienti		2	1.5	0.5
Operatorët (%)		30	40	30
Pagesa vjetore për operator (lekë)	2600000	5200000	3900000	1300000
Pagesa vjetore për operator (euro)	20000	40000	30000	10000
Pagesa mujore për operator (lekë)	216666.5	433333.5	325000	108333.5
Pagesa mujore për operator (euro)	1667	3333	2500	833

Tabela 34. Pagesat për mbështetjen në rrjetin numerik të TVSH-së e reduktuar për vitin e parë

7.7.3. Pagesë e reduktuar gjatë viteve

Nëse, me gjithë korrigjimet e mundshme, ndonjë operator i zonave të largëta do të gjykohej se nuk do të jetë në gjendje të përballojë pagesën për mbështetje në platformën numerike, mund të aplikohen pagesa të reduktuara për tri vitet e para të operimit (ose deri në fund të periudhës së licencimit). Këto pagesa mund të jenë të përshkallëzuara sipas viteve. Operatorët që do të përfitojnë nga kjo skemë do të jenë në numër shumë të kufizuar dhe do të përcaktohen nga KKRT-ja sipas kriterëve rigorozë e transparente. Edhe në këtë rast, një zgjidhje alternative mund të ishte aplikimi i ndihmës shtetërore (ose mbështetja nga donatorë të tjerë) i diferencës, për të mos ndikuar në afatet e vetëshlyerjes së investimit.

Nëse edhe pas tri viteve (ose pasi i mbaron afati i licencës) operatori nuk do të jetë në gjendje të paguajë, ai do të dalë nga tregu i medieve elektronike.

7.7.4. Subvencione

Me qëllim garantimin e objektivave për shumëllojshmërinë e medieve dhe sigurimin e vazhdimësisë, të ofrimit të shërbimit në zonat e largëta, mund të konsiderohet edhe dhënia e subvencioneve për mbështetjen në platformat numerike, në rastet e justifikuara për operatorët me mundësi të kufizuara financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

ANEKSI 1

LICENCIMI I PLATFORMAVE NUMERIKE

Platforma DTT (Digital Terrestrial Television) është një prej disa platformave të ndryshme numerike dhe futje e DTT ka qenë dhe akoma është një problem në shumë vende që përdorin qasje të ndryshme për rregullimin dhe modelet e licencimit. Por pyetja e parë është nëse ka nevojë për DTT. Nëse sateliti apo tv me kablo janë predominues në një zonë, mund të lindë mendimi që spektri mund të përdoret për shërbime të tjera.

Por shumica e vendeve dhe rajoneve në Europë duket se kanë arritur në konkluzionin se DTT-ja duhet të jetë një opsion për konsumatorët. Me t'u zgjedhur ky opsion, duhet krijuar kuadri rregullator. Në disa vende janë të mjaftueshme vetëm disa rregullime të vogla të legjislacionit ekzistues, ndërsa në disa të tjera janë krijuar sisteme të reja licencimi. Duhet marrë në konsideratë çështja nëse DTT-të do të rregullohet ndryshe nga platformat e tjera dhe arsyet e një veprimi të tillë. Midis vendeve të Europës përdoren rrugë të ndryshme për të rregulluar sektorin.

Qasjet dhe modelet e ndryshme të licencimit të DTT-së kanë avantazhet dhe dizavantazhet e tyre, të cilat rregullatori duhet t'i marrë parasysh përpara së të zgjidhet qasja përkatëse. Qasja e zgjedhur nga një vend, mund të mos jetë e përshtatshme në një vend tjetër. Zgjedhja e një modeli mund të prekë edhe pjesë të tjera të sistemit. Modeli i quajtur "gatekeeper" me variantet e tij të

ndryshme është një opsion i zgjedhur nga vende të ndryshme, ku e drejta për të vendosur mbi përmbajtjen e mbështetur në platforma numerike pak a shumë i jepet një entiteti privat ose duke i dhënë atij liri të plotë zgjedhjeje ose duke i dhënë një seleksion kanalesh për të zgjedhur. Në sisteme të tjera licencimi rregullatorët dëshirojnë të mbajnë kontrollin mbi përmbajtjen e ofruar. Në përgjithësi çështja e mbajtjes së kontrollit mbi përmbajtjen duket të jetë çështje madhore në shumë shtete.

Disa vende si Shqipëria kanë një traditë të fortë të kanaleve pa pagesë (*free to air*) dhe disa të tjera kanë tradita të tv me pagesë, gjë e cila influencon në modelin e licencimit. Nëse lejohet tv me pagesë, duhet të jepet edhe modeli i biznesit për të përcaktuar modelin e licencimit. Si përfundim mund të themi se metoda “gatekeeper” është një alternativë që ecën në vendet me traditë “pay TV”.

ASPEKTE MBI PËRMBAJTJEN

Gjatë diskutimit të DTT-së zakonisht tentohet përqendrimi në detajet teknike duke harruar perspektivën e konsumatorit. Një shumicë e gjerë konsumatorësh nuk janë të interesuar në teknikën por në përmbajtjen. Duke pasur mundësinë e zgjedhjes midis platformave të ndryshme, një konsumator mund të zgjedhë platformën më të mirë nga pikëpamja e përmbajtjes.

Vendosja e DTT-së zakonisht krijon më shumë kanale, më shumë përmbajtje për konsumatorin. Sipas konceptit të pastër “gatekeeper” rregullatori ka zgjedhur të mos ketë asnjë ndikim mbi përmbajtjen, me përjashtim të çështjeve të monitorimit të rregulluara nga direktiva AVMS (Audiovisual Media Services). Por, zakonisht një rregullator vendos disa kritere mbi përmbajtjen që duhet t’u ofrohet konsumatorëve; kjo mund të jetë një dëshirë për të mbrojtur kulturën apo gjuhën ose thjesht një dëshirë që DTT-ja duhet të ketë një përmbajtje që u drejtohet sa më shumë konsumatorëve. Dhe, më shumë kanale zakonisht do të thotë gjithashtu, që kompani programesh të krijuara në vende të tjera të varen nga qëndrimet e rregullatorëve vendas kundrejt “kanaleve të huaj”.

Në shumë vende DTT-ja do të thotë gjithashtu, një mundësi të transmetohet jo vetëm në shkallë kombëtare, por edhe në shkallë lokale/rajonale, pasi vlerësimi i shikuesit zakonisht nuk merr parasysh zona transmetimi më të vogla. Kështu që ka disa vështirësi në gjykimin e kërkesës së konsumatorit apo shikimin e shërbimeve programore lokale/rajonale. Si rezultat, një transmetues rajonal mund të ketë vështirësi për të gjetur një model biznesi, pasi blerësit e spoteve komerciale shpesh përdorin vlerësimin e teleshikuesve kur ata vendosin se në cilin program do ta japin reklamën e tyre.

E ARDHMJA

Qysh prej fillimit të DTT-së, teknologjia është zhvilluar prej përdorimit të standardit MPEG2 dhe DVB-T në MPEG4 dhe/ose DVB-T2. Në një dokument konsultimi prej qershorit 2009, Komisioni Europian diskutoi një grafik europian, si të transformohet dividendi digjital në përfitime sociale dhe rritje ekonomike në Europë. Një nga çështjet është dhe pritjet e mëdha të konsumatorëve lidhur me zhvillimet e ardhshme të shërbimeve të transmetimeve televizive si më shumë programe, cilësi e rritur si HDTV apo marrje mobile. Një nga elementet e propozuara është përmirësimi i eksperiencës së konsumatorëve duke siguruar standarde të cilësisë së lartë për marrësit HDTV në Europë. Pra një nga veprimet prioritare është sigurimi që standardet e kompresionit për të gjithë marrësit e shitur pas janarit 2012 të jenë të paktën aq efikase sa standardi MPEG4 (H264/MPEG4 AVC).

Përdorimi i MPEG4 dhe/ose DVB-T2 do të thotë një përdorim më efikas i spektrit, por në shumë raste do të çojë në rritjen e kostove të konsumatorit.

Duke ditur kohën mesatare të rinovimit të dekoderave (rreth 5 deri në 8 vjet), rregullatori duhet të marrë parasysh faktin që konsumatorët duhet të motivohen për të blerë dekodera të rinj apo marrës tv të rinj, përpara se të vendosin të lëvizin drejt tranzicionit në teknikat e reja, përndryshe avantazhet e teknologjive të reja nuk mund të realizohen plotësisht.



Platforma DTT mund të shihet si një plotësim i platformave të tjera që mbartin një përmbajtje më të kufizuar ose mund të shihet si një platformë që konkurren me kabllon, satelitin, apo IPTV-në (Internet Protocol Television). Në rastin e IPTV, HDTV mund të konsiderohet si thelbësore për të mbajtur konkurrencën midis platformave të ndryshme.

Pas më shumë se 10 vjetësh me DTT, platforma diskutohet akoma nga kënde të ndryshme me çështje të reja interesante. Jo shumë sektorë kanë këtë lidhje të ngushtë dhe këtë përzierje çështjesh teknike, të konsumatorëve dhe të përmbajtjes.

Administratat kombëtare përgatisin legjislacionin duke marrë në konsideratë marrëveshjet e ITU-së dhe ato rajonale (midis anëtarëve të ITU-së, marrëveshjet në kuadrin e CEPT-it dhe politikat dhe direktivat e BE-së). Në bazë të këtij legjislacioni kombëtar jepen licencat për transmetimet numerike. Procesi i licencimit të televizionit numerik varion shumë nga vendi në vend. Në disa vende, licencat u jepen operatorëve të rrjetit, ndërsa në të tjera licencat u jepen ofruesve të përmbajtjes, operatorëve multipleks dhe operatorëve të rrjetit. Selektimi i aplikimeve ndonjëherë bëhet në bazë të ankandëve, në raste të tjera nëpërmjet konkurseve krahasues (beauty contest). Në shumicën e rasteve transmetimet e operatorit publik nuk kanë nevojë për licencë. Kostot e licencave ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend. Në disa raste kërkohet një pagesë për mbulimin e kostove të procesit të licencimit, në raste të tjera realizohet pagesa në bazë të vlerës së tregut të spektrit të frekuencave.

PROPOZIMI PËR MËNYRAT E LICENCIMIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE NUMERIKE NË SHQIPËRI

Shqipëria ka një traditë të fortë të marrjes së programeve pa pagesë (free to air) nëpërmjet transmetimeve analoge tokësore, gjë e cila influencon në zgjedhjen e modelit të licencimit edhe të transmetimeve numerike.

Modeli “gatekeeper” ku e drejta për të vendosur mbi përmbajtjen e mbështetur në platforma numerike i jepet një entiteti privat konsiderohet jo e përshtatshme për Shqipërinë.

Në analogji me shumë shtete të Europës, edhe në Shqipëri propozohet një sistem licencimi ku rregullatori të mbajë kontrollin mbi përmbajtjen e ofruar, duke synuar përmbushjen e misionit publik të medieve elektronike.

Në funksion të këtij objekti propozohet të aplikohen llojet e mëposhtme të licencave:

- a) Licencë shërbimi programi audio, për ofrimin e një shërbimi programi audio;
- b) Licencë shërbimi programi audioviziv, për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv;
- c) Licencë transmetimi audio. Kjo licencë përbëhet nga:
 - i) Licencë shërbimi programi audio sipas pikës “a”; dhe
 - ii) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit, i cili mund të jetë analog ose numerik;
- d) Licencë transmetimi audioviziv. Kjo licencë përbëhet nga:
 - i) Licencë shërbimi programi audioviziv sipas pikës “b”; dhe
 - ii) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit, i cili mund të jetë analog ose numerik.

Një ndarje e tillë e licencave krijon fleksibilitet për t’iu përshtatur çfarëdo modeli biznesi në tregun e medieve audiovizuale.

P.sh. për transmetimet analoge, propozohet të jepet licencë transmetimi audio ose audiovizive analoge (pikat “c” dhe “d” më sipër). Kjo licencë përfshin licencën për shërbimin programor dhe licencën për ndërtimin e operimin e rrjetit analog (1 rrjet - 1 program).

Për transmetimet numerike, propozohet të jepet licencë transmetimi audio ose audiovizive numerike. Kjo licencë përfshin licencën për shërbimet programore dhe licencën për ndërtimin e operimin e rrjetit numerik (1 rrjet – shumë programe).

Për të shmangur monopolet dhe për të nxitur pluralizmin, operatorët që do të pajisen me licencë transmetimi numerike (audio apo audiovizuale) do të lejohen të shfrytëzojnë vetëm 60% të

kapacitetit të rrjetit të tyre numerik për të mbështetur programet e veta. Kapacitetet e lira ata detyrohen t'ua ofrojnë në bazë të kritereve të drejta, të barabarta dhe jodiskriminuese, operatorëve të tjerë që nuk disponojnë rrjet të vetin por janë pajisur me licencë shërbimi programi (audio ose audiovizive), sipas pikave “a” dhe “b” më sipër.

Licencat do të kategorizohen në:

- a) kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak së 80% e territorit të vendit;
- b) rajonale, për mbulim deri në 4 qarqe me vazhdimësi gjeografike; dhe
- c) lokale, për mbulimin e një qarku.

Licencat e përmendura të shërbimeve të programeve do të jenë kombëtare, rajonale apo lokale në funksion të kategorisë së rrjetit tokësor (analog apo numerik), në të cilin do të mbështeten këto shërbime.

Për shërbimet programore që do të mbështeten në rrjete të ndryshme nga rrjetet tokësore (analoge apo numerike), pra nuk kërkojnë shfrytëzimin e burimeve të kufizuara natyrore, propozohet që të jepen pa konkurrim autorizime për shërbimin e programit audio dhe autorizime për shërbimin e programit audioviziv. Këto autorizime do të jenë:

- a) satelitor, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor;
- b) kabllor kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor;
- c) shërbimi *on line*, kur shërbimi mbështetet në internet;
- ç) shërbimi teknik për sistemet e aksesit të kushtëzuar;
- d) ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

Propozimet e mësipërme duhet të reflektohen në ligjin e ri të medieve audiovizive të Shqipërisë.

ANEKS 2 DIVIDENDI DIGJITAL

A1. ASPEKTE NDËRKOMBËTARE

A1.1 Elemente teknike në lidhje me optionet e harmonizimit për dividendin digjital

Në Europë, kalimi nga transmetimi analog në transmetim digjital tokësor në fund të 2012-ës, do të lirojë një sasi spektri të konsiderueshme, si rezultat i efikasitetit më të madh të teknologjisë digjitale. Ky spektër njihet si “Dividendi digjital” ose “Hapësirat e bardha”.

Dividendi digjital konsiderohet si një mundësi unike për të plotësuar kërkesën në rritje të shpejtë për shërbimet e komunikimit pa tel. Ai hap një spektër të mjaftueshëm për transmetuesit për të zgjeruar e zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme shërbimet e tyre duke siguruar në të njëjtën kohë që përdorime të tjera të rëndësishme sociale e ekonomike, si aplikimet me brez të gjerë.

Termet “Pika të bardha”(White spots), “Hapësira të bardha”(White spaces) ose “Spektër i shtresuar” janë përdorur për të prezantuar një koncept spektri frekuence, që është potencialisht i disponueshëm në një kohë të dhënë, për përdorim të mëtejshëm brenda spektrit të frekuencave të planifikuar që në fillim për transmetim në GE 06 [1]. Dokumentacioni i disponueshëm përdor kryesisht termin “Hapësira të bardha” dhe ky term do të përdoret në të gjithë dokumentin në vazhdim si emër xhenerik, për të përshkruar të gjitha rastet e ndryshme. Do të përfshihet i gjithë spektri i disponueshëm.

Këto hapësira të bardha kanë kohëzgjatje dhe zgjerim gjeografik të kufizuar, dhe në çdo përdorim duhet marrë parasysh mbrojtja e shërbimeve parësore të afërta dhe sistemet e tjera (shërbime, aplikime) të alokuara mbi bazë përparësie, që do të krijojnë pengesa në operimin e aplikimeve që përdorin spektrin e hapësirës së bardhë. Ky operim në hapësirën e bardhë mund të kryhet vetëm mbi bazën e një jointerference dhe jombrojtjeje.

Shërbimet e hapësirës së bardhë duhet të jenë të afta të lëvizin nëpër kanale alternative të hapësirës së bardhë, për të shmangur kështu interferencën me stacionet e reja në operim ose me të tjera shërbime që u është dhënë një përparësi më e madhe në bazë kombëtare. Në varësi të



kërkesave kombëtare dhe atyre jashtë kufirit, shërbimet e hapësirës së bardhë që hyjnë në brez duhet të kenë dijëni se zakonisht mund të shtohen stacione të tjera, përgjithësisht ato transmetueset.

Pra “Hapësira e bardhë” është një emërtim që tregon një pjesë të spektrit, që është e disponueshme për një aplikim radiokomunikimi (shërbim, sistem) në një kohë të dhënë, në një zonë gjeografike të dhënë, mbi një bazë jointerferuese/jo të mbrojtur, në lidhje me të tjera shërbime që kanë një përparësi më të madhe në bazë kombëtare.

EC-ja, në mandatin e saj në CEPT mbi dividendin digjital, synon përdorimin më fleksibël të mundshëm të spektrit, duke lejuar intervalin më të gjerë të mundshëm të përdorimeve dhe teknologjive. Rrjedhimisht, në raportin A, raportin B dhe suplementin e tij, CEPT-ja ka analizuar rrjedhojat e parashikuara që vijnë nga përdorimi i përbashkët pjesor në brezin 470-862 MHz për shërbime transmetimi digjital, transmetimi multimedial dhe shërbime fikse/mobile.

RSPG-ja në opinionin e saj “Ndërlikimet e politikës spektrale të BE-së për dividendin digjital” thekson së për të implementuar dividendin digjital, shtetet anëtare mund të duan të marrin në konsideratë impaktin mbi shërbimet e tjera ekzistuese, përfshirë këtu shërbimet dytësore. Padyshim, implementimi i dividendit digjital për aplikimet transmetuese dhe jotransmetuese mund të ketë ndërlikime, për sa i përket ekzistencës aktuale të shërbimeve të tjera që zënë spektrin e shtresuar ose “hapësirën e bardhë” brenda brezit 470-862 MHz. Këto përfshijnë navigimin radio, shërbimet fikse ose mobile për aplikime ushtarake, astronominë radio dhe shërbimet ndihmëse për transmetimin dhe program-krijimin (SAB/SAP, gjithashtu i njohur në industri si program krijimi dhe shërbimet e eventeve speciale ose PMSE). Shumë nga këto shërbime mund të ndikohen ose pengohen nga zhvillimi i brezit UHF.

Për më tepër, në spektrin e bardhë ka mundësi për aplikime të reja që përfitojnë nga karakteristikat e favorshme fizike të përhapjes që ka spektri UHF, për shembull kalimi i lirë përmes muresh për të mundësuar aplikimet e rrjetit në të gjithë shtëpinë ose në rrjetet e zonës.

Ky kapitull është një vëzhgim paraprak i praktikimit të implementimit të aplikimeve të reja/të ardhshme brenda spektrit të hapësirës së bardhë në brezin 470-862 MHz.

A1.2 CEPT

Për të shkuar më tej mandatin të parë të komitetit të spektrit të KE-së, për të studiuar kufizimet teknike të hasura nga dividendi digjital, duke pasur parasysh miratimin e një politike të harmonizuar në Bashkimin Europian, në fund të 2006-ës, Konferenca Europiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) krijoi grupin TG4 ECC. Për të përmbushur mandatin që i është dhënë, TG4 kishte si qëllim në thelb hartimin e tri raporteve.

RAPORTI CEPT 21

Ky raport trajton çështjet e përputhshmërisë ndërmjet rrjeteve DVB-T për marrjen fikse dhe rrjeteve DVB-H (Digital Video Broadcasting - Handheld) për marrjen e lëvizshme, dhe mundësinë e harmonizimit të një nënbrezi në brezat e frekuencave IV dhe V për rrjetet DVB-H, duke konstatuar së të dyja llojet e rrjetit janë në thelb kompatibël, me identifikimin e teknikave për të zgjidhur interferencat e mundshme. Lidhur me mundësinë e harmonizimit të një nënbrezi për rrjetet DVB-H, raporti nuk është përfundimtar, duke treguar avantazhet dhe dizavantazhet e harmonizimit apo të mosharmonizimit të një nënbrezi. Ai gjithashtu përmend se, në qoftë se një harmonizim duhet të ndodhë, kjo nuk duhet të jetë e detyrueshme dhe se miratimi i tij bëhet duke e lënë në konsideratën e çdo vendi.

RAPORTI CEPT 22

Raporti i dytë, i cili në thelb i afrohet fizibilitetit teknik të harmonizimit të një nënbrezi në brezat IV dhe V UHF për aplikimet fikse/mobile duke përfshirë *uplink*, arrin në përfundimin se është i mundshëm për t'u kryer, duke përfshirë të paktën kanalet 62 deri 69, për aq kohë sa harmonizimi nuk është i detyrueshëm.

Ky raport, gjithashtu arrin në përfundimin se do të jetë praktikisht e pamundur për një vend

për të përdorur këtë nënbrez për aplikime mobile pa pëlqimin paraprak të vendeve fqinje, duke marrë parasysh nivelin e interferencës prodhuar nga futjet digjitale të GE 06.

Duhet të përmendet se disa administrata europiane paraqitën një rezervë për konkluzionet e këtij raporti, sepse nënbrezi i identifikuar në raport është pikërisht brezi ku DTT-ja është duke u futur në këto vende, duke ndjekur marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkuara.

Në fakt, implementimi i DTT-së në këtë nënbrez ishte një strategji e adoptuar nga disa vende europiane, për shkak të disponueshmërisë së tij më të gjerë, më tej për lirimin e tij nga mbrojtja ushtarake dhe përdorime të sigurisë, pra duke bërë të mundur implementimin e DTT pandryshuar kanalet radio të përdorura nga tv analog.

RAPORTI CEPT 24

Raporti i fundit vlerëson mundësinë e marrjes pjesë të spektrit që nuk është përdorur nga DVB-T (përcaktuar “hapësira e bardhë”) për aplikime ose shërbime të reja në të ardhmen.

Raporti arrin në përfundimin se teknologjia e lidhur me radiot njohëse është ende në fazën fillestare dhe për këtë arsye do të ishte i parakohshëm përcaktimi i kërkesave që do të mundësojë përdorimin e saj, e cila gjithmonë do të jetë i bazuar në mosinterferencë. Ai gjithashtu arrin në përfundimin së “hapësirat e bardha”, në një shkallë të madhe, do të vazhdojnë të përdoren nga mikrofonat transmetues për prodhimin e programeve dhe ngjarjeve të (PMSE - Programme-making and Special Events) dhe kështu duhet të jetë përdorimi kryesor.

RAPORTI ECC 142

Ky raport ofron informacion dhe këshilla për administratat që mbulojnë çështjet, të cilat duhet të diskutohen hapur dhe të merren në konsideratë gjatë një përpjekjeje për të futur rrjete komunikimi mobil/fiks në brezin 790-862 MHz ose për të përdorur burime shtesë për transmetim në brezin UHF.

Duke marrë parasysh përfundimet e këtyre raporteve, në mesin e vitit 2008, komiteti i spektrit të KE-së i ngarkoi CEPT-it një mandat të dytë mbi dividendin digjital. Duke pasur parasysh shtrirjen e zgjatur të studimeve, ato u ndanë në tri grupe CEPT: TG4, SE42 dhe PT1.

Aktualisht, TG4 është duke zhvilluar:

- Udhëzime për koordinime kufitare të shërbimeve mobile të një vendi dhe shërbimeve të transmetimit të vendit fqinj;

- Rekomandim për të siguruar mirëmbajtjen e pajisjeve PMSE që veprojnë në breza 470-862 MHz në mënyrën më të mirë, duke përfshirë vlerësimin e avantazhet e një strategjie në nivelin europian;

- Rekomandim për riplanifikimin e mundshëm të shërbimit të radiodifuzionit (broadcasting), në mënyrë që të lirohet nënbrezi 790-862 MHz;

- Përcaktimin e kriterëve të mbrojtjes, për të mbrojtur shërbimin e lëvizshëm të transmetimit, për të ndihmuar krijimin e situatave që përputhen.

Nga ana tjetër, SE42 është duke përcaktuar kushtet e optimizuara teknike për të implementuar shërbime fikse dhe mobile të komunikimeve elektronike në nënbrezin 790-862 MHz, duke marrë parasysh bashkekzistencën me shërbimet aktuale, shërbimit e radiodifuzionit. SE42 është duke përdorur konceptin BEM (Block Edge Mask) për të përcaktuar kushtet teknike në këtë nënbrez.

Së fundi, PT1 është duke zhvilluar ndarjen e kanaleve për nënbrezin 790-862 MHz për IMT (International Mobile Communications), e cila nga njëra anë bën të mundur që të implementohen sisteme IMT në një shkallë të madhe në Bashkimin Europian, dhe në anën tjetër bën të mundur që vende të ndryshme të përshtatin mënyrën e ndarjes së kanaleve të propozuara me realitetet e tyre kombëtare dhe nevojat e tregut. Kanalizimi i IMT-së zhvilluar nga grupet duhet të përputhet me marrëveshjen GE 06.

A1.3 ITU

Konferenca Botërore e Radiokomunikimit 2007 (WRC-07) ka konsideruar alokimin e



shërbimeve të reja pa tel, përkatësisht për IMT (International Mobile Communications). Nga kjo Konferencë Botërore u vendos një ndarje primare në RR për shërbimin e telefonisë së lëvizshme në frekuencat e nënbrejit 790-862 MHz, në përputhje me kufizimet e përmendura më tej. Duhet të theksohet se pjesë e të njëjtit spektër është ndarë tashmë në RR për shërbimin e transmetimit (edhe me një status primar).

Identifikimi nga WRC-07 i spektrit për IMT është bërë nga një ndryshim në shënimin 5.317A të nenit 5 të RR, edhe pse ajo ishte vonuar në kohë (që hyn në fuqi më 17 qershor 2015), siç është specifikuar në shënimin 5.316B.

Gjatë diskutimeve në WRC-07 pati një debat të rëndësishëm rreth shënimit 5.316 të nenit 5 të RR, një shënim që ka ekzistuar dhe bëri një ndarje shtesë për shërbimin e lëvizshëm në nënbrejin 790-862 MHz.

Me pak fjalë, krijimi i nënbrejit 790-862 MHz për IMT në rajonin 1 ofron fleksibilitet në drejtim të implementimit të shërbimeve të tjera të radiokomunikimit.

Krijimi i grupit JTG 5-6 në kuadër të qëllimit të ITU-së duhet të përmendet. Ky grup i kombinuar është i përbërë nga grupet e studimit SG5 (shërbime tokësore) dhe SG6 (shërbime radiodifuzioni) në mënyrë që të merren me pikën 1.17 të agjendës së konferencës botërore të radhës (WRC-11). Kjo pikë kërkon që të kryhen studime në ndarjen midis shërbimit të lëvizshëm dhe shërbimeve të tjera për të cilat nënbrezi 790-862 MHz është ndarë (radiodifuzion, fiks, mobil dhe shërbimet e navigimit aeronautik) në rajonet 1 dhe 3, në bazë të rezolutës 749 (versioni WRC-07).

Agjenda e Konferencës Botërore të Radiokomunikimit 2012 (WRC 12) parashikon në një ndër pikat e saj, për marrjen në konsideratë të rezultateve të studimeve për ndarjen midis shërbimit të lëvizshëm dhe shërbimeve të tjera në brezin 790-862 MHz në rajonet 1 dhe 3, në përputhje me rezolutën 749 (WRC 07), për të siguruar një mbrojtje adekuate të shërbimeve për të cilat ky brez frekuencash është ndarë dhe marrjen e masave të duhura.

Propozimi i përbashkët europian i CEPT-it mbi pikat e agjendës në lidhje me shërbimin e radiodifuzionin dhe shërbimeve fikse shprehet se gjithashtu duhet të theksohet se në kuadër të Bashkimit Europian (dhe në vende të tjera europiane), brezi 790-862 MHz do të vihet në dispozicion për shërbimet e lëvizshme duke filluar nga viti 2013.

A2. APLIKIMET KANDIDATE POTENCIALE

Ekziston potenciali për përdorimin e përbashkët të spektrit të hapësirës së bardhë nga aplikime të tjera. Për shpërndarjen shtesore në brezin UHF mund të merren në konsideratë dy klasa pajisjesh me rreze të shkurtër dhe më të gjatë:

- Pajisje personale/portabël, si kartat Wi-Fi në kompjuter, laptop, telefona *smart*, PDA, aparate personale media (media players), që operojnë, për shembull me një fuqi maksimale *output* prej 100 mW.

- Pajisje fikse/aksesi që përgjithësisht operojnë nga një vendndodhje fikse dhe që mund të përdoren për të përfutur një shërbim komercial, siç është aksesimi pa fije (wireless) i internetit me brez të gjerë. Këto pajisje mund të operojnë, për shembull me një fuqi transmetimi *output* deri në 1 W.

Kategori të ngjashme pajisjesh operojnë sot në breza 2.4 GHz dhe 5 GHz.

Duhet theksuar se fuqitë shembull të transmetuesit janë të krahasueshme me ose më të mëdha se ato të supozuara për aplikime mobile në nënbrez (21 dBm për UMTS). Rrjedhimisht, mbrojtja e përdoruesve parësorë në brezin UHF do të kërkojë breza roje dhe zona përjashtimi të krahasueshme me ato të studiuarat paraprakisht për nënbrejin e harmonizuar.

Industria ka shprehur interes në përdorimin e brezit UHF për shkak të kushteve specifike të përhapjes, meqenëse lejon një interval më të madh se në 2.4 GHz ose 5 GHz, megjithëse operohet në kanale me gjerësi më të vogël brezi. Çdo kanal 8 MHz do të mbante vlera të dhënash që janë të krahasueshme me ato të shërbimeve aktuale të zonave të gjera, si 5 MHz HSDPA, por më të ulëta se pajisjet 802.11 që operojnë në kanale 20 MHz në 2.4 GHz dhe 5 GHz. Gjithsesi, pajisjet e hapësirës

së bardhë mund të bashkoheshin me çfarëdo lloj kanalesh të disponueshme për të fituar kapacitet më të madh.

Më poshtë janë radhitur disa shembuj aplikimesh:

- Në shpërndarjen multimediale të shtëpisë;
- Rrjeti WLAN dhe brixhing me interval të gjatë;
- Rrjete të vetorganizuara, rrjete komunitare dhe kompleksesh;
- Lojëra;
- Automatizimi dhe kontrolli shtëpiak;
- Aplikime monitoruese jokritike.

Këto aplikime mund të ofrohen tashmë në breza të tjerë frekuencash, të ndryshëm nga spektri UHF, por industria dëshiron të shfrytëzojë përfitime specifike të këtij spektri. Në veçanti, karakteristikat e përhapjes superiore të UHF bëjnë të mundur lidhje në një interval të gjerë, duke u ardhur në ndihmë kështu aplikimeve që kërkojnë shpërndarje të dhënash në kohë reale (shpërndarje multimediale në shtëpi, lojëra etj.). Nga ana tjetër, për të njëjtën arsye, që është përhapja superiore e UHF, interferenca e gjeneruar nga pajisjet e reja të hapësirës së bardhë drejt shërbimeve parësore apo të tjera me përparësi është gjithashtu më e madhe dhe do të imponojë disa pengesa në operimin e pajisjeve të tjera.

Suksesi i aplikimeve të treguara mund të mbështetet në aftësinë e tyre për të ofruar shërbime alternative, apo për të siguruar kapacitet shtesë për zgjidhje të tjera ekzistuese, siç janë pajisjet që aktualisht shpërndajnë kapacitet të lartë me interval të shkurtër në brezat 2.4 GHz dhe 5 GHz ose rrjetet mobile.

A2.1 FLEKSIBILITETI

Administratat kanë fuqi të plotë vendimmarrëse dhe sovranitet për të vendosur nëse brezi 790-862 MHz do të përdoret për transmetim, shërbim mobil apo ndonjë shërbim tjetër. Ky fleksibilitet mund të jetë i domosdoshëm nëse një administratë nuk mund t'i zhvendosë të gjitha shërbimet që aktualisht përdorin brezin 790-862 MHz ose për të tjera rrethana kombëtare. Megjithatë, duke bërë një gjë të tillë, administrata ka mundësi të humbë përfitimet e një plani të zakonshëm brezi që përfshin:

- ekonomitë e masës për pajisje të përballueshme nga përdoruesi;
- mundësi më e madhe zgjedhjeje për sigurues shërbimi (*provider-a*) dhe prodhues të pajisjeve të konsumatorit;
- risk i minimizuar i interferencës radio;
- vlerë ekonomike totale e maksimizuar e spektrit;
- koordinim jashtë kufijve i thjeshtuar dhe *roaming global*.

A2.2 NEUTRALITETI TEKNOLOGJIK

Një rregullim është teknologjikisht i paanshëm nëse ai as imponon, as diskriminon në favor të përdorimit të një lloji të caktuar teknologjie.

Teknologjitë (si për shembull, LTE dhe WiMAX) aktualisht të përballura me nevojën për shpërndarje në brezin 790-862 MHz i pranojnë të dyja mënyrat TDD dhe FDD. Një plan brezi tek për intervalin 790-862 MHz (ose FDD e çiftuar ose TDD e paçiftuar) rrjedhimisht nuk do të diskriminonte në favor ose kundër njëres prej këtyre teknologjive të përballura. Megjithatë, mund të ketë disa vështirësi implementimi në qoftë se терминаlet shumëbrezësh kanë nevojë për të mbështetur një metodë duplex të ndryshme në breza të tjerë.

A3. STRUKTURA GE 06 DHE KOORDINIMI JASHTË KUFIJVE

Mandati i dytë i CEPT konstaton se “Duhet marrë në konsideratë qëllimi i përgjithshëm i një qasjeje të koordinuar europiane, e implementuar përmes vendimeve të detajuara kombëtare mbi rregullimet e frekuencës, duke u pajtuar me strukturën GE 06”.

Masat aktuale në marrëveshjen GE 06 kërkojnë një administratë me dëshirë për të implementuar shërbime mobile për të përfutur marrëveshje paraprake nga administrata, shërbimi



aktual dhe i ardhshëm, i të cilit mund të ndikohet nga interferenca e shkaktuar nga shërbimi mobil, por gjithashtu nga pengesa që mund të lindin nga nevoja për të mbrojtur shërbimin mobil nga interferenca e shkaktuar nga shërbimet e saj transmetuese aktuale dhe të ardhshme.

Struktura GE 06 gjendet në raportin 21, 22 dhe 29 të CEPT-it. Për më tepër, CEPT-i po zhvillon një raport/rekomandim mbi rirregullimin e shërbimeve transmetuese, në mënyrë që nënbrezi 790-862 MHz të lirohet.

“Fleksibiliteti është një pjesë integrale e GE 06. E thënë me fjalë të tjera, plani nuk lejon që frekuencat e përcaktuara (njësi digjitale) të përdoren për të implementuar shërbimet e transmetimit me karakteristika të ndryshme ose me aplikime të tjera, me kusht që interferenca dhe kërkesat e mbrojtjes të ruhen brenda zarfit të njësisë korresponduese në plan. Administrata mund t’i modifikojë njësitë e saj në plan duke aplikuar dispozitat e nenit 4 të marrëveshjes GE 06.

Plani GE 06 nuk lejon që frekuencat e përcaktuara (njësi digjitale) të përdoren për shërbime të tjera në konceptin e maskës së spektrit, për sa kohë ato njoftohen sipas zarfit të përcaktimit të transmetimit dhe nuk kërkojnë më shumë mbrojtje, apo nuk shkaktjnë më shumë interferencë sesa është e lejueshme sipas GE 06. Rrjedhimisht, konkluzioni është i vlefshëm, duke qenë se marrëveshja GE 06 e lejon futjen në përdorim të aplikimeve multimediale mobile. Supozohet se spektri i harmonizuar për këto aplikime do ta përmirësojë futjen e tyre në përdorim.”

“Duhet theksuar se niveli i interferencës që mund të krijohet nga implementimi i njësive të planit GE 06 e bën praktikisht të pamundur që një vend të fillojë të përdorë një nënbrez të harmonizuar për aplikimet e komunikimeve mobile pa dakordësinë e vendeve fqinje, duke theksuar së këto mund të mos jenë anëtare të CEPT-it apo BE/EEC në të gjitha rastet. Implementimi i këtij nënbrezi të harmonizuar rrjedhimisht do të kërkojë negociata dypalëshe ose shumëpalëshe, sipas procedurave të marrëveshjes GE 06, që janë projektuar për të siguruar akses të paanshëm të spektrit nga të gjitha administratat.”

Raporti 29 i CEPT-it “Direktivat mbi çështjet e koordinimit ndërkufitar midis shërbimeve mobile në një vend dhe shërbimeve transmetuese në një vend tjetër” adreson koordinimin ndërkufitar për brezin 790-862 MHz. Raporti ka për qëllim të ndihmojë administratat të vendosin një metodologji të përbashkët për koordinimin në rastin kur një vend në kufi do që të përdorë brezin 790-862 MHz për aplikimet mobile, ndërkohë që vendi tjetër do që ta mbajë këtë brez për aplikime transmetimi. Ai konstaton:

CEPT është i mendimit që marrëveshja GE 06 siguron procedurat e përshtatshme rregullatore për identifikimin e administratave që do të përfshihen në procesin e koordinimit midis shërbimit të transmetimit në një vend dhe shërbimit celular në një vend tjetër. Identifikimi kryhet me anë të fuqisë së fushës së koordinimit nxitës.

CEPT-i më tej bie dakord se gjatë diskutimeve dypalëshe ose shumëpalëshe që përdorin elementet e përfshira në raportin 29 të CEPT-it për udhëzimin, nga administratat e interesuara, mund të lindë nevoja për zhvillimin e një metodologjie të detajuar koordinimi, përfshirë një vlerësim të kujdesshëm të interferencës.

Dispozitat e GE 06 mund të mos jenë të përshtatshme për koordinim ndërkufitar mes vendesh që janë anëtare të GE 06 dhe atyre që janë jashtë kësaj marrëveshjeje. Për më tepër, çështja e koordinimit midis shërbimit mobil dhe shërbimeve të ndryshme nga ato të transmetimit (që janë, ARNS) nuk mbulohen në GE 06 dhe nuk adresohen në studimet për përgatitjen për njësinë 1.17 të agjendës WRC-12.

A3.1 Avantazhet e një rregullimi të preferueshëm frekuence të harmonizuar bazuar në FDD

CEPT-i ka marrë në konsideratë përfitimet dhe risqet e pasjes së dy opsioneve (që janë FDD dhe TDD) për rregullimin e frekuencës përkundrejt pasjes së një rregullimi të preferueshëm frekuence dhe ai doli në përfundimin se avantazhet e një rregullimi të preferueshëm tek për këtë brez janë:

- Zhvillim i reduktuar dhe kostoja operative për infrastrukturën e ardhshme radio ose pajisjet e terminalit, që do të përdoren në brezin 790-862 MHz, duke shmangur copëzimin e tregut të CEPT-it në këtë brez frekuence, që mund të ndodhte me rregullimet e papërshtatshme të frekuencës. Një fokusim harmonizimi i mbarë CEPT-it mbi plan frekuence teke bazuar në mënyrën FDD do të jetë një përfitim për industrinë dhe konsumatorët;

- Mundësi e rritur dhe kosto të reduktuara për shërbimet *roaming* brenda CEPT-it;

- Proces licencimi i thjeshtëzuar;

- Siguria e tregut: Industria kërkon vizibilitet për lançimin e zhvillimit të pajisjeve radio, të cilat të jenë gati në kohë sipas pritshmërive të operatorëve të ardhshëm të licencuar në brezin 790-962 MHz;

Mënyra e përshtatshme (FDD ose TDD) duhet t'u përgjigjet kërkesave të tregut. Sot, industria është duke e mbështetur në mënyrë unanime mënyrën FDD duplex në këtë brez frekuence.

Duhet shtuar se nga CEPT-i është treguar se mbrojtja e marrjes së stacionit bazë nga emetimi tv është shumë më sfiduese sesa mbrojtja e marrjes së terminalit. Rrjedhimisht, rregullimi i frekuencës TDD, aty ku stacionet janë duke marrë përgjatë gjithë brezit, krijon një sfidë shumë më të vështirë koordinimi sesa FDD-ja në rastin kur një vend fqinj do të vazhdojë ta përdorë brezin për transmetim.

Pra, CEPT-i ka zhvilluar një rregullim të preferueshëm për frekuencën e harmonizuar, bazuar në mënyrën FDD.

A4. Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë

Në Shqipëri. Në brezin e parashikuar për dividendin digjital, aktualisht ka transmetime analoge, transmetime ekzistuese digjitale dhe kanale të planifikuara për transmetime digjitale sipas planit GE 06. Problemi kryesor rezulton riplanifikimi i transmetimeve digjitale në breza më të ulët frekuencash, për të mos pakësuar kapacitetet transmetuese të fituara nga plani GE 06.

Për këtë qëllim duhet planifikuar koordinimi me vendet fqinje dhe duhet bërë regjistrimi në GE 06 të rreth 13% të caktimeve frekuencore totale të planifikuara nga GE 06. Vetëm pasi të jetë realizuar migrimi i këtyre caktimeve frekuencore në breza frekuencash më të ulëta (470-790 MHz), mund të fillojë përdorimi i brezit të DD (790-862 MHz) për aplikime me bandë të gjerë, me leverdi për ekonominë.

Futja e shërbimeve të reja të komunikimeve elektronike dhe zhvillimi i shërbimeve të transmetimit digjital në kuadër të spektrit të frekuencave UHF kanë kufizime të caktuara në kuptimin e përdorimit të dividendit digjital:

- Mbrojtja e shërbimeve analoge të transmetimit deri në *switch-off* ngadalëson procesin e shfrytëzimit të dividendit digjital;

- Përdorimi i dividendit digjital është në përgjithësi i kufizuar nga shërbimet sekondare të përdorur në brezin UHF;

- Megjithëse procedurat për modifikimin e planit GE 06 japin një kuadër të përshtatshëm në të cilin administratat përshtatin kërkesat e tyre për nevojat e ardhshme, fleksibiliteti i ofruar për administratat për të bërë këtë, tashmë çon në variacione të nevojave për burime spektale, të cilat në një kuptim më të gjerë kufizojnë mundësinë për përdorimin e spektrit të harmonizuar në të ardhmen;

- Në shumë shtete implementimi i shërbimeve mobile multimediale devijon nga konfigurimi i planifikimit të referencës në të cilën marrëveshja GE 06 është bazuar;

- Projektimi i pajisjeve marrëse dhe shpenzimet në rast të shërbimeve multimedia mobile kushtëzojnë ndarjen minimale të frekuencave që ka nevojë të sigurohet midis frekuencave që do të përdoren për marrjen e përmbajtjes multimediale, d.m.th. *downlink* dhe frekuencave që do të përdoren për transmetimin nga marrja e lëvizshme, d.m.th. *uplink*;

- Pavarësisht nga fakti se marrëveshja GE 06 jep një nivel të caktuar fleksibiliteti për



administratat, duke futur konceptin e maskës së spektrit, procedurat e marrëveshjes nuk parashikojnë mundësinë për njoftimin e kërkesave për *uplink* për shërbime mobile multimediale;

- Përdorimi i *uplink* për shërbime fikse/mobile në UHF krijon nevojën për futjen e një brezi mbrojtës midis frekuencave të parashikuara për *uplink* dhe kanaleve që do të përdoren për transmetimet digjitale tokësore. Kjo e bën bashkekzistencën e shërbimeve fikse/mobile dhe transmetimeve televizive tokësore të vështirë dhe gjithashtu krijon nevojën për koordinim. Harmonizimi i nënbrezave brenda brezit UHF që të përdoren për nevojat e shërbimeve fikse/mobile në nivel evropian, si dhe kështu në nivelin e shteteve anëtare të ITU-së, është zgjidhja e propozuar nga grupi RSPG i Komisionit Evropian, ku administratat që synojnë të përdorin të gjithë brezin UHF për sistemet e transmetimit digjital tokësor prapë mund të vazhdojnë kështu;

- Harmonizimi i pjesës së brezit VHF për përdorimin e *uplinks* nuk është i përshtatshëm për shkak të gjerësisë së brezit joadekuat.

Për implementimin e shërbimeve fikse/mobile në pjesë të brezit UHF pikat e mëposhtme duhet të merren parasysh:

- Realizueshmëria teknike e harmonizimit të nënbrezit brenda brezit UHF për përdorim të lëvizshëm (duke përfshirë *uplinks*), duke minimizuar ndikimin në planin GE 06;

- Propozimet e planit mbi mundësitë teknike dhe skenarët e optimizimit të digjitalit dividend, duke përfshirë edhe hapat gjatë periudhës së tranzicionit përpara *switch-off analog*.

Shërbimet fikse/mobile janë sisteme që kërkojnë dy drejtime, transmetim *downlink* dhe *uplink*, ku *uplink* nuk mbulohet nga marrëveshja GE 06, d.m.th. nuk mund të përcaktohen nga zbatimi i maskës spektrale të hyrjeve ekzistuese në planin GE 06. Megjithatë, tendencat teknologjike iniciojnë nevojën për të kërkuar akses në pjesë të spektrit të frekuencave UHF.

Për shërbime me brez të gjerë fikse/mobile IMT (International Mobile Telecommunications) dhe WiMAX, duke marrë parasysh si vijon:

- Përmirësime në cilësinë e shërbimeve *broadband*, për shembull shërbimet me shkallë të lartë të transmetimit të të dhënave, me mbulim të mirë brenda ndërtesave, veçanërisht në zonat kryesore të popullsisë;

- Shtirja e mbulimit të shërbimeve *broadband* në zonat rurale, të mbuluara nga rrjeti 3G.

Uplink-u i shërbimeve fikse/mobile mund të shkaktojë ndërhyrje (interferencë) në rast se shërbime të tilla do të operojnë në kanalet e ngjitura në shërbimin televiziv digjital tokësor, dhe për shkak të faktit se burimi i një ndërhyrjeje të tillë është sinjali i transmetuar nga pajisje të lëvizshme, operatorët në përgjithësi nuk janë në gjendje për të zvogëluar ndërhyrjen me metoda që zakonisht zbatohen për shërbime fikse.

Disa detyra që lindin për KKRT/AKEP në vijim të ndryshimit nga transmetimet analoge në digjitale janë:

- Harmonizimi i dividendit digjital në nivel kombëtar dhe evropian. Ndjekja dhe implementimi i politikave dhe rekomandimeve të Bashkimit Evropian, grupit të spektrit radio “Përfitime për të gjithë BE-në për përdorimin e dividendit digjital nga aplikacionet mobile (duke përfshirë *uplinks*) në një nënbrez UHF të harmonizuar”. Sipas CEPT-it, harmonizimi është i mundshëm nga një këndvështrim rregullator teknik, dhe nuk duhet të jetë i detyrueshëm. Brezi i parapëlqyer është 800 MHz dhe për këtë harmonizim janë të nevojshme diskutime shumëpalëshe.

- Rialokimi dhe studimi i brezave të frekuencave që preken nga kalimi në transmetime digjitale tokësore.

- Pasqyrimi i këtyre ndryshimeve, caktimi i brezave për shërbime të reja, në planin kombëtar të frekuencave dhe në planin e përdorimit të frekuencave.

Prandaj sa më parë të realizohet kalimi i plotë në transmetimet digjitale dhe të bëhet riplanifikimi në breza më të ulëta, aq më parë lirohet spektri i dividendit digjital për shërbime me brez të gjerë.

ANEKS 3 ASPEKTE MBI TEKNOLOGJINË

Rritja e kërkesës për informacion ka sjellë zhvillime të rëndësishme, të cilat pasqyrohen në një rritje të konsiderueshme në kapacitetin e transmetimit në platformën tokësore. Këto zhvillime kanë të bëjnë me përmirësime në standardet e përdorura për kodim (kompresim) informacioni dhe në sistemet e transmetimit.

- MPEG-4 është një standard kompresimi i videos dhe audios i përmirësuar. Kjo pritet të rezultojë deri në dyfishin e efikasitetit të standardit të kompresimit MPEG-2, që aktualisht është përdorur për shumicën e transmetimeve digjitale tokësore në Europë. Kjo do të thotë se një Multiplex (MUX) DTT mund të mbështesë deri dy herë më shumë programe, duke përdorur MPEG-4 sesa duke përdorur kodimin MPEG-2, duke siguruar të njëjtin kualitet figure dhe zëri.

- DVB-T2 është një standard i ri transmetimi specifikimet e të cilit janë botuar për herë të parë nga projekti DVB, në qershor 2008 dhe është standardizuar nga Instituti i Standardeve Europiane të Telekomunikacionit (ETSI), që nga shtatori 2009.

Në krahasim me standardin aktual të televizionit digjital tokësor, DVB-T, standardi i gjeneratës së dytë DVB-T2 siguron një rritje minimale në kapacitet të paktën 30% në kushte ekuivalente të marrjes, duke përdorur antena të marrjes ekzistuese. Disa testime paraprake, megjithatë, sugjerojnë se rritja e kapacitetit të fituar në praktikë mund të jetë deri 50%. Kjo mund të bëjë të mundur hedhjen në treg të shërbimeve të reja të transmetimit që mundësojnë përdorimin intensiv të kapacitetit të frekuencave, duke pasur parasysh spektrin e kufizuar në dispozicion në VHF dhe UHF. Standardi DVB-T2 mundëson gjithashtu ofrimin e shërbimeve të gjeneratës tjetër si 3D TV, të cilët mund të përfitojnë nga rritja e kapacitetit në dispozicion me këtë standard.

Nga vlerësimet e bëra rezulton se përdorimi i këtyre dy teknologjive, nëse kombinohen, rrit kapacitetin e një Multipleksi (MUX) deri në 160% për marrjen fikse edhe pse disa ekspertë konsiderojnë vlerën 100%, që të jetë një vlerësim më realist. Presupozohet, gjithashtu, se përfitimi në kapacitet në rastin e marrjes mobile do të jetë i ngjashëm me atë të marrjes fikse.

Implementimi i një sistemi DTT DVB-T2:

- kërkon trajtime të ndryshme në lidhje me planifikimin e rrjetit dhe mund të ketë një ndikim në planifikimin e frekuencave. Në veçanti, nëse plani i GE 06 do të përdoret për DVB-T2 në vend të DVB-T kushtet për këtë zëvendësim duhet të jenë të përcaktuara dhe implikimet në drejtim të interferencave, kërkesat për mbrojtjen dhe parametrat e mbulimit duhet të hetohen;

- do të sjellë kosto më të larta për transmetuesit dhe konsumatorët.

Në mënyrë që të përfitojnë nga ekonomia në shkallë kombëtare, do të jetë e nevojshme që operatorët kombëtarë të miratojnë specifikime të përbashkëta për marrësit DVBT2. Kjo do të parandalojë fragmentimin e tregut dhe do të sigurojë që shikuesit të kenë akses në një përzgjedhje të gjerë të dekoderave DVB-T2 në pikën më të ulët të mundshme të çmimit. Kjo është arsyeja që prodhuesit kanë filluar tashmë punën për të përcaktuar kërkesat për dekoderat DVBT2 në të gjithë Europën.

SISTEMET E KRIPTUARA DHE NDËRFAQJA E PËRBASHKËT

Kriptimi zbatohet në përgjithësi, për të siguruar një akses të kushtëzuar për shikuesit që kanë të drejtë të marrin shërbim dhe për të parandaluar përdorimin e paautorizuar. Kusht për aksesin mund të jetë pagesa ose vendndodhja në rastet ku të drejtat e programit janë të kufizuara gjeografikisht. Në shumicën e rasteve, aksesit sigurohet nga një kartë *smart*. Kur konsumatori i plotëson kushtet e aksesit (d.m.th. është i pajisur me *SmartCard*-in e duhur dhe ka paguar për shërbimet e kërkuara) transmetohet një sinjal autorizimi i cili pranohet nga karta *smart* dhe konsumatori ka akses në shërbimet e ofruara.

Kriptimi i sinjaleve televizive është një praktikë normale me shumë shërbime të transmetimit



satelitor. Gjithashtu, në vende të ndryshme, pjesë e paketës së programeve është e koduar dhe aksesit jepet vetëm në qoftë së abonimi paguhet.

Problemi me enkriptimin qëndron në faktin së çdo ofrues shërbimi që ofron përmbajtje *premium* me anë të kanaleve me pagesë mund të përdorë një kod enkriptimi që është i ndryshëm nga të tjerët. Si pasojë, konsumatori që dëshiron të shikojë kanale të pranishme në më shumë se një platformë, të enkriptuara në mënyrë të ndryshme, do të duhet të blejë një dekoder për secilin sistem enkriptimi.

Zgjidhja e këtij problemi qëndron në përdorimin e të ashtuquajturës “Ndërfaqe e përbashkët”, një standard i përcaktuar që mundëson shtimin e një sistemi aksesit të kushtëzuar (CAS) në një marrës DTV, për t’u përshtatur me lloje të ndryshme kriptografimi. Aktualisht në treg ekzistojnë forma të ndryshme të sistemeve të kushtëzuara të aksesit (Conditional Access System - CAS), zhvilluar kryesisht për transmetim satelitor, por gjithashtu të zbatueshme edhe në platformat digjitale tokësore.

Zgjedhja për një CAS është një kompromis midis shpenzimeve të sistemit dhe sigurisë (mundësitë e pritshme ose të raportuara të *hack*-imit të sistemit). Në qoftë se zgjidhet përdorimi i CAS-së është e rëndësishme të sigurohet që:

- Mund të inkorporohet më shumë se një sistem (multicript) në rast se sistemet e ndryshme të CAS-it janë në përdorim në një vend;

- Prodhuarit e marrësit implementojnë CAS-in në marrës apo *set-top box*, me anë të një ndërfaqeje të përbashkët (Common Interface-CI), një zgjidhje më e shtrenjtë që e bën marrësin të pavarur nga ofruesi i shërbimit dhe më fleksibël.

Ndërfaqja e përbashkët lejon transmetuesit të përdorin module që përmbajnë zgjidhje nga furnizues të ndryshëm në të njëjtin sistem transmetimi, duke rritur kështu zgjedhjen e tyre për opsionet kundër piraterisë.

Me qëllim promovimin e ndërveprimit dhe nxitjen e konkurrencës në treg, çdo operator duhet të integrojë në marrësit e vet ndërfaqen e përbashkët.

Një ndërfaqe e përbashkët e përmirësuar “CI Plus” është zhvilluar nga një numër i madh prodhuesish në mënyrë që të sigurojë funksionalitet të përmirësuar të mbrojtjes nga kopjet. CI Plus pritet të bëhet *de facto* norma në të gjithë marrësit televiziv nga viti 2011.

**PLANI I VEPRIMIT
PËR NDJEKJEN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË KALIMIT TË PLOTË NË TRANSMETIMET NUMERIKE**

Nr.	Çështja	Kostimi	Institucioni/et përgjegjës/e		Fillimi	Mbarimi
			Zbatuesi	Kush e ndjek		
1.	Propozimi i strategjisë së kalimit në transmetimet numerike nga komisioni <i>ad hoc</i>	-	Komiteti <i>ad hoc</i>	MITIK		Maj 2012
2.	Miratimi i strategjisë së kalimit në transmetimet numerike në Këshillin e Ministrave	-	Këshilli i Ministrave	Komiteti <i>ad hoc</i>		Maj 2012
3.	Miratimi i: 1. Ligjit “Për mediet audiovizive në territorin e Shqipërisë”	-		Kuvendi		Maj 2012
4.	Miratimi i rregullores së licencimit/autorizimit të shërbimeve audiovizive, rrjeteve ku mbështeten këto shërbime, si dhe shërbimet e tjera	-	KKRT	Komiteti i ri <i>ad hoc</i> ¹		Shtator 2012
5.	Miratimi i karakteristikave teknike të rrjeteve numerike, standardet për ndërfaqen e përbashkët (EPG), standardin e kompresionit etj.	-	KKRT	Komiteti <i>ad hoc</i>		Korrik 2012
6.	Njoftimi i ITU-së dhe vendeve brenda zonës së koordinimit për vënien në shfrytëzim të frekuencave të planifikuara (article 5)	-	KKRT	Komiteti <i>ad hoc</i>		Korrik 2012
7.	Përgatitja e planeve të frekuencave për fazën e parë për krijimin e: 1. rrjetit numerik të RTSH-së (MUX 1 + MUX 2); 2. rrjet numerik i op. privatë kombëtarë (MUX 3); 3. rrjet numerik i op. privatë kombëtarë (MUX 4); 4. identifikimi i frek. për (MUX 5)	-	KKRT	Komiteti <i>ad hoc</i>		Korrik 2012 Korrik 2012 Korrik 2012 Korrik 2012
8.	Përgatitja e planeve të frekuencave për rrjetet e tjera pas lirimimit të frekuencave nga transmetimet analoge dhe riplanifikimit të frekuencave për lirimimin e spektrit të dividendit numerik, sipas përcaktimit të planit kombëtar të frekuencave	-	KKRT	Komiteti <i>ad hoc</i>		Qershor 2012
9.	Koordinimi i punës për lirimimin e spektrit 790-862 MHz për dividendin numerik brenda afateve të përcaktuara nga WRC 07	-	MITIK KKRT AKEP	Komiteti <i>ad hoc</i>		Qershor 2012
10.	Caktimi i frekuencave për shërbimet fikse pikë më pikë për mbartjen e fluksit të transportit	-	AKEP	Komiteti <i>ad hoc</i>		Korrik 2012

¹ Me urdhrin e Kryeministrit nr. 159, datë 27.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 77, datë 2.6.2009 “ Për ngritjen e komitetit *ad hoc* për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në digjitale”, parashikohet që mandati i këtij komiteti *ad hoc*, përfundon me miratimin e strategjisë, në këtë projektstrategji është parashikuar krijimi i një organizmi të ri (që mund të quhet sërish komiteti *ad hoc*). Ky organ është menduar të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie dhe objekti i punës së tij do të jetë ndjekja e zbatimit të strategjisë.



	(transport stream) deri tek transmetuesit, sipas kërkesave të projektit të ndërtimit të MUX 1 dhe MUX 2		RTSH	KKRT		
11.	Njoftimi zyrtar i aktorëve të tregut audioviziv mbi kuadrin rregullator, mënyrat e detajuara të kalimit në transmetimet numerike për secilin operator analog ekzistues, afatet e zbatimit të “ishujve numerikë” dhe penalitetet për moszbatimin e tyre (Konferenca rajonale e kombëtare)	Lekë 4 000 000	KKRT ¹	Komiteti <i>ad hoc</i>		Qershor 2012
12.	Krijimi i “ <i>call center</i> ” pranë KKRT-së	Lekë 4 000 000	KKRT ²	Komiteti <i>ad hoc</i>		Tetor 2012
13.	Organizimi i fushatës për informimin e publikut	Lekë 188 000 000	Varianti 1: KKRT ³	Komiteti <i>ad hoc</i>	Qershor 2012	Qershor 2015
14.	Licencimi i operatorëve privatë kombëtarë bazuar në kriteret e përcaktuara në ligj dhe rregulloren e licencimit të KKRT-së. Një nga kushtet për licencim do të jetë respektimi i grafikut të ndërtimit të “ishujve numerikë”	-	KKRT	Komiteti <i>ad hoc</i>		Nëntor 2012
15.	Paraqitja para operatorëve ekzistues privatë analogë (lokalë e rajonalë) e alternativave të digjitalizimit të tyre: 1. Mbështetja në rrjetin e RTSH-së; 2. Financimi i përbashkët për ndërtimin e rrjetit; 3. Garë për ndërtimin e rrjetit. Bazuar në rezultatet e konsultimit, përcaktimi i nr. të operatorëve që do të mbështeten në rrjetin e RTSH-së	Lekë 4 200 000	KKRT RTSH ⁴	Komiteti <i>ad hoc</i>		Qershor 2012
16.	Sigurimi i financimit të ndërtimit të rrjetit të operatorit publik dhe hartimi i planit të implementimit të tij: a) Përcaktimi përfundimtar i kostove buxhetore të ndërtimit të rrjetit; b) Ndjekja e procedurave të sigurimit të kredisë së butë për financimin. c) Zbatimi i procedurave të prokurimit për zgjedhjen e kompanisë furnizuese me pajisje d) Lidhja e kontratës me fituesin e garës dhe miratimi i grafikut të ndërtimit në përputhje me grafikun e zbatimit të “ishujve numerikë”	-	MITIK RTSH	Komiteti <i>ad hoc</i>	Nëntor 2011	Qershor 2012
17.	Sigurimi i financimit të dekoderve, hartimi i skemës së shpërndarjes së tyre te përdoruesit, përcaktimi i mbështetjes së mundshme nga ana e operatorëve numerikë ekzistues në subvencionin e dekoderve.	Lekë; V1. Subv.100% 3 850 000 000 V2 Subv. 50% 1 950 000 000	MITIK Min. e Financave METE	Komiteti <i>ad hoc</i>	Janar 2012	Korik 2012

¹ KKRT-ja merr përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit/donatorët.

² KKRT-ja merr përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit/donatorët.

³ Varianti 2: Të përcaktohet me akt normativ që bërja e reklamave për këtë çështje, si në tv publik edhe ato private të bëhet falas.

Për variantin 1: KKRT-ja merr përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit/donatorët.

⁴ KKRT-ja dhe RTSH-ja marrin përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit/donatorët.

		V3. Subv 7% 262 000 000				
18.	Propozimi i masave për mbulimin e abonentëve të largët që merrnin më parë sinjal analog dhe që mund të mbeten jashtë shërbimit gjatë kalimit në transmetimet numerike (kompozimi i buketave satelitore me programet ekzistuese analoge)	Lekë 252 000 000 (ose 1 800 000 Euro) në vit	RTSH ¹ Min. e Financave		Nëntor 2012	Gusht 2012
19.	Fillimi i zbatimit të “ishullit të parë numerik” (allotmenti Tiranë-Durrës): a) Fillimi i njoftimit të popullatës për ndryshimet, afatet e realizimit, për t’u pajisur me kohë me dekodera; b) Zbatimi i skemës së miratuar të shpërndarjes së dekoderave; c) Ndërtimi i rrjetit SFN të TVSH-së; d) Koordinimi i kohës së ndërtimit të rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë me rrjetin e RTSH-së; e) Hartimi dhe lidhja e kontratave midis TVSH-së dhe operatorëve analogë ekzistues për kushtet e mbështetjes në rrjetin e RTSH-së; f) Sjellja e sinjaleve nga studiot e operatorëve analogë ekzistues në MUX -in e RTSH-së me shpenzimet e vetë operatorëve ekzistues; g) Testimi i funksionimit dhe njoftimi i audiencës për afatin përfundimtar të mbylljes së transmetimeve analoge; h) Verifikimi i mbulimit me sinjal numerik tokësor të zonës së mbulimit; i) Mbyllja e transmetimeve analoge	(Shih kostot më lart) Lekë 3 500 000 000 (E 25 000 000) për të gjitha allotmentet	RTSH Operatorët privatë Min. e Financave RTSH RTSH KKRT RTSH RTSH Op. analogë Op. analogë RTSH RTSH Sek. teknik RTSH KKRT RTSH, operatorët lokalë	Komiteti <i>ad hoc</i> Komiteti <i>ad hoc</i> Komiteti <i>ad hoc</i> Komiteti <i>ad hoc</i> Komiteti <i>ad hoc</i> KKRT Komiteti <i>ad hoc</i> KKRT Komiteti <i>ad hoc</i> KKRT	Tetor 2012 Nëntor 2012 Tetor 2012 Nëntor 2012 Tetor 2012 Mars 2013 Shkurt 2013 Shkurt 2013 Prill 2013	Prill 2013 Prill 2013 Janar 2013 Janar 2013 Dhjetor 2012 Mars 2013 Shkurt 2013 Shkurt 2013 Mars 2013 Prill 2013
20.	Implementimi i “ishujve numerikë” pasues duke zbatuar hap pas hapi metodologjinë e aplikuar në implementimin e “ishullit” të parë.	-	RTSH Op. analogë	Komiteti <i>ad hoc</i> KKRT	Tetor 2012	Qershor 2015
21.	Ndjekja e ecurisë së procesit të digjitalizimit			Komiteti <i>ad hoc</i> Kuvendi	Mbledhje e çdo muaji (ose mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesën e secilit prej anëtarëve të komitetit <i>ad hoc</i>)	

¹ RTSH-ja merr përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit/donatorët.



VENDIM
Nr. 368, datë 30.5.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1180, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR
LEGALIZIM DHE MBLEDHJEN E ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË PROCESIT
TË LEGALIZIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Tarifa e shërbimit për legalizimin e objekteve pa leje, shtesave informale në ndërtime me leje përbëhet nga:

1.1. Tarifa e shërbimit për përditësim, e cila është në vlerën 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo kat të objektit pa leje/shtesës informale në ndërtime me leje.

1.2. Tarifa e shërbimit për hartimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, me vlerë 6 000 (gjashtë mijë) lekë për çdo objekt pa leje/shtesë informale në ndërtim me leje.

1.3. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa e shërbimit për përditësimin dhe për hartimin e dokumentacionit tekniko - ligjor do të përdoren nga ALUIZNI dhe do të destinohen respektivisht për përditësimin në terren të gjendjes ndërtimore dhe mbulimin e shpenzimeve për hartimin e dokumentacionit administrativ për legalizimin e objekteve pa leje/shtesave informale në ndërtime me leje.

1.4. Subjektet, që përfitojnë legalizimin e objekteve informale, do të shlyejnë brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e njoftimit me shkrim mbi pagesat, vlerat e përcaktuara në pikat 1.1 dhe 1.2 të këtij vendimi, në llogarinë e hapur për këtë qëllim.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.6.2012
Doli nga shtypi më 7.6.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 80 lekë